



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Integritimit Evropian
Ministarstvo za Evropske Integracije - Ministry of European Integration

Plani i Veprimit për
Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit 2014

Dhjetor, 2013
Prishtinë

Faqe e zbrazët

Fjala hyrëse e Kryeministrit



Në rrjedhën e një dekade, Republika e Kosovës është ballafaquar me shumë sfida.

Kemi kaluar një rrugë të gjatë. Duke dalur nga lufta për liri nga një regjim tiranik, dhe duke u ngritur në një demokraci funksionale, me institucione të qëndrueshme dhe ekonomi të lirë të tregut, ku liria e fjalës, fesë, dhe të drejtat e tjera themelore janë garantuar nuk ka qenë rrugëtim i lehtë. Megjithatë, ne ia arritëm.

Më 17 Shkurt 2008, Kuvendi i Kosovës shpalli Republikën e Kosovës shtet të pavarur dhe sovran. Deri më sot, pavarësia e Kosovës është njohur nga gjithsej 105 vende, nga të cilat 23 janë shtete anëtare të BE-së. Republika e Kosovës është anëtare në institucionet kryesore ndërkombëtare, të tilla si Banka Botërore, Fondi Monetar Ndërkombëtar, Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, etj.

Procesi i Evropianizimit është më shumë se vetëm miratimi i *acquis* së BE-së dhe përmbushjes së normave dhe standardeve të BE-së. Një shembull i kësaj është Kroacia, e cila me 1 korrik 2013 u bë pjesë e familjes së madhe Evropiane. Me trashëgimi përafërsisht të njëjtë historike, politike dhe ekonomike, procesi i anëtarësimit të Kroacisë ka sjellë një transformim thelbësor të marrëdhënieve shtet-qtet, reformë të qëndrueshme të administratës publike dhe një cikël të zhvillimit ekonomik, investimeve të huaja direkte dhe zbutjen e varfërisë duke përmirësuar mirëqenjen e përgjithshme të shoqërisë.

Këtë vitë, Kosova ka hapur një kapitull të ri në fushën e integrimit evropian. Republika e Kosovës, më 28 tetor 2013, ka filluar negociatat për Marrëveshjen Stabilizim Asociimi. Kjo u bë e mundur vetëm pas përmbushjes së kriteve afat-shkurta të identifikuar në Studimin e Fizibilitetit. Nisja e negociatave konfirmoj konkretizimin dhe përkushtimin e qeverisë së Kosovës drejt integrimit të plotë në BE.

Nisja e negociatave për Marrëveshjen Stabilizim Asociimi në mes të vendit tonë dhe BE-së është një moment historik në kuadër të procesit integruar të vendit tonë. Marrëveshja Stabilizim Asociimi do të jetë marrëveshja e parë kontraktuale që ofron perspektivë të qartë drejt anëtarësimit të plotë të Kosovës në BE.

Qeveria ka shprehur vazhdimisht përkushtimin e saj të lartë për agjendën e BE-së - me vepra, po aq sa edhe me fjalë. Bërthama e përkushtimit tonë qëndron në mbështetjen e madhe të qytetarëve tanë për reformat që do të transformojnë vendin tonë në një anëtar krenar të familjes Evropiane.

Ekziston një rrugë e gjatë përpara nesh. Sundimi i ligjit është prioritet kyç. Në vitet e fundit është bërë një punë e madhe në miratimin e legjislacionit modern që ka mundur themelimin e institucioneve të pavarura të gjyqësorit dhe vendosjen e standardeve të larta evropiane në fushën e sundimit të ligjit. Tani është koha për zbatimin e legjislacionit të miratuar dhe arritjes së rezultateve konkrete që do të dëshmojnë funksionimin efektiv të gjithë sistemit të gjyqësor.

Ofrimi efikas i shërbimeve publike mbështetet në një administratë publike profesionale, bazuar në parimin e meritokracisë dhe pa ndërhyrje politike. Në fushën e mbrojtjes së minoriteteve dhe të drejtave themelore, ne kemi miratuar një legjislacion modern evropian i cili garanton standarde më të larta evropiane.

Reformat strukturore ekonomike do të ulin rolin jo-efikas të shtetit dhe do të krijojnë një mjedis të favorshëm për të bërit biznes. Ne jemi duke zbatuar projekte infrastrukturore që do të jenë thelbësore për zhvillimin tonë ekonomik.

Në fjalën përmbyllëse, unë do të doja të shprehë falënderimet e mia për të gjithë kolegët që kanë punuar në përgatitjen e Planit të Veprimit të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit. Plani i Veprimit për MSA-në përfaqëson përgjigjen e Qeverisë për vizionin e vendit për anëtarësim në Bashkimin Evropian.

Progresi përgjatë linjave që kemi përshkruar në këtë dokument do të sjellë qytetarët më afër BE-së dhe do të sigurojë që Kosova është një vend më i mirë, i ankoruar vendosmërisht në rrugën e saj drejt anëtarësimit në BE.

Hashim Thaçi

Kryeministër i Republikës së Kosovës

| | |
|--|--|
| Marrëdhëniet e Republikës së Kosovës me Bashkimin Evropian | 6 |
| 2. KRITERET POLITIKE | 11 |
| 2.1. DEMOKRACIA DHE SUNDIMI I LIGJIT | 11 |
| 2.2. Të Drejtat e Njeriut dhe Mbrojtja e Minoriteteve | 16 |
| 2.3 Çështjet Rajonale dhe Obligimet Ndërkombëtare | 18 |
| 3. KRITERET EKONOMIKE | 20 |
| 3.1 Ekzistenca e Ekonomisë Funktionale te Tregut..... | 20 |
| 3.2. Kapaciteti i Përbaljes me Presion Konkurrues dhe Forcat e Tregut Brenda Bashkimit Evropian | 23 |
| Kapitali njerëzor dhe fizik | 23 |
| 4. STANDARDET EVROPIANE..... | 26 |
| 4.1. Tregu i Brendshëm..... | 26 |
| 4.1.1. Lëvizja e Lirë e Mallrave | 26 |
| 4.1.2. Lëvizja e lire e punëtorëve, shërbimeve dhe e drejta e themelimit..... | 30 |
| 4.1.3. Lëvizja e Lirë e Kapitalit..... | 31 |
| 4.1.4. Doganat dhe Tatimet | 32 |
| a. Doganat | 32 |
| b. Tatimet..... | 32 |
| 4.1.5. Konkurrenca | 33 |
| 4.1.6. Prokurimi Publik..... | 34 |
| 4.1.7. Ligji i Pronësisë Intelektuale..... | 35 |
| 4.1.8. Politikat e Punësimit dhe ato Sociale, Politikat e Shëndetit Publik | 36 |
| 4.1.9. Arsimi dhe Hulumtimi..... | 38 |
| 4.1.10. Çështjet e Organizatës Botërore të Tregtisë (OBT) | 39 |
| 4.2. Politikat Sektoriale | 39 |
| 4.2.1. Industria dhe NVM-të | 39 |
| 4.2.2. Bujqësia..... | 40 |
| 4.2.3. Mjedisi | 43 |
| 4.2.4. Politikat e Transportit..... | 44 |
| 4.2.5. Energjia | 46 |
| 4.2.6. Shoqëria Informative | 47 |
| 4.2.7. Kontrolli Financiar | 48 |
| 4.2.8. Statistikat | 49 |
| 4.3. Drejtësia, Liria dhe Siguria | 50 |
| 4.3.1. Vizat, kufijtë, azili dhe migrimi..... | 50 |
| 4.3.2. Shpëlarja e parave | 51 |
| 4.3.3. Drogat | 51 |
| 4.3.4. Policia..... | 51 |
| 4.3.5. Luftimi i krimit të organizuar..... | 52 |
| 4.3.6. Mbrojtja e të dhënave personale | 53 |
| Aneksi 1. Matrica e Planit te Veprimt për MSA 2014 | Ошибка! Закладка не определена. |
| Aneksi 2. Matrica e Planit te Veprimt me fokus në kriteret afatmesme të Studimit të Fizibilitetit | |

Marrëdhëniet e Republikës së Kosovës me Bashkimin Evropian

Në vitin 1999, BE-ja propozoi themelimin e procesit të Stabilizim Asociimit për vendet e Ballkanit Perëndimor, si kornizë për procesin e anëtarësimit për Ballkanin Perëndimor.

Në Nëntor të vitit 2000, procesi i Stabilizim Asociimit zyrtarisht u fillua në samitin e Zagrebit. Në Zagreb, BE-ja nënvizoi se perspektiva Evropiane e vendeve të Ballkanit Perëndimor do të përcaktohet në bazë të progresit të tyre drejt një demokracie të qëndrueshme, sundimit të ligjit, ekonomisë së tregut dhe bashkëpunimit rajonal. Këshilli Evropian në Selanik i mbajtur në Qershor të vitit 2003, konfirmoi se e ardhmja e vendeve të Ballkanit Perëndimor është në BE.

Që nga Selaniku, Kosova është e përfshirë në kornizën e procesit të Stabilizim Asociimit. Në prill të vitit 2005, Komisioni Evropian ka miratuar komunikatën "*E ardhmja evropiane për Kosovën*". Në vitin 2006, Këshilli ka miratuar Partneritetin e parë Evropian. Partneriteti i dytë Evropian për Kosovën është miratuar në vitin 2008. Si një përgjigje ndaj prioriteteve të Partneritetit Evropian, Qeveria ka miratuar Planin e Veprimit të Partneritetit Evropian në vitin 2008, dhe e ka rishikuar atë çdo vit, pas publikimit të Raportit të Progresit.

Më 17 Shkurt 2008, Kosova u shpall shtet i pavarur dhe sovran. Që nga 17 shkurti 2008, njëqind e pesë (105) shtete e kanë njohur Republikën e Kosovës.

Në Tetor 2009, Komisioni Evropian publikoj komunikatën "*Kosova - Përmbushja e Perspektivës së saj Evropiane*" në të cilën Komisioni Evropian ka propozuar thellimin dhe forcimin e perspektivës Evropiane të Kosovës.

Iniciativat kryesore sipas propozimit ishin: (1) Përmirësimi i dialogut politik dhe teknik në Procesin e Dialogut të Stabilizim Asociimit; (2) Dialogu i vizave me perspektivë të liberalizimit eventual të vizave; (3) Zgjerimi i Masave Tregtare Autonome dhe marrëveshja e mundshme tregtare me Bashkimin Evropian; (4) Korniza e marrëveshjes me Kosovën mbi parimet e përgjithshme të pjesëmarrjes së saj në programet e Komunitetit; (5) Aktivizimi i komponentit IPA për bashkëpunim ndër-kufitar (komponenti II).

Në Tetor të vitit 2012, Komisioni Evropian publikoj **Studimin e Fizibilitetit** për Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit në mes të Bashkimit Evropian dhe Kosovës. Studimi i Fizibilitetit konfirmoi se Kosova "*...është kryesisht e gatshme për të filluar negociatat për një Marrëveshje të Stabilizim Asociimit.*"

Megjithatë, në mënyrë që të fillojnë negociatat për MSA-në, Kosova duhet të vazhdojë zbatimin të të gjitha marrëveshjeve të arritura në mes të Beogradit dhe Prishtinës deri më tani dhe të angazhohet në mënyrë konstruktive në kuadër të dialogut për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.

Në këtë drejtim, Komisioni Evropian do të propozojë direktivat negociuese për MSA-në, pasi që Kosova të ketë përmbushur **prioritetet afatshkurtra** në fushën e sundimit të ligjit, administratës publike, mbrojtjes së minoriteteve dhe të tregtisë.

Më 12 Dhjetor 2012, Këshilli i Çështjeve të Përgjithshme të BE-së ka marr parasysh Studimin e Fizibilitetit për MSA në mes të BE-së dhe Kosovës dhe qëllimin e Komisionit për të propozuar

direktivata negociuese për MSA-në, pasi që Kosova të ketë përmbushur prioritetet afatshkurtra, të cilat janë identifikuar në Studimin e Fizibilitetit.

Në këtë kontekst, në muajin prill 2013, Komisioni Evropian publikoj raportin monitorues për zbatimin e kritereve afatshkurtra dhe konfirmoj që Kosova ka përmbushur të gjitha kriteret afatshkurtra për nisjen e negociatave për MSA.

Duke marr për bazë raportin e prillit të Komisionit Evropian, me 28 qershor 2013, samiti Evropian mori vendim për nisjen e negociatave për MSA ndërmjet Kosovës dhe BE-së.

Negociatat për MSA kanë filluar me 28 tetor 2013 me takimin e parë në nivel të Kryenegociatorëve. Negociatat pritet të përfundojnë në pranverë të vitit 2014.

Përveç kritereve afatshkurtra, Studimi i Fizibilitetit identifikoj edhe **kriteret afatmesme** të cilat Kosova duhet të përmbush me qëllim të marrjes përishtë të obligimeve që dalin nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit.

Studimi i Fizibilitetit ka identifikuar 8 prioritetet afatmesme për Kosovën:

1. Sundimi i ligjit;
2. Gjyqesori;
3. Administrata publike;
4. Reforma zgjedhore dhe Kuvendi;
5. Te drejtat e njeriut dhe te drejtat themelore;
6. Mbrojtja e minoriteteve;
7. Tregtia dhe tregu i brendshëm;
8. Fitosanitaria dhe veteriaria.

Duke pas parasysh që është esenciale që këto prioritetet të adresohen me një theks të veçantë dhe vëmendje më të fokusuar politike dhe teknike, ky plan i veprimit në kuadër të aneksit 2 parasheh masat konkrete me qëllim të përmbushjes së 8 prioriteve respektive.

Në Janar të vitit 2012, Komisioni Evropian ka vendosur të fillojë dialogun për **liberalizimin e vizave** me Kosovën. Më 14 Qershor 2012, KE ka dorëzuar udhërrëfyesin për liberalizimin e vizave. Më 1 Shtator 2012, Kosova ka dorëzuar raportin e parë të gatishmërisë në KE. Me 12 shkurt 2013, KE-ja publikoj vlerësimin e parë të zbatimit të udhërrëfyesit për liberalizimin e vizave. Në muajin dhjetor 2013, KE-ja ka realizuar misionet e radhës për vlerësimin e zbatimit të udhërrëfyesit. Pritet që raporti i radhës mbi vlerësimin e zbatimit të udhërrëfyesit të publikohet në pjesën e parë të vitit 2014.

Duke pas parasysh përvojën e mëparshme të anëtarësimit në Bashkimin Evropian, BE-ja ka prezantuar një qasje të re në negociatat për gjyqësorin dhe të drejtat themelore dhe mbi drejtësinë, lirinë dhe sigurinë, dhe i ka dhënë një rol të rëndësishëm çështjeve të sundimit të ligjit, duke përfshirë luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, në qendër të politikës së zgjerimit të BE-së. Qasja e re siguron trajtimin e çështjeve të përmendura në fazat e hershme të procesit të zgjerimit.

Në vazhden e kësaj, KE-ja dhe Kosova kanë nisur **Dialogun e Strukturuar mbi Sundimin e Ligjit** më 30 Maj 2012. Dialogu i Strukturuar do të ofrojë një forum të nivelit të lartë me një objektiv të dyfishtë: (1) vendosja e prioriteteve për reforma në fushën e sundimit të ligjit, dhe (2) monitorimi dhe vlerësimi i rregullt i progresit të Kosovës drejt përmbushjes së prioriteteve. Puna e nën-komitetit të DPSA-së mbi Drejtësinë dhe Punët e Brendshme, si dhe takime të rregullta të Bordit të Përbashkët për Koordinim mbi Sundimin e Ligjit shërbejnë si forume përcjellëse në objektiven e dyfishtë të Dialogut të Strukturuar.

Më 16 Dhjetor 2012, Bordi i Guvernatorëve të **Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim** ka vendosur që të lejojë Kosovën të bëhet anëtare e BERZH-it. Ne qershor 2013, Kosova është anetaresuar edhe ne **Banken Zhvillimore te Keshillit te Evropes**. Me 7 qershor, Kosova ka nenshkruar marreveshjen kornize me **Banken Evropiane per Investime**.

Keto zhvillime nuk janë vetëm shembujet e fundit të përparimit të Kosovës drejt integritimit në komunitetin ndërkombëtar, por keto gjithashtu do të lejojnë që Kosova të përfitojë nga një financim më i madh dhe do të kontribuojë në promovimin e zhvillimit socio-ekonomik të Kosovës.

Në Dhjetor të vitit 2009 Këshilli i Çështjeve të Përgjithshme ka mirëpritur Komunikatën e lëshuar në muajin Tetor të vitit 2009 "*Kosova – Përmbushja e Perspektivës së saj Evropiane*" dhe, në mes të tjerash, ka ftuar Komisionin për të hapur pjesëmarrjen e Kosovës në **programet e Bashkimit Evropian**. Në Dhjetor të vitit 2012, Këshilli i Punëve të Jashtme ka autorizuar Komisionin të hapë negociatat mbi një marrëveshje kornizë në emër të Unionit (BE-së) me Kosovën dhe të kthehet prapa tek Këshilli në gjysmën e parë të vitit 2013. Këshilli ende nuk ka vendosur mbi kete ceshtje.

Që nga viti 2010, Komisioni dhe Kosova kanë përfunduar katër raunde të **Procesit të Dialogut të Stabilizim Asociimit**. Takimet e nën-komitetit të DPSA-së mbahen në shtatë fusha tematike dhe gjetjet e tyre janë të përmbledhura në takimin vjetor plenar të DPSA-së. Që nga viti 2013, ka filluar edhe takimi i veçantë në fushën e administrates publike. DPSA-ja ka dëshmuar të jetë një mekanizëm efektiv për monitorimin dhe këshillimin e Kosovës mbi masat që duhet të ndërmerren për të zbatuar agjendën e saj reformuese Evropiane.

BE-ja mbetet donatori më i madh në Kosovë, duke siguruar më shumë burime për kokë banori në Kosovë sesa në çdo vend tjetër të botës. BE-ja është duke mbështetur Kosovën nëpërmjet dhe **Instrumenti të Asistencës së Para-Anëtarësimit (IPA)**. Nga viti 1999 deri në vitin 2011, BE-ja ka dhënë mbi 2.3 miliardë € të asistencës financiare dhe afërsisht 1 miliard € në mbështetje të pranisë ndërkombëtare në Kosovë.

Për periudhën e ardhshme, 2014-2020, pritet një asistencë në vlerë të përafërt për Kosovën (70 milionë në vit), e cila do të ndahet për sektorët: i) sundimi i ligjit, ii) energjia; dhe iii) bujqësia. Përveç këtyre, do të përkrahen edhe masa horizontale për ngritjen e kapaciteteve institucionale dhe për zhvillimin ekonomik dhe social.

Kosova ka një rrugë të gjatë dhe të vështirë në udhëtimin e saj drejt anëtarësimit të BE. Megjithatë, reformat janë para së gjithash në interes të Kosovës dhe qytetarëve të saj. Ambiciet evropiane të Kosovës gëzojnë mbështetje të fuqishme nga publiku i gjerë në Kosovë.

Studimi i Fizibilitetit i KE-së për vitin 2012 dhe konkluzionet e Keshillit të dhjetorit të vitit 2012 kanë vendosur një rrugë të qartë për pranimin e Kosovës në BE. Në bazë të procesit të zgjerimit të Ballkanit Perëndimor ekziston një numër i madh i hapave formal që do të shënojnë rrugën e integritimit Evropian të Kosovës në BE:

1. Negociatat e MSA-së kanë përfunduar dhe MSA-ja është nënshkruar;
2. Zbatimi i kënaqshëm i MSA-së dhe aplikimi për statusin e kandidatit;
3. Përgjigja e pyetësorit dhe mendimi i KE-së mbi aplikimin (*avis*);
4. Këshilli vendos për dhënien e statusit të kandidatit dhe i jep KE-së mandatin për të filluar bisedimet e pranimit;
5. Shqyrtimi dhe negociimi i kapitujve individual përmes konferencave ndërqeveritare;
6. Përfundimi i negociatave dhe mendimi i KE-së mbi gatishmërinë e Kosovës për të hyrë në BE;
7. Nënshkrimi i Traktatit të Anëtarësimit dhe statusi i shtetit anëtar;
8. Anëtarë i BE-së.

Metodologjia dhe Struktura e Planit të Veprimit të MSA-së

Plani i Veprimit për Marrëveshjen Stabilizim Asociimit paraqet strategjinë kyçe të Qeverisë në rrugën e saj drejt anëtarësimit në BE.

Plani i Veprimit për MSA-n përfaqëson 356 masa, implementimi i të cilave përmbush dy objektiva kyçe: (1) përmbushja kritereve afat mesme dhe (2) zbatimi i detyrimeve që do të merren përsipër nga MSA-ja.

Bazat për përgatitjen e Planit të Veprimit për MSA-në kanë qenë:

- Studimi i Fizibilitetit për Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit në mes të Bashkimit Evropian dhe Kosovës si dhe Stafit shoqëruar në Përpunimin e Dokumentit;
- Prioritetet e Partneritetit Evropian 2008;
- Raporti i Progresit 2013;
- Konkluzionet e Procesit të Dialogut të Stabilizim Asociimit 2013;
- Konkluzionet e Dialogut të Strukturuar mbi Sundimin e Ligjit;
- Udhërrëfyesi për Liberalizimin e Vizave.

Gjatë përgatitjes së Planit të Veprimit për MSA-në, nën koordinimin e Ministrisë së Integritimit Evropian, janë ofruar të dhëna nga të gjitha institucionet shtetërore. Në bashkëpunim të ngushtë me Zyrën e Kryeministrit dhe Ministrinë e Financave, Plani i Veprimit për MSA-në është harmonizuar me Ligjin mbi Buxhetin 2014, Planin Vjetor të Punës së Qeverisë për vitin 2014 dhe Strategjinë Legjislative të Qeverisë për vitin 2014.

Plani i Veprimit për MSA-në është i ndarë në dy pjesë kryesore: (1) përshkrimi dhe (2) tabela e veprimeve.

Pjesa përshkuese e Planit të Veprimit për MSA-në ka tre pjesë: (1) Kriteret Politike; (2) Kriteret Ekonomike; dhe (3) Standardet Evropiane.

Si shtojcë e këtij dokumenti është një tabelë e detajuar e veprimeve që qartazi identifikon objektivat që duhet të plotësohen, masat që duhet të merren, institucionet përgjegjëse, afatin e zbatimit dhe koston financiare.

Plani i Veprimit MSA ka një total prej 356 masave, nga të cilat 129 masa janë nën kapitullin e kritereve politike, 12 nën kapitullin e kritereve ekonomike dhe 215 janë nën kapitullin e standardeve evropiane.

Në përputhje me parimet SMART, janë ngritur tregues të matshëm të nivelit të aktiviteteve. Kostoja e përgjithshme e Planit të Veprimit për MSA-në 2014 është vlerësuar të jetë 598,868,240.54€, nga të cilat 523,520,252.54€ janë planifikuar të mbulojnë nga buxheti kombëtar, ndërsa 69,767,988.00€ nga donatorët. Këtë vit boshllëku financiar është 5,580,000€.

Plani i Veprimit për MSA-në do të shërbejë si strategji kyçe e Qeverisë në rrugën e saj drejt anëtarësimit në BE; si e tillë ajo do të shërbejë si një pikë referimi për institucionet shtetërore kur të vendoset për prioritetet vjetore, planet e rekrutimit, planet strategjike për investime, planet për TI dhe ndërtimin e kapaciteteve njerëzore, ndihmën e donatorëve, si dhe komunikimin dhe aktivitetet informuese.

Monitorimi dhe Rishikimi i Planit të Veprimit për MSA-në

Pasi që të miratohet Plani i Veprimit i MSA-së nga ana e Qeverisë së Republikës së Kosovës, duhet që të dorëzohet për komente tek Komisioni Evropian. Pasi që të merren komentet e KE-së do të jenë pjesë integrale e dokumentit.

Monitorimi i Planit të Veprimit të MSA-së do të bëhet me anë të monitorimit elektronik dhe sistemit të raportimit që është zhvilluar bashkërisht nga Qeveria e Kosovës dhe Komisioni Evropian. Që nga viti 2010, Ministria e Integritimit Evropian ka përdorur bazën sistematike të të dhënave M&R për përgatitjen e raporteve zyrtare për Komisionin Evropian. Për më tepër, që nga viti 2012, Ministria e Integritimit Evropian ka filluar hartimin e raporteve statistikore tremujore që janë diskutuar rregullisht në mbledhjen e Qeverisë.

Në përputhje me praktikën e vendosur, të gjitha veprimet përcjellëse që do të rrjedhin nga cikli i DSPA-së i vitit 2014 do të integrohen në kuadër të sistemit të monitorimit dhe raportimit të Planit të Veprimit për MSA-në.

Strukturat e integritimit për koordinim evropian - Këshilli Ministror, Komiteti Punues dhe 7 Komisione Ekzekutive - do të shërbejnë si një mekanizëm institucional mbështetës që do të mbikëqyrë zbatimin e Planit të Veprimit për MSA-në.

Duke marrë parasysh rëndësinë e dokumentit, Plani i Veprimit për MSA-në do të dorëzohet në Kuvendin e Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.

2. KRITERET POLITIKE

2.1. DEMOKRACIA DHE SUNDIMI I LIGJIT

Legjislativi/Zgjedhjet

Kuvendi ka vazhduar rritjen graduale të kapaciteteve dhe rolit mbikëqyrës ndaj ekzekutivit. Kuvendi ka rritur numrin e debateve parlamentare tematike dhe interpelancat e ministrave. Komisionet kanë ndërmarrë aktivitete të mëtejshme për të monitoruar zbatimin e ligjeve dhe kanë gjeneruar raporte, disa prej tyre të bazuara në vizitat në terren. Për më tepër, hapa konkrete janë ndërmarrë sa i përket rritjes së bashkëpunimit me shoqëri civile në formë të hapjes së një pozite për zyrtar për marrëdhënie me shoqërinë civile dhe koordinim të donatorëve.

Komisioni Qendror Zgjedhor në korrik të këtij viti ka aprovuar 12 vendime dhe Planin Operacional për zgjedhje lokale të Kosovës të cilat janë mbajtur me 3 nëntor. Procesi është konsideruar i rregullt, me dalje në votime prej 47.92% të qytetarëve. Me datën 11 nëntor është bërë edhe certifikimi i subjekteve politike. Me 1 dhjetor është mbajtur rauni i dytë i zgjedhjeve i zgjedhjeve lokale. Procesi zgjedhor është vlerësuar nga të gjithë akterë, vendor dhe ndërkombëtarë, si shumë i sukseshshëm dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Kuvendi ka luajtur rol të rëndësishëm dhe pozitiv në proces të përmirësimit të bashkëpunimit rajonal dhe përmirësimit të marrëdhënieve fqinjësore. Kuvendi, ka miratuar rezolutën për dialogun për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë, si dhe ka ratifikuar këtë marrëveshje në qershor. Në korrik Kuvendi ka miratuar Ligjin për Amnistinë.

Pavarësisht progresit të shënuar, në këtë fushë ende mbesim sfida që duhet adresuar, me theks të veçantë në ngritjen e kapaciteteve në proces të përafrimit të legjislacionit vendor me *acquis*. Po ashtu, sfidë mbetet sigurimi i pavarësisë financiare dhe administrative të Kuvendit; sigurimi i kontrollit të buxhetit sidomos në fusha të tilla si shëndetësia, bujqësia, asistenca sociale, kultura dhe arsimiti. Gjithashtu, sfiduese dhe me prioritet të lartë mbetet përfundimi i reformës zgjedhore dhe kushtetuese.

Me qëllim të adresimit të sfidave të identifikuar, ky plan i veprimit parasheh që gjatë vitit 2014 të përfundohet reforma zgjedhore duke marrë parasysh rekomandimet e Komisionit Evropian si dhe praktikat më të mira nga BE. Gjithashtu, është paraparë të finalizohet dhe miratohet projektligji për Kuvendin në mënyrë që të përforcohet kapaciteti legjislativ i Kuvendit për të siguruar ekspertize legjislative dhe përputhshmëri me *acquis*, të harmonizohet plani legjislativ në mes të Kuvendit dhe Qeverisë si dhe të sigurohet llogaridhënia dhe shqyrtimi i shpenzimeve të buxhetit të Kuvendit. Përveç kësaj, ky plan gjithashtu parasheh pavarësinë buxhetore të Kuvendit dhe fuqizimin e rolit mbikëqyrës të Komisionit për Integritet Evropian në procesin e Integritetit Evropian të Kosovës, si dhe përforcimin e kapacitetit administrativ përmes zhvillimit të planeve strategjike për trajnimin si dhe ngritjes së kapacitetit për Departamentin Ligjor dhe për Çështje Procedurale.

Ekzekutivi

Qeveria e Kosovës ka rritur kapacitetin e saj për adresimin e prioritetëve për procesin e integritetit Evropian përmes ngritjes së kapaciteteve sa i përket zhvillimit dhe koordinimit të politikave si dhe planifikimit strategjik. Për më tepër, Qeveria ka përmirësuar dukshëm proceset në përputhshmëri me rregullat e procedurës dhe kjo është duke u zbatuar nga të gjitha organet kompetente. Gjithashtu, sa i përket koordinimit të procesit të Stabilizim Asocimit, duhet theksuar që janë themeluar strukturat për negocimin e MSA-së. Qeveria ka ndërmarr masa në përmirësimin e proceseve në harmonizim të legjislacionit vendor me *acquis*. Janë hartuar standardet për draftim ligjor, si është në përfundim e sipër është procesi i vlerësimit i kapaciteteve të zyrtarëve ligjor the

zyrtarëve përgjegjës për koordinimin e procesit të integritimit evropian. Për më tepër, ka vazhduar forcimi i kapaciteteve administrative në nivel lokal përmes miratimit të projekt rregulloreve, koncept dokumenteve dhe hartimit të analizave mbi funksionimin e organeve komunale në komuna të reja si dhe funksionalizimit të plotë të Zyrës Administrative të Mitrovicës Veriore.

Pavarësisht progresit të shënuar në këtë fushë, sfidë ende përmirësimi i kapaciteteve të Qeverisë për filtrim të legjislacionit vendor me *acquis*. Gjithashtu, duhet përmirësuar niveli i implementimit të legjislacionit, llogaridhënies dhe transparencës së Qeverisë. Në nivel lokal, sfidë mbetet funksionalizimi i tri (3) komunave veriore (Zubim Potok, Zveçan dhe Leposaviq), të implementohet legjislacioni për vetëqeverisje lokale si dhe të ngritet transparenca e punës dhe vendim-marrjes të nivelit lokal.

Me qëllim të adresimit të sfidave të lartpërmendura, përmes këtij Plani synohet të përmirësohet kapaciteti i Qeverisë për të verifikuar dhe konfirmuar përputhshmërinë e legjislacionit kombëtar me *acquis*, koordinimi dhe planifikimi i përbashkët me Kuvendin si dhe duhet rritur niveli i mbikëqyrjes së ekzekutivit nga Kuvendi. Gjithashtu, ky plan ka për qëllim që t'i përkrahë autoritetet lokale më shumë për të vazhduar procesin e decentralizimit. Për më tepër, në nivel lokal planifikohet të identifikohen aktet ligjore që duhet të harmonizohen me *acquis* nga fusha e vetëqeverisjes lokale si dhe të kompletohet korniza legjislative duke pranuar udhëzime nga niveli qendror.

Administrata Publike

Fusha e administratës publike po zhvillohet në mënyrë progresive si rrjedhojë e prioritizimit të objektivave nga institucionet e Republikës së Kosovës. Progres të shënuar ka pasur sa i përket kompletimit të kornizës ligjore për implementimin e ligjit për shërbim civil, ligjit për pagat e shërbyesëve civil si dhe legjislacionit sekondar me qëllim të implementimit të politikave për reformën e administratës publike. Për më tepër, pas mbajtjes së takimit të parë të Grupit të Veçantë për Reformë të Administratës Publike, është marrë vendim që të ristrukturohet dhe funksionalizohet KNRAP dhe si rrjedhojë tani më ky trup kryesohet nga Ministri i Administratës Publike.

Sa i përket Avokatit të Popullit, është përmbushur plotësisht kriteri afatshkurtër të studimit të fizibilitetit rreth sigurimit të pavarësisë financiare për Institucionin e Avokatit të Popullit, që tashmë është rregulluar dhe është reflektuar në projekt-ligjin e ri për buxhet, si dhe sigurimit dhe ndarjes së hapësirave për këtë institucion për zyrën qendrore në Prishtinë.

Pavarësisht progresit të shënuar, sfidë në këtë fushë mbetet të kompletohet korniza legjislative duke përfunduar në këtë mënyrë me plotësim-ndryshim të Ligjit për Avokatin e Popullit bazuar në rekomandimet e Komisionit të Venedikut. Po ashtu, një sfidë tjetër e cila është adresuar tek MAPL por ende nuk është kryer është ndarja e hapësirave për zyrat rajonale të Institucionit të Avokatit të Popullit. Për më tepër, duhet të miratohen projektligjet mbi procedurat administrative dhe për pagat e zyrtarëve të lartë publik. Rregulloret për organizim të brendshëm dhe sistematizim të punës janë në fazën përfundimtare, megjithatë jo të gjitha institucionet e kanë përmbyllur këtë proces. Në këtë mënyrë do të mundësohej vendosja e sistemit të ri të pagave në pajtim me rregulloren për klasifikim të vendeve të punës. Gjithashtu, mbetet të miratohen edhe planet zhvillimore strategjike për të gjitha institucionet e Qeverisë.

Me qëllim të adresimit të këtyre sfidave, ky Plan parasheh një numër veprimesh që do të ndërmerren gjatë vitit 2014. Së pari, korniza ligjore do të plotësohet përmes miratimit të legjislacionit sekondar si dhe amandamentimit të atij primar si dhe miratimit të planeve zhvillimore strategjike të mbetura. Për më shumë, në mënyrë që të implementohen politikat për reformë të administratës

publike, do të sigurohet ngritje kapacitetesh dhe burime financiare, me theks të veçantë për Departamentin për Menaxhim të Reformës së Administratës Publike si dhe Departamentit për Integrim Evropian dhe Koordinim të Politikave në kuadër të MAP-it. Gjithashtu, do të hartohet Udhërrëfyesi për implementimin e Strategjisë për Reformë të Administratës Publike i cili do të mbulojë një periudhë një vjeçare dhe për synim ka përmbushjen e të gjitha objektivave që derivojnë nga SRAP-i. Pasi që të vendoset sistemi i ri i pagave dhe të miratohet kodi i mirësjelljes për shërbyes civil, hap tjetër kyç në këtë proces planifikohet të jetë finalizimi i vlerësimeve të performancës së shërbyesve civil. Depolitizimi i administratës publike mbetet edhe më tutje sfidë për institucionet e Kosovës, të cilat duhet të ndërmarrin masa urgjente dhe konkrete për t'a adresuar këtë sfidë.

Mbikëqyrja civile e forcave të sigurisë

Sa i përket këtij sektori, duhet theksuar që në korrik të këtij viti Këshilli i Atlantikut të Veriut ka deklaruar që Forca e Sigurisë së Kosovës ka arritur kapacitetin e plotë operacional. Gjithashtu, progres është shënuar për faktin që Komiteti parlamentar mbi Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje i Forcës së Sigurisë së Kosovës ka shqyrtuar me kujdes një numër më të lartë ligjesh se në periudha paraprake.

Pavarësisht progresit në këtë sektor, nevojiten përpjekje të mëtejshme për të siguruar mbikëqyrje adekuate civile të forcave të sigurisë.

Në mënyrë që kjo sfidë të adresohet, ky Plan parasheh finalizimin e Strategjisë të Sigurisë së Kosovës dhe raportimit të rregullt nga Legjislativi sa i përket vlerësimit rreth implementimit të legjislacionit dhe numrit të interpelancave në mënyrë që të sigurohet rritje në kuadër të mbikëqyrjes së sektorit të sigurisë nga ana e komisioneve parlamentare.

Shoqëria Civile

Në fushën e bashkëpunimit me shoqërinë civile, progres është shënuar me përfshirjen e përfaqësuesve lokal të shoqërisë civile në task-forcat për integrim Evropian dhe Këshill Kombëtar për integrimin Evropian. Strategjia e qeverisë dhe plani i veprimit mbi bashkëpunimin me shoqërinë civile për vitet 2013-2017 u përgatit me përfshirjen e përfaqësuesve të shoqërisë civile dhe u aprovuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Organet propozuese të cilat janë bartëse për hartimin e projekt akteve normative, në përgjithësi i realizojnë konsultimet publike me shoqërinë civile.

Sfidë në këtë fushë mbetet që të rritet përfshirja e shoqërisë civile në konsultime publike pasi që në shumicën e rasteve, ministritë e linjës i realizojnë konsultimet publike përmes shpërndarjes së projekt akteve normative në formë elektronike. Financimi publik për shoqërinë civile mbetet ende i kufizuar. Gjithashtu, sfidë mbetet përshkrimi dhe zbatimi i politikave publike në kuadër të bashkëpunimit me shoqërinë civile.

Në mënyrë që të adresohen këto sfida, ky Plan parasheh hartimin e kornizës ligjore për rregullimin e procedurave të kontraktimit të shërbimeve publike dhe për financim të projekteve që zbatohen nga Organizatat e Shoqërisë Civile. Gjithashtu, duhet të themelohet Këshilli Kombëtar për bashkëpunim Qeveri – Shoqëri Civile dhe një sistem mbikëqyrës dhe monitorues për këtë këshill. Ky Plan Veprimi synon rritjen e numrit të konsultimeve publike për hartim të legjislacionit përmes organizimeve të rregullta të tryezave të rrumbullakëta, dialogëve dhe formave tjera të konsultimeve me shoqërinë civile. Përveç rritjes së numrit të konsultimeve publike, synohet të ndërmerren masa që adresojnë veprimet pasuese të dala nga takimet e rregullta me OSHC-të. Ky plan parasheh një bashkëpunim të

Kuvendit dhe shoqërisë civile rreth përputhshmërisë së legjislacionit me *Aquie* si dhe për çështje të tjera që ndërlidhen me provesin e integritetit evropian.

Sistemi gjyqësor

Pavarësia dhe efikasiteti i sistemit gjyqësor paraqet një nga kushtet kryesore për sundimin efikas të ligjit në Kosovë. Në vazhden e përpjekjeve për sigurimin e një kornize gjithëpërfshirëse ligjore, që nga 1 Janari 2013 kanë hyrë në fuqi Kodi i ri Penal dhe Kodi i Procedurës Penale, si dhe është miratuar Ligji për ekzekutimin e sanksioneve penale. Angazhim i madh është bërë edhe për uljen e numrit të rasteve të mbetura në gjykata si dhe rritjen e efikasitetit të sistemit gjyqësor, me ç'rast është miratuar Ligji për Procedurën Përmbartimore si dhe aktet nënligjore që rrjedhin nga ky Ligj, si dhe është miratuar Strategjia Shtetërore për Reduktimin e Lëndëve të Vjetra. Për më tepër është miratuar edhe Ligji për Avokaturën Shtetërore edhe si dhe Ligji për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë së përfituar me vepër penale.

Me qëllim të fuqizimit të bashkëpunimit me EULEX-in është nënshkruar Marrëveshja Kompakte e cila përcakton objektivat e në fushën e sundimit të ligjit, Për më tepër, në drejtim të bashkëpunimit juridik ndërkombëtar, Kosova ka ratifikuar marrëveshjet ndërkombëtare me Shqipërinë dhe Italinë si dhe është në përfundim të procesit të funksionalizimit të bazës së të dhënave dhe ngritjes së masave të sigurisë së dosjeve konfidenciale dhe sigurimit të të dhënave personale.

Progres në këtë fushë është edhe miratimi i strukturës së re organizative të gjykatave me ç'rast me qëllim të finalizimit të kornizës për zbatimin e reformës gjyqësore, KGJK dhe KPK kanë miratuar rregulloret mbi organizimin e brendshëm dhe punën e gjykatave dhe zyrave të prokurorisë. Në kuadër të këtij reformimi janë miratuar edhe rregulloret mbi organizimin e brendshëm dhe veprimin e gjykatave dhe zyrave të prokurorisë. Gjithashtu, në drejtim të implementimit të kornizës ligjore të reformës gjyqësore, KGJK dhe KPK, kanë miratuar Kodet e Etikës, si dhe kanë emëruar të gjithë gjyqtarët si dhe kryeprokurorët e prokurorive themelore dhe të apelit.

Për më tepër KPK dhe KGJK kanë arritur nënshkrimin e memorandumeve të mirëkuptimit me policinë për të garantuar sigurinë e duhur dhe masat mbrojtëse për gjykatësit, prokurorët dhe personelin gjyqësor. Gjithashtu, Instituti Gjyqësor i Kosovës ka organizuar trajnime me qëllim të ngritjes së kapaciteteve të të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve në të gjitha fushat ku ata punojnë. Progres është shënuar edhe në procesin e ndërmjetësimit, ku një numër i konsiderueshëm i rasteve janë zgjidhur përmes këtij mekanizmi dhe janë themeluar zyra për ndihmë juridike në 11 komuna të Kosovës. Gjatë vitit 2012 dhe 2013, më shumë se 300 raste i janë referuar qendrave të ndërmjetësimit, pothuajse gjysma e rasteve kanë përfunduar me sukses gjatë procesit të ndërmjetësimit.

Me gjithë progresin e arritur, sfidë në këtë fushë mbetet miratimi i legjislacionit për certifikimin e përkthyesve gjyqësor si dhe miratimi i pakos së ligjeve të gjyqësorit. Në fushën e bashkëpunimit juridik ndërkombëtar duhet të bëhet më shumë në ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare dhe ngritjen e kapaciteteve që merren me trajtimin e rasteve të ndihmës së ndërsjellët juridike në ngritjen e kapaciteteve dhe përvojës në fushën e bashkëpunimit juridik ndërkombëtar, çështjet e ekstradimitit dhe bashkëpunimit juridik në çështjet penale.

Kurse sa i përket gjyqësorit, sfidë akoma mbetet kompletimi anëtarëve të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, si dhe plotësimi i pozitave vakante për gjyqtarë dhe prokurorë nga komuniteti pakicë duke i ulur kriteret e përzgjedhjes si mekanizëm i qasjes në sistemin gjyqësor. Pritet të bëhet ngritja e kapaciteteve të prokurorëve në trajtimin e rasteve që janë nën juridiksionin e Prokurorisë Speciale. Gjithashtu me qëllim të luftimit të korrupsionit brenda sistemit gjyqësor duhet të zbatohen me

rigorozitet masat e parapara në kodin e mirësjelljes për gjyqtarë si dhe të sigurohet që politikat disiplinore të tregojnë rezultate.

Për më tepër duhet t'i kushtohet rëndësi nominimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve si dhe KPK e KGJK duhet të sigurohen që personat e nominuar të përmbushin kriteret e procesit të emërimit dhe të përfundojnë provimin përgatitor dhe programin e trajnimit fillestar për gjyqtarë dhe prokurorë të organizuar nga IGJK.

Prioritet duhet të mbetet zvogëlimi i numrit të rasteve të mbetura përmes implementimit të Strategjisë Shtetërore për Reduktimin e Lëndëve të Vjetra, prandaj institucionet përkatëse duhet të sigurohen për funksionimin e sistemit të përmbaruesve privat. Në të njëjtën kohë përkushtim i veçantë duhet ti dedikohet përmirësimit të qasjes në mekanizma alternative të zgjedhjes së kontesteve, siç është arbitrazhi si dhe zbatimin e vendimeve civile përmes procedurës së ndërmjetësimit, si dhe emërimi dhe licencimi i noterëve shtesë dhe të administratorëve falimentues. Në këtë kontekst ky plan parasheh mekanizma në qasjen e drejtësisë për viktimat e trafikimit me qenie njerëzore.

Me qëllim të rritjes së efikasitetit të sistemit gjyqësor dhe adresimit të sfidave të identifikuar ky Plan i Veprimit parasheh miratimin e pakos së ligjeve të gjyqësorit, siç janë: Plotësim ndryshimin e Ligjit për Gjykatat, Prokurorin e Shtetit, Këshillin Prokurorial dhe Këshillin Gjyqësor të Kosovës, si dhe plotësim/ndryshimin e projektligjit për Prokurorinë Speciale dhe amandamentimin e Kushtetutës, në mënyrë që procedurat e votimit të përzgjedhjes së anëtarëve të KGJK-së të jenë në pajtueshmëri me rekomandimet e Komisionit e Venedikut. Gjithashtu duhet të sigurohet unifikimi i kriterëve për përzgjedhjen e gjyqtarëve dhe prokurorëve, harmonizimin e akteve nënligjore për implementimin e ligjeve në nivel të gjyqësorit dhe atij prokurorial, si dhe mbetja e provimit përgatitor i organizuar nga IGJK si pjesë e procedurave për nominimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Plani gjithashtu parasheh sigurimin e funksionalizmit të plotë të sistemit të menaxhimit të rasteve dhe koordinimin në distribuimin e lëndëve në mes të gjykatave. Me qëllim të përmbushjes së numrit të gjyqtarëve dhe prokurorëve parashihet sigurimi i alokimit të mjeteve buxhetore për pozita shtesë. Për më tepër, në mënyrë që të sigurohet rrjedhshmëria e punës në gjykata, ky plan parasheh përmirësim në administrimin e gjykatave, finalizimin e renovimit të gjykatoreve të cilat kanë mbetur pa u rinovuar si dhe alokimin e mjeteve për ndërtimin e objekteve të gjykatave themelore siaps Ligjit të ri të gjykatave pasi që objektet aktuale nuk përmbushin nevojat që dalin nga kompetencat e reja të gjykatave themelore. Ndërhyrjet politike duhe të dënohen dhe të evitohen në sistemin gjyqësor dhe prokurorial, kurse është e rëndësishme të merren masa për mbrojtjen e gjyqtarëve dhe prokurorëve si dhe për familjarët e tyre, sipas nevojës.

Politikat kundër korrupsionit

Sa i përket luftës kundër korrupsionit, korniza legislative në këtë fushë është pothuajse e kompletuar. Është amandamentuar Ligji për Financimin e Partive Politike duke adresuar mangësitë ekzistuese, gjithashtu është rishikuar Kodi Penal dhe janë inkorporuar si vepra penale konflikti i interesit si dhe deklarimi i rremë i pasurisë nga zyrtarët publikë. Për më tepër është miratuar Strategjia dhe plani i ri i veprimit anti-korrupsion si dhe strategjia për bashkëpunim ndërinstucional në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit.

Sa i përket ngritjes së kapaciteteve institucionale KPK ka themeluar një rrjet të prokurorëve që merren me rastet e korrupsionit në shtatë zyra prokuroriale përreth Kosovës, si dhe ka funksionalizuar mekanizmin përcjellës për hetimin dhe dënimin e rasteve të korrupsionit dhe krimit

të organizuar ndërmjet institucioneve të zbatimit të ligjit. Gjithashtu progres është arritur edhe në deklarimin e pasurisë nga zyrtarët publik ku vlen të theksohet se gjatë vitit 2012 rreth 99% të zyrtarëve të obliguar e kanë deklaruar pasurinë.

Sfidë në sferën e politikave kundër korrupsionit mbetet zbatimi i kornizës legislative duke arritur rezultate konkrete në luftën kundër korrupsionit. Institucionet përkatëse duhet të vazhdojnë përpjekjet për të siguruar llogaridhënien nga ana e zyrtarëve të nivelit të lartë. Gjithashtu si pjesë e angazhimeve në luftën kundër korrupsionit, duhet të forcohet bashkëpunimi në mes të agjencive përkatëse duke krijuar mekanizma adekuat në vlerësimin e riskut të korrupsionit për sektorët e ndjeshëm, si dhe vlerësimin mbi kompetencat dhe përgjegjësit institucionale të mekanizmave kundër korrupsionit. Për më tepër duhet të intensifikohen përpjekjet për përmbushjen e numrit të prokurorëve që punojnë në Taskforcën kundër korrupsionit në kuadër të prokurorisë speciale, si dhe në sigurimin e hapësirave të nevojshme për punë.

Për të adresuar sfidat në këtë sferë ky plan parasheh plotësim/ndryshimin e Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtar, dhe Ligji për Parandalimin e Konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik. Sa i përket zbatimit të strategjisë kundër korrupsionit parashihet një vlerësim i kostos financiare dhe burimeve të nevojshme për zbatimin efikas si dhe të sigurohen mekanizma detyrues në mënyrë që institucionet të veprojnë në pajtueshmëri me përgjegjësitë e tyre si dhe të kenë përkrahje të vazhdueshme nga niveli i lartë politikë. Si rrjedhojë pritet efikasitet i vazhdueshëm i menaxhimit të bazës së përbashkët të të dhënave në mes të institucioneve të zbatimit të ligjit, për rastet e krimit të organizuar dhe korrupsionit.

Gjithashtu duhet të sigurohet rrjedhueshmëria dhe efikasiteti i punës së Këshilli Kombëtar kundër Korrupsionit. Për më tepër është e një rëndësie të veçantë që të shqyrtohet fakti që deklarimet e rrejshme dhe konflikti i interesit trajtohen ende si kundërvajtje administrative, përderisa Kodi Penal parasheh trajtimin e tyre si vepra penale. Plani parasheh ndërmarrjen e masave në mënyrë që të rritet numri i kallximeve penale të ushtruara për rastet e konfliktit të interesit dhe deklarimit të rrejshëm të pasurisë. Sa i përket ngritjes së kapaciteteve institucionale mbetet sfiduese krijimi i modaliteteve në mes të AKK dhe institucioneve të zbatimit të ligjit në hetimin e rasteve korruptive përmes trajnimeve të specializuara. Në këtë drejtim IGJK ka organizuar një varg trajnimesh për gjyqtarë e prokurorë si dhe profesionist tjerë dhe ka në programin e vet trajnues vazhdimin e mëtejme në organizimin e këtyre trajnimeve.

2.2. Të Drejtat e Njeriut dhe Mbrojtja e Minoriteteve

Institucionet e Kosovës kanë treguar shkallë të lartë të angazhimit dhe përkushtimit për respektimin e të drejtave të njeriut dhe minoriteteve. Si rrjedhojë e këtij përkushtimi, ka vazhduar përmirësimi i kornizës ligjore me miratimin e legjislacionit në fushën e të drejtave të punëtorëve si dhe amandamentimi i kornizës ekzistuese legislative në fushën e lirisë së shprehjes. Gjithashtu është miratuar legjislacioni sekondar për implementimin e Ligjit kundër dhunës në familje, si dhe janë miratuar dhe implementuar masat e nevojshme për zbatimin e legjislacionit në fushën e trashëgimisë kulturore. Për më tepër, është avancuar edhe korniza ligjore në fushën e të drejtave pronësore, por realizimi i të drejtave pronësore nga ana e grave mbetet sfidë e veçantë e cila duhet të adresohet si nga aspekti i rishikimit të legjislacionit, ashtu edhe sa i përket zbatimit të tij.

Me qëllim të zbatimit të kornizës legislative në fjalë, janë miratuar strategji dhe plane veprimi për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, të drejtat e fëmijëve si dhe strategjia për bashkëpunim me shoqërinë civile.

Sa i përket kornizës institucionale, është funksionalizuar Zyra e Koordinatorit për të drejtat pronësore, si dhe është shtyrë mandati i Agjencisë Kosovare për Prona deri në vitin 2016. Në kuadër të ngritjes së kapaciteteve të gjyqtarëve, prokurorëve, stafit të shërbimit korrektues, si dhe me qëllim të ngritjes së kapaciteteve dhe kualitetit të inspektorëve të punës, janë mbajtur një numër trajnimesh për këta zyrtarë.

Me gjithë progresin e shënuar, mbetet një numër i sfidave të cilat duhet të adresohen në këtë fushë, e posaçërisht finalizimi dhe miratimi i pakos së ligjeve për të drejtat e njeriut, reformimi i strukturave institucionale për mbrojtjen e të drejtave të njeriut si dhe zbatimi i rekomandimeve të Avokatit të Popullit nga ana e institucioneve publike të Kosovës. Për më tepër, në fushën e lirisë së shprehjes sfidë mbetet konsolidimi i legjislacionit dhe definimi i fushëveprimit të institucioneve përgjegjëse. Në të njëjtën kohë duhet të bëhet më shumë për përmirësimin e kushteve për të burgosurit, si dhe të luftohen korrupsioni, nepotizmi, kontrabanda dhe diskriminimi brenda sistemit të burgjeve. Gjithashtu duhet të rritet angazhimi për hetimin e rasteve të vjedhjeve dhe vandalizmit ndaj objekteve fetare, sulmeve ndaj komunitetit LGBTI si dhe ato ndaj medieve.

Me qëllim të adresimit të sfidave në këtë sektor, Plani i veprimit parashih një numër masash, duke filluar nga finalizimi i pakos ligjore për të drejtat e njeriut (ku përfshihen Ligji kundër diskriminimit, Ligji për barazi gjinore, për tetraplegjikë dhe paraplegjikë, Ligji për avokatin e popullit, Ligji për mbrojtjen e fëmijëve) si dhe strategjitë dhe planet përkatëse të veprimit për implementimin e legjislacionit në fjalë.

Gjithashtu parashihet edhe përmirësimi i funksionimit të strukturave institucionale që merren me të drejtat e njeriut si dhe mekanizmave institucionalë që zbatojnë rekomandimet e Avokatit të Popullit. Sa i përket të drejtave pronësore parashihet definimi i financimit të Agjencisë Kosovare të Pronave si dhe të rritet numri i stafit dhe fondit në Zyrën e Koordinatorit për të drejta pronësore. Për më tepër, me këtë plan parashihen masa për përmirësimin e shërbimit shëndetësor brenda burgjeve, kategorizimi adekuat i të burgosurve si dhe alokimin e mjeteve të mjaftueshme për financimin e strehimoreve për viktimat e trafikimit dhe dhunës në familje. Sa i përket lirisë së shprehjes, plani i veprimit parashih sigurimin e qëndrueshmërisë financiare për transmetuesin publik RTK, si përmbushjen e numrit të anëtarëve të Komisioni të Pavarur të Medieve dhe numrit të anëtarëve të bordit të RTK-së. Në të njëjtën kohë parashihen masa vetëdijësuese për mos diskriminimin e grave, personave me aftësi të kufizuara dhe anëtarëve të komunitetit LGBTI.

Institucionet e Kosovës duhet të zbatojnë obligimin e tyre kushtetues që në interpretimin e të drejtave të njeriut të respektojnë vendimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Sfidë gjithashtu mbetet zbardhja e fatit të personave të pagjetur dhe zhvillimi i kapaciteteve në fushën e mjeksisë ligjore.

Mbrojtja dhe respektimi i të drejtave të minoriteteve

Progres është shënuar edhe sa i përket mbrojtjes dhe respektimit të drejtave të minoriteteve. Ministria për Komunitete dhe Kthim ka vazhduar implementimin e projekteve për përmirësimin e kushteve të jetesës për anëtarët e minoriteteve në Kosovë si dhe për refugjatët dhe personat e kthyer. Gjithashtu vlerësohet lartë mbyllja e kampit Osterode si dhe funksionalizimi i Këshillave Komunal për Siguri në Bashkësi.

Në vazhden e përkushtimit të treguar është shënuar progres edhe sa i përket të drejtës së përdorimit të gjuhës, me ç'rast është funksionalizuar Zyra e Komisionarit për Gjuhët si dhe është emëruar

Komisionari për Gjuhët, për më tepër ka filluar punën kanali televiziv në gjuhën serbe në kuadër të transmetuesit publik. Sa i përket përfshirjes së minoriteteve në Administratën Publike, ka arritur përqindja e punësimit të tyre deri në 10.29% e të punësuarve.

Në fushën e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore është miratuar UA për themelimin e Këshillit Zbatues dhe Monitorues i cili tanimë është funksional si dhe janë hartuar direktivat për vlerësimin e përfshirjes dhe integritetit të trashëgimisë kulturore në planifikimin urban dhe hapësinor të nivelit lokal.

Me gjithë angazhimin e treguar sa i përket mbrojtjes së minoriteteve, sfidë mbetet implementimi i Strategjisë dhe Planit të veprimit për komunitetin RAE, e në veçanti alokimi i buxhetit të përshtatshëm për këtë komunitet si dhe rritja e bashkëpunimit në mes të nivelit qendror dhe atij lokal. Në të njëjtën kohë duhet të vazhdohet me angazhimin për përmirësimin e qasjes së refugjatëve dhe personave të zhvendosur në pronat e tyre dhe shërbime publike, si dhe tu ofrohen mundësi më të mëdha ekonomike. Sfidë mbetet akoma konsolidimi i kornizës strategjike për rregullimin e vendbanimeve joformale. Përkushtim më i madh duhet të tregohet gjithashtu sa i përket planifikimit hapësinor për trashëgimi kulturore dhe të ndërmerren masa konkrete për luftimin e ndërtimeve ilegale në zona të mbrojtura.

Plani i veprimit parasheh një mori masash për përmirësimin e kushteve të jetesës për minoritetet, e një ndër to është edhe miratimi i strategjisë së re për Komunitete dhe Kthim. Në të njëjtën kohë, përkushtim i veçantë duhet të tregohet për mbylljen e kampit së Leposaviqit si dhe për trajtimin e fëmijëve të kontaminuar me plumb. Plani gjithashtu parasheh masa për rritjen e numrit të nxënësve në shkolla nga komunitetet si dhe hartimin e kurrikulave në gjuhën serbe. Gjithashtu pritet themelimi i Këshillit lokal për implementimin e Ligjit për Hoqën e Madhe si pjesë e angazhimit për implementimin e legjislacionit për trashëgimi kulturore.

2.3 Çështjet Rajonale dhe Obligimet Ndërkombëtare

Në kuadër të dialogut për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, të lehtësuar nga BE-ja, me 19 prill 2013, u arrit Marrëveshja e parë për parimet që qeverisin normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Kjo Marrëveshje është plotësuar nga një plan veprimi gjithëpërfshirës të hartuar në maj të këtij viti. Gjithashtu, me 28 shkurt është amendamentuar Statuti i Këshillit Rajonal për Bashkëpunim Rajonal (KBR) në mënyrë që të reflektojë me ndryshimin e fundit për këtë institucion, pra anëtarësimin e Kosovës si anëtare e plotë dhe e barabartë. Qeveria e Republikës së Kosovës ka përmbushur kontributin vjetor financiar për KBR-në me datën 5 prill të këtij viti.

Përkundër progresit të shënuar në këtë fushë, sfidë mbetet të emërohet koordinatori i ri kombëtar i Kosovës në KBR. Sfidë gjithashtu mbetet zbardhja e fatit të personave të pagjetur dhe zhvillimi i kapaciteteve në fushën e mjekësisë ligjore.

Në mënyrë që këto sfida të adresohen, ky plan parasheh kompletimin e kornizës ligjore me miratimin e akteve ligjore dhe nënligjore që kanë të bëjnë me fushën për mjekësi ligjore si dhe persona të zhdukur. Gjithashtu, ky Plan parasheh përmirësimin e kapaciteteve të Qeverisë përmes trajnimeve dhe specializimeve të stafit aktual dhe rekrutimit të ekspertëve mjeko-ligjorë në mënyrë që të plotësohen standardet e kërkuara për rimarrjen, analizimin dhe identifikimin e qëndrueshëm dhe adekuat të mbetjeve të njerëzve. Për më shumë, gjatë vitit të ardhshëm, parashihet të emërohet koordinatori i ri kombëtar që do të përfaqësojë Kosovën në KBR.

3. KRITERET EKONOMIKE

3.1 Ekzistenca e Ekonomisë Funktionale të Tregut

Politikat Ekonomike Esenciale

Institucionet e Kosovës kanë implementuar me sukses politika të matura ekonomike që kanë rezultuar me përmbushjen e objektivit të ruajtjes së stabilitetit makro-ekonomik dhe konsolidim fiskal. Kjo ka qenë veçanërisht e rëndësishme marrë parasysh trendin e zhvillimeve ekonomike në vendet evropiane dhe në regjion përfshirë këtu efektet e krizës globale në rritjen ekonomike dhe financat publike në disa nga këto vende. Në pjesën e parë të vitit, është aprovuar Korniza Afatmesme e Shpenzimeve (KASH) për periudhën 2014-2016.

Performanca makroekonomike është vlerësuar pozitivisht edhe nga disa misione të stafit teknik të FMN-së që janë bërë në kuadër të vlerësimit të Marrëveshjes Stand-By. Zhvillime shumë pozitive janë bërë sa i përket marrëdhënieve të vendit me institucionet financiare ndërkombëtare. Kosova është anëtarësuar në Bankën Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD), në Bankën Zhvillimore të Këshillit të Evropës, si dhe ka nënshkruar Marrëveshjen Kornizë me Bankën Evropiane për Investime (EIB). Në tetor është mbajtur takimi i dytë i Mekanizmit të Mbikëqyrjes Fiskale mes Qeverisë së Kosovës dhe Komisionit Evropian.

Në kuadër të përgatitjeve për Programin Ekonomik-Fiskal të para-anëtarësimit, Plani i Veprimit parasheh realizimin e disa aktiviteteve të cilat në dy vitet e ardhshme synojnë ngritjen e kapaciteteve për hartimin dhe implementimin efektiv të këtij program.

Stabiliteti makroekonomik

Rritja reale e Bruto Produktit Vendor (BPV) ka qenë 2.5% në vitin 2012, ndërsa BPV për kokë banori ka arritur në 2,721 Euro në vitin 2012. Konsumi final i ekonomive shtëpiake vazhdon të jetë komponenti kryesor i BPV-së, me rreth 90.5% i përcjellur nga investimet totale me rreth 28.2%

Inflacioni i çmimeve të konsumit në vitin 2012 ishte 2.5%, i ndikuar kryesisht nga lëvizja e çmimeve ndërkombëtare të ushqimit dhe naftës. Shkalla e papunësisë sipas Anketës së Fuqisë Punëtore të ASK-së ishte 30.9% në gjysmën e dytë të vitit 2012. Ndërsa, sipas të dhënave të MPMS, në fund të vitit 2012 kishte rreth 260 mijë të regjistruar si të papunë apo rreth 21% më pak se një vit më parë. Mbi 57% e të papunëve janë nga kategoria e të pakualifikuarve.

Sektori financiar vazhdon të jetë stabil. Edhe pse i dominuar nga bankat në pronësi të huaja, sektori bankar ka qenë likuid pasi që operacionet e bankave janë të financuara kryesisht nga depozitat vendore. Në vitin 2012, asetet e sektorit financiar arritën vlerën 3.8 miliardë euro (78.2% e BPV). Raporti kredi-depozita qëndroi në 78.6% në mars të 2013.

Bilanci tregtar është karakterizuar me një deficit tregtar prej rreth 41.9% e BPV edhe në vitin 2012. Bilanci tregtar pritet të ketë tendencë për një rënie të vogël në periudhën 2012-2015 si rezultat i rritjes më të shpejtë të eksportit të mallrave dhe tregtisë së shërbimeve. Deficiti i llogarisë rrjedhëse në vitin 2012 ishte 7.7% e BPV që paraqet nivelin më të ulët në vitet e fundit. Për dallim nga tregtia e mallrave, tregtia e shërbimeve vazhdon performancën pozitive. Kjo kategori pati rritje vjetore prej rreth 30% në 2012. Ndërsa në tremujorin e parë të 2013 suficiti i kësaj llogarie u rrit edhe për 25%. Edhe llogaria e të ardhurave dhe trasfereve ka vazhduar me trend rritës në vitin 2012. Llogaria kapitale dhe financiare edhe pse mbeti në bilanc pozitiv, në vitin 2012 pësoi një rënie prej rreth 66% krahasuar me vitin paraprak kryesisht si pasojë e rënies së investimeve të huaja direkte.

Deficiti buxhetor u rrit krahasuar me 2011 duke shënuar 2.6% të BPV në vitin 2012. Shpenzimet e përgjithshme buxhetore në vitin 2012 ishin rreth 29.1% e BPV. Kategoria e shpenzimeve kapitale ka mbetur në nivelin e njëjtë të vitit paraprak (11% e BPV). Edhe kategoria e pagave ka qenë gati e njëjtë me vitin paraprak, ndërsa subvencionet dhe mallrat e shërbimet kanë pasur një rritje në vitin 2012. Të hyrat e përgjithshme ishin rreth 26.7% e BPV në këtë vit. Të hyrat nga doganat u rritën me 2.1% në vitin 2012 edhe pse me një ritëm më të ngadalshëm sesa që ishin parashikuar. Ndërsa të hyrat vendore u rritën me 9% më shumë se në vitin paraprak. Ndërsa në 6 mujorin e parë të vitit 2013, të hyrat vendore u rritën për 10% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

Për të rritur qëndrueshmërinë e financave publike dhe për të mbështetur politika fiskale stabile, në harmoni me rekomandimet e FMN-së, në Ligjin e rishikuar për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë është inkorporuar rregulla fiskale që limiton deficitin buxhetor vjetor në 2% të Bruto Produktit Vendor. Ngjashëm, në kuadër të reformës fiskale janë amandamentuar Ligji për TVSH-në dhe Ligji për Administratën Tatimore dhe Procedurat.

Plani i Veprimit parasheh implementimin e rregullës fiskale nga viti 2014. Institucionet po ashtu kanë në plan të ndërmarrin masa që kontribuojnë në menaxhimin dhe monitorimin efikas të borxheve publike përfshirë këtu aprovimin në Qeveri të Strategjisë Afatmesme të Borxhit Publik, Strategjinë Vjetore dhe publikimeve të rregullta të raporteve periodike të borxhit. Kosova duhet që edhe më tutje të përmirësojë politikat fiskale makroekonomike me qëllim të zhvillimit ekonomik.

Ndërveprimi i forcave të tregut

Spektori privat ka vazhduar të zgjerohet në vazhdimësi që nga viti 2009. Si konsumi ashtu edhe investimet private të shprehura në raport me BPV, pas një rritje konsekuative, në 2012 kanë mbetur në nivel afërsisht të njëjtë me vitin paraprak (10,7% dhe 26.1% e BPV respektivisht) me tendencë rënëse në pjesën e parë të 2013.

Ndërmarrjet publike qendrore dhe regionale kanë vazhduar përmirësimin e performancës së tyre. Shumica e ndërmarrjeve publike, kanë operuar me fitim në vitin 2012. Ka përfunduar me sukses privatizimi i Kompanisë së Distribuimit dhe Furnizimit me Energji Elektrike (KEDS). Po ashtu, këtë vit janë përmbyllur procedurat teknike dhe ofertimi financiar i përzgjedhjes së fituesit për privatizimin e Postës dhe Telekomit të Kosovës. Konsorciumi Axos Capital GMBH dhe Najafi Company është përzgjedhur si oferta më e mirë. Sidoqoftë, nënshkrimi i kontratës së blerjes nuk është bërë ende.

Sa i përket privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore, rreth 54 ndërmarrje janë futur në procesin e privatizimit. Gjithsej 11 kontrata spin-off dhe 44 marrëveshje likuidimi janë përmbyllur me një vlerë prej 10,151,682 dhe 5,363,233 respektivisht. Kanë përfunduar të gjitha procedurat e likuidimit për 4 ndërmarrje, ndërsa janë iniciuar procedurat e likuidimit për 53 NSh për të cilat janë emëruar autoritetet e likuidimit.

Sidoqoftë, sfidë kryesore në këtë fushë mbetet përshpejtimi i procesit të likuidimit të ndërmarrjeve shoqërore dhe përfundimi i privatizimit të ndërmarrjeve të mbetura.

Në këtë kontekst, Plani i Veprimit parasheh masa konkrete për vendosjen e ndërmarrjeve në procesin e likuidimit, shqyrtimin e kërkesave eventuale të kreditorëve dhe arkëtimin e distribuimin e fondeve të likuidimit.

Hyrja dhe dalja nga tregu

Në periudhën shtator 2012-prill 2013 rreth 6,560 biznese të reja janë regjistruar (rreth 5.3% e numrit total të bizneseve). Ndërsa 876 biznese kanë shuar veprimtarinë e tyre në periudhën e njëjtë. Në periudhën maj-shtator të 2013 janë regjistruar gjithsej 2,463 biznese të reja dhe janë shuar 428 biznese.

Gjatë vitit 2012 janë ndërmarrë edhe një varg masash në kuadër të reformës së Të Bërit Biznes përfshirë edhe eliminimin e një varg licencash dhe barrierash për bizneset. Këto masa kanë ndikuar pozitivisht në përmirësimin e ambientit të biznesit të reflektuara edhe në ngritjen e Kosovës në ranglistën e “Të Bërit Biznes 2014” të Bankës Botërore. Po ashtu, janë hapur edhe tri qendra komunale që ofrojnë shërbime “one stop shop” për bizneset duke e rritur numrin e këtyre qendrave në gjithsej 28. Institucionet janë duke punuar për finalizimin e regjistrimit të bizneseve që do të bëjë të mundur kalimin nga sistemi i klasifikimit NACE Rev1 në NACE Rev2.

Edhe përkundër progresit të bërë, kjo fushë ende ballafaqohet me shumë sfida dhe pengesa, sidomos sa i përket ambientit rregullativ dhe sistemit efikas ligjor, konkurrencës dhe mungesës së qasjes në financa.

Plani i Veprimit parasheh një varg masash në kuadër të vazhdimin të reformës së të bërit biznes dhe përmirësimit të ambientit të biznesit. Institucionet synojnë të vazhdojnë me aktivitetet për zvogëlimin e barrierave për biznes me fokus të veçantë në nivelin komunal. Po ashtu, do të vazhdojnë masat për lehtësimin e hyrjes në treg të bizneseve përmes ofrimit të shërbimeve online të regjistrimit, pagesës së tatimeve dhe unifikimit të numrit të bizneseve. Gjithashtu duhet ndërmarrë disa masa për përmirësimin e të bërit biznes, siç janë konsolidimi i qasjes në financa, përmirësimin e furnizimit me energji elektrike, krijimin e një konkurrence të ndershme dhe luftimin e korrupsionit.

Sistemi ligjor

Sa i përket masave në sistemin ligjor që lidhen me ambientin e biznesit dhe kapacitetet administrative në funksion të bizneseve, është shënuar progres i konsiderueshëm në infrastrukturën pronësore. Korniza ligjore është zhvilluar më tej me adoptimin e ligjit të ndërtimeve dhe ligjit për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunave. Janë zgjidhur një numër i madh i kontesteve pronësore si dhe janë realizuar me sukses procedurat e administrimit të pronave.

Institucionet kanë filluar me implementimin e regjistrimit elektronik të pronave të luajtshme. Me këtë regjistër janë digjitalizuar regjistrimi i këtyre pronave, tarifat, si dhe certifikatat digjitale. Progres është shënuar edhe sa i përket regjistrimit të transaksioneve të pronës dhe rritjes së numrit të hipotekave për qëllime kreditore. Kjo konfirmohet edhe nga pozicionimi i Kosovës mbi mesataren e regjionit në raportin e Të Bërit Biznes të Bankës Botërore 2014.

Sidoqoftë, sektori akoma ballafaqohet me sfida sa i përket zhvillimit dhe implementimit të kornizës legjislative. Zbatimi i kësaj infrastrukture është një tjetër sfidë që ndikon në ambientin e biznesit.

Në kuadër të Planit të Veprimit janë paraparë masa që synojnë të përmirësojnë çështjet pronësore në funksion të një ambienti më të përshtatshëm për biznes.

Zhvillimet në sektorin financiar

Asetet totale të sektorit financiar në fund të 2012 ishin 3.8 miliard euro. Sistemi financiar përbëhet nga bankat komerciale, kompanitë e sigurimeve, fondet pensionale, institucionet mikrofinanciare

dhe institucionet financiare jobankare. Ky sektor është i dominuar nga sektori bankar i cili përbëhet nga 9 banka komerciale. Struktura e aseteve të sistemit bankar dominohet nga kreditë. Ndërsa raporti kredi-depozita u rrit nga 79.9% në 2011, në 80.6 në 2012.

Niveli i kapitalizmit vazhdon të jetë i lartë, treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit në dhjetor të 2012 ishte 14.42% (krahasuar me 17% në periudhat e mëhershme) edhe përkundër kërkesave të reja rregullative të kapitalit për rrezikun operacional . Në qershor të 2013 treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit qëndroi në 15%, që është mbi nivelin e kërkuar nga rregullatori. Treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit sipas kërkesave rregullative duhet të jetë së paku 12%.

Sistemi bankar vazhdon të karakterizohet me nivel të kënaqshëm të likuiditetit dhe të jetë profitabil. Indikatorët e kthimit mesatar në asete dhe kthimit mesatar në kapital ishin pozitiv edhe pse me një rënie në vitin 2012 krahasuar me vitin paraprak. Niveli i kënaqshëm i likuiditetit reflektohet edhe në raportin kredi-depozita, i cili në qershor të 2013 qëndroi në 83% që është mbi nivelin e rekomanduar. Raporti i kredive jo-performuese ka qenë 7.5% në dhjetor të 2012. Ky tregues u rrit lehtë në gjashtëmuorin e parë të 2013, duke arritur në 7.8% në qershor 2013, krahasuar me vendet tjera të regjionit ku ka pësuar një rritje të konsiderueshme.

Gjithsej kreditë e lëshuara nga sistemi bankar në 2012 arritën në 1.76 miliardë euro. Ndërsa, depozitat e sistemit bankar të njëjtin vit arritën në 2.28 miliard euro.

Institucionet kanë aplikuar një qasje të matur për të ruajtur qëndrueshmërinë e sistemit bankar, e shprehur në mënyrë të vazhdueshme edhe përmes nivelit të lartë të adekuatshmërisë së kapitalit. Përveç kësaj, Banka Qendrore e Kosovës vazhdimisht bën analiza stres-test të sistemit bankar, të fokusuar në veçanti në riskun kreditor dhe riskun e likuiditetit.

Ndërsa tregu i sigurimeve përbëhet nga 13 kompani në fund të vitit 2012 të cilat ofrojnë sigurime jetë dhe produkte të sigurimeve jo-jetë. Pjesëmarrja e sistemit të sigurimeve në sektorin financiar në vitin 2012 ishte e ulët me rreth 3.4% e gjithsej aseteve financiare (ose 2.7% e BPV)

Në kuadër të zhvillimit të mëtutjeshëm të kornizës ligjore të sistemit financiar, Plani i Veprimit parasheh adoptimin e legjislacionit të nevojshëm primar dhe atij sekondar për implementimin e kornizës rregullatore të sigurimeve, pagesave , mbikëqyrjes bankare dhe pensioneve. Kjo do të ndikojë edhe në përafrimin e mëtutjeshëm të legjislacionit me atë të BE-së në këtë fushë. Plani parasheh edhe zhvillimin e rregullativës së nevojshme për mbikëqyrjen e tregut të letrave me vlerë.

3.2. Kapaciteti i Përballjes me Presion Konkurrues dhe Forcat e Tregut Brenda Bashkimit Evropian Kapitali njerëzor dhe fizik

Sa i përket kapitalit njerëzor, ka vazhduar reforma në sistemin e arsimit. Institucionet kanë bërë investime të konsiderueshme në zhvillimin e infrastrukturës fizike dhe politikave gjithëpërfshirëse. Ministria e Arsimit ka ndarë në buxhetin e vitit 2012 mbi gjysmë milioni euro për programet e hulumtimit, financim të projekteve të vogla shkencore, mbështetje studimeve të doktoraturës dhe publikime shkencore.

Në arsimin dhe aftësimin profesional, janë zgjeruar dhe pajisur Qendrat e Aftësimin Profesional me pajisjet e nevojshme për ofrimin e disa programeve profesionale. Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve ka verifikuar dhe akredituar një varg programesh profesionale.

Sistemi i Menaxhimit Informativ të punësimit është plotësuar me harduer dhe module softuerike duke u bërë një databazë plotësisht operative e punësimit. Me qëllim të zbutjes së papunësisë afatgjatë, shërbimet publike të punësimit kanë vazhduar aktivitetet e ndërmjetësimit të punëkërkesve përmes projekteve publike dhe skemave të trajnimit profesional.

Në lidhje me kapitalin fizik, treguesit e investimeve publike dhe private tregojnë se janë rritur investimet edhe private edhe publike. Në vitin 2012, investimet private ishin rreth 1 miliard euro, ndërsa ato publike ishin rreth 550 milionë euro.

Investimet publike kanë qenë të orientuara në ndërtimin dhe modernizimin e infrastrukturës rrugore. Autostrada kryesore është tashmë në përfundim të punimeve ndërsa kanë nisur punimet edhe në zgjerimin e disa rrugëve regjionale.

Përkundër këtyre zhvillimeve pozitive, në fushat e kapitalit njerëzor dhe fizik ende mbetin shumë sfida në zhvillimin adekuat të tyre. Ndër to janë edhe pamjaftueshmëria e kapaciteteve dhe laboratorëve shkencor dhe siguria e kualitetit në fushën e arsimit. Investime të konsiderueshme në kapital njerëzor janë të nevojshme për të mbështetur zhvillimin social dhe kërkesat e tregut të punës.

Me qëllim të adresimit të disa prej këtyre sfidave, institucionet kanë paraparë disa masa në kuadër të Planit të Veprimit. Ndër to janë edhe aktivitetet për përmirësimin e qasjes dhe cilësisë së arsimit dhe aftësisë profesionale në linjë me kërkesat e tregut. Këtu përfshin edhe zhvillimi dhe licencimi i kurrikulave dhe programeve të aftësisë profesionale dhe pajisja e Qendrave të Aftësisë Profesionale me mjete dhe hapësira të nevojshme. Po ashtu plani fokusohet edhe në forcimin e lidhjeve të domosdoshme të bashkëpunimit midis institucioneve arsimore dhe ndërmarrjeve. Me qëllim të zhvillimit ekonomik duhet të forcohet sundimi i ligjit, të bëhet evitimi i ekonomisë joformale dhe të krijohet një kornizë e politikave e mirëfilltë zhvillimore.

Struktura sektoriale dhe e ndërmarrjeve

Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM) vazhdojnë të dominojnë strukturën e ndërmarrjeve me rreth 99% të numrit të përgjithshëm të ndërmarrjeve. Ndërsa struktura e ndërmarrjeve sipas pronësisë dominohet nga bizneset individuale me rreth 88% pasuar nga ndërmarrjet me përgjegjësi të kufizuar me rreth 7.4% të të gjitha ndërmarrjeve. Struktura sektoriale e ndërmarrjeve të reja vazhdon të dominohet nga tregtia me rreth 29.5% sipas statistikave të tremujorit të tretë të 2013 (rreth 31% në shtator 2012) pasuar nga hoteleria dhe restorantet.

Me gjithë progresin e bërë për përmirësimin e ambientit të biznesit, sektori ende ballafaqohet me shumë vështirësi. Kosto dhe qasja në financa, ekonomia jo-formale dhe zbatimi i dobët i ligjit janë ndër sfidat kryesore në këtë fushë.

Në përpjekje për të adresuar disa nga këto sfida, institucionet kanë paraparë disa masa në Planin e Veprimit. Rritja e fondit për garantimin e kredive dhe shtimi i fondeve për subvencionimin e NVM-ve synojnë të zbusin sadopak koston dhe qasjen në financa të ndërmarrjeve. Hartimi i një programi për parandalimin e ekonomisë informale bashkë me planin implementues që do të involvonte kontribut ndërinstitucional është një tjetër masë që targeton ekonominë informale.

Ndikimi i shtetit në konkurrencë

Tarifat e energjisë elektrike dhe mbeturinave kanë vazhduar të caktohen nga rregullatorët respektiv. Ka përfunduar me sukses privatizimi i Kompanisë së Distribuimit dhe Furnizimit me Energji Elektrike (KEDS). Po ashtu, këtë vit janë përmbyllur procedurat teknike dhe ofertimi financiar i

përzgjedhjes së fituesit për privatizimin e Postës dhe Telekomit të Kosovës. Konsorciumi Axos Capital GMBH dhe Najafi Company është përzgjedhur si oferta më e mirë. Edhe në këtë periudhë ka vazhduar subvencionimi i projekteve kapitale dhe mbulimi i kostos në sektorin e energjisë, subvencionimi i shpenzimeve të mazutit për ngrohje qendrore, dhe subvencionimi i sektorëve të hekurudhave dhe shërbimeve të ujit.

Sidoqoftë, korniza institucionale për monitorimin dhe aprovimin e ndihmës shtetërore është ende e pa funksionalizuar plotësisht.

Për përafrimin e mëtejshëm të ndihmës shtetërore me acquis, Plani i Veprimit parasheh zhvillimin e legjislacionit primar dhe sekondar. Po ashtu, në aspektin institucional Plani parasheh edhe masa për funksionalizimin e Zyrës së Ndihmës Shtetërore.

Integrimi ekonomik me BE

Ekonomia e Kosovës ka mbetur relativisht e hapur edhe në vitin 2012. Sipas treguesit të hapjes së ekonomisë i matur si proporcion i shkëmbimit tregtar me BPV, shkalla e hapjes së ekonomisë ishte rreth 71%. Eksporti për në vendet e BE ishte më i vogël se në 2011 duke shënuar 39.6% e eksportit total. Edhe sa i përket importit, vendet e BE-së janë partneri kryesor i Kosovës me rreth 41.6% të gjithsej importeve. Pas vendeve të BE-së, CEFTA është partneri më i rëndësishëm tregtar i Kosovës me rreth 37% të eksporteve dhe 34% të importeve të përgjithshme të vendit, kurse vendet e BE-së mbeten investitorët më të mdhenj në Kosovë.

4. STANDARDET EVROPIANE

4.1. Tregu i Brendshëm

4.1.1. Lëvizja e Lirë e Mallrave

Sa i përket zhvillimit të kapaciteteve ligjore, institucionale, si dhe administrative, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë ka shënuar përparim të theksuar në fushën e lëvizjes së lirë të mallrave. Korniza ligjore është plotësuar tutje me miratimin e tetë direktivave të hartuara sipas qasjes së re dhe katër prej tyre sipas qasjes së vjetër në përputhje me direktivat e BE-së. Po ashtu janë miratuar disa udhëzime administrative dhe rregullore teknik.

Korniza institucionale e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë ka pësuar një ri-strukturim të theksuar përbrenda njërive të saj me qëllim të funksionalizimit të plotë dhe ngritjes së efektshmërisë, e cila është hartuar në bazë të praktikave më të mira të BE-së dhe shembujt e marra nga vendet e tjera. Më në detaje, Departamenti i Tregtisë është ristrukturuar dhe përfshinë tri divizione: Divizioni për Marrëveshjet Tregtare, ai i Mbrojtjes së Tregtisë, si dhe i Politikave Tregtare; janë themeluar dy njësi të veçanta: një për mallrat strategjike dhe një për rezervat e detyrueshme të naftës; Zyra e Pronësisë Industriale dhe Departamenti i Metrologjisë janë transformuar në nivelin e agjencive; Departamenti i Buxhetit dhe Financave është vendosur si divizion nën Departamentin e Financave dhe Shërbimet e Përgjithshme; Departamenti i Mbrojtjes së Konsumatorit është themeluar si njësi e veçantë; si dhe Divizioni i Infrastrukturës së Cilësisë është themeluar si një njësi e veçantë në kuadër të Departamentit të Industrisë. Këshilli Ndërmintor për Politika Tregtare është zëvendësuar me Këshillin Kombëtar për Zhvillim Ekonomik, i cili ka themeluar grupin e nivelit teknik, i ashtuquajtur Grupi Punues për Politika Tregtare (GPPT).

Përkundër arritjeve në fushën e legjislacionit dhe kapaciteteve institucionale, pjesë e sfidave të cilat do të adresohen në Planin e Veprimit, mbetet përafrimi i mëtejshëm i legjislacionit vendor me acquis të BE-së, në veçanti përafrimi i legjislacionit në fushën e sigurisë së produkteve. Ngjashëm, mbetet të përmirësohen kapacitetet administrative dhe profesionale, si dhe koordinimi i agjencive të ndryshme të cilat janë aktive në këtë fushë.

Në funksion të adresimit të sfidave në këta sektorë, në këtë Plan të Veprimit janë paraparë një varg aktiviteteve. MTI të vazhdojë me përmirësimin dhe ristrukturimin i cili do të përfshijë Agjencinë për Promovim të Investimeve dhe Agjencinë për Mbështetjen e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme, të cilat do të bashkohen dhe do të krijohet si Agjenci për Zhvillim të Sektorit Privat. Inspektorati i Tregut do të funksionalizohet në tërësi duke i përfshirë edhe inspektorët komunal të cilët do të jenë pjesë e inspektimit të rregullt të tregut në të gjitha komunat e Kosovës.

Në drejtim të përmirësimit të mekanizmave për konsultim me palët e interesuara të politikave tregtare, GPPT do të organizojë takime të rregullta brenda GPPT si dhe nëngrupet për Shërbime, Industri, Bujqësi, Marrëveshje Tregtare dhe Lehtësim të Tregtisë. Në kuadër të kësaj, do të përfshihet edhe pjesëmarrja aktive e komunitetit të biznesit dhe shoqërisë civile. Për më tepër, do të realizohen takime të rregullta të komisioneve ekzekutive relevante.

Me qëllim të monitorimit të rregullt të zbatimit të Marrëveshjes mbi Hapësirën për Tregti të Lirë të Evropës Qendrore (CEFTA) dhe aktivitetet në kuadër të CEFTA-s, MII do të vazhdojë me mbledhjen e të dhënave në teren nga bizneset me formularët për barriera tarifore dhe jo-tarifore, identifikimi i tyre, si dhe më pastaj adresimin e këtyre sfidave me qëllim të eliminimit të tyre. Lidhur me këtë, autoritetet përgjegjëse përbrenda MII-së do të jenë pjesëmarrëse të rregullta të nën-grupit në takimet e CEFTA-s, si dhe do të organizojnë takimet e rregullta me bizneset vendore me qëllim të lehtësimit dhe mënjanimin të barrierave tarifore.

Tregtia me mallra industriale

Sa i përket prioriteteve tregtare të Kosovës, MTI ka përcaktuar në bashkëpunim me autoritetet përgjegjëse tregtare të Turqisë produktet industriale dhe bujqësore të cilat do të jenë të përfshira në kuadër të tregtisë së lirë, siç janë produktet 8-shifrore sipas Sistemit të Harmonizuar të cilat janë të importuara në Kosovë nga Turqia; listën e produkteve të liberalizuar plotësisht sipas kërkesës së Turqisë; si dhe pjesën tjetër të produkteve të mbetur dhe produktet e tjera industriale. Gjithashtu, në kuadër të përgatitjeve për liberalizim të tregut vendor lidhur me aspektet negociuese të MSA-së, MTI ka përgatitur listën e produkteve industriale të ndjeshme dhe ato bujqësore me 2, 4 dhe 8 shifra sipas Sistemit të Harmonizuar.

Standardizimi, Akreditimi, Vlerësimi i Konformitetit, Metrologjia dhe Mbikëqyrja e Tregut

Standardizimi

Agjencia Kosovare për Standardizim (AKS) si institucion kyç në fushën e standardeve, ka miratuar legjislacionin përkatës të Këshillit Profesional të Standardizimit. Numri i standardeve kosovare të miratuara sipas standardeve Evropiane (EN) është mjaft i lartë edhe për periudhën e kaluar. Në këtë aspekt, tregu kosovar është duke u plotësuar gradualisht me standardet e nevojshme.

Megjithatë, në këtë fushë ende mbeten disa sfida në lidhje me ngritjen e kapaciteteve ligjore dhe ato institucionale në funksion të ngritjes së efektshmërisë së punës së AKS-së.

Për të adresuar këto sfida, AKS do të vazhdojë ecurinë e punës së adaptimit të rreth 1,400 standardeve të reja, përkthimin e standardeve kosovare të aprovuara në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës, si dhe organizimin e disa aktiviteteve me qëllim të ngritjes së vetëdijes së bizneseve për zbatimin e standardeve në fuqi.

Akreditimi

Korniza ligjore në fushën e akreditimit është plotësuar më tej, duke përfshirë edhe miratimin e Udhëzimit Administrativ të amandamentuar Nr. 19/2012 mbi formën, përmbajtjen dhe përdorimin e emblemës së Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit të Kosovës (DPAK).

Në aspektin institucional, kapacitetet janë zhvilluar më tej përmes zgjerimit të Laboratorit për Kontrollin e Cilësisë së Produkteve Farmaceutike, rekrutimit të punonjësve, si dhe trajnimit profesional të stafit përgjegjës.

Me gjithë arritjet e realizuara deri më tani në fushën e akreditimit, pjesë sfiduese e DPAK mbetet avancimi i bashkëpunimit evropian në këtë drejtim. Në funksion të adresimit të kësaj çështje, DPAK do të zhvillojë tutje aktivitetet profesionale për arritjen e Marrëveshjes me institucionin përgjegjës Evropian të Akreditimit (European Co-operation for Accreditation).

Vlerësimi i Konformitetit

Kjo fushë ka shënuar progres të konsiderueshëm. Janë miratuar katërbëdhjetë rregulloreve mbi kërkesat teknike (nëntë të mbuluara nga direktivat e qasjes së re, pesë nën direktivat e qasjes së vjetër), si dhe dy rregullore mbi produktet që përbëjnë rrezik për konsumatorët (njoftimi dhe shkëmbimi i shpejtë i informacionit).

Në kuadër të zhvillimeve institucionale të fundit, është bërë akreditimi i një organi të inspektimit të produkteve të naftës (ISO 17020) dhe pesëmbëdhjetë laboratorëve testues të cilat janë akredituar në përputhje me standardet evropiane EN/ISO. Gjithashtu është bërë çertifikimi i dy laboratorëve inspektues dhe dy organeve inspektuese në përputhje me standard EN/ISO në fushën e lëndëve

djegëse me bazë të naftës. Zhvillimet tjera pozitive përfshijnë përfundimin e laboratorit për magnitudë elektrike me sistemin e matjes për testimin e njehsorëve të energjisë elektrike dhe të 24 krahasuesve me klasën e saktësisë së lartë të 0,01 për kalibrimin e etalonëve të sistemit matës dhe referent.

Me gjithë zhvillimet pozitive, institucionet duhet të fokusohen në zhvillimin e kapaciteteve administrative dhe implementuese.

Me qëllim të adresimit të sfidave në këtë fushë, Plani parasheh transpozimin e direktivave dhe rregulloreve teknike mbi vlerësimin e konformitetit. Fillimisht, do të zhvillohet një studim mbi zbatimin e rregulloreve teknike të transpozuar në Kosovë, si dhe raportimi mbi zbatimin e tyre në praktikë. Ndërsa, pjesë e transpozimit të direktivave dhe rregulloreve teknike do të jenë një varg direktivash për produkte dhe pajisje të ndryshme. Gjithashtu, DPAK do të vazhdojë me mbikëqyrjen e vazhdueshme të Trupave të Vlerësimit të Konformitetit (TVK-të), shtimin e numrit të tyre, si dhe organizimin e takimeve të rregullta të trupave koordinues të procesit të akreditimit.

Metrologjia

Korniza legjislative në fushën e metrologjisë është zhvilluar më tej me qëllim të përafrimit me acquis të BE-së, përfshirë adoptimin e disa Udhëzimeve Administrative të cilat përfshijnë tarifatat e agjencisë, peshat dhe kërkesa për testim.

Në funksion të përmirësimit të bashkëpunimit ndërshtetëror, Agjencia e Metrologjisë së Kosovës (AMK) ka nënshkruar Memorandum të Mirëkuptimit me autoritetet përgjegjëse të Turqisë dhe Shqipërisë në fushën e metrologjisë.

Me gjithë zhvillimet e theksuara në fushën e metrologjisë, sfidë mbeten kapacitetet administrative përfshirë aftësinë për të përfituar nga asistencat teknike e ofruar. Kjo ngase disa laboratorë janë themeluar në Prishtinë dhe Prizren, mirëpo funksionet e tyre nuk janë plotësisht në përputhje me standardet e kërkuara të cilësisë.

Duke pasur në fokus përmirësimin e këtyre ngecjeve, AMK do të vazhdojë veprimtarinë e saj për kalibrimin e etanoleve, mirëmbajtjen dhe sigurimin e funksionalizimit të laboratorëve ekzistues, si dhe krijimin e laboratorëve të rinj të metrologjisë. Ndërsa, në vazhden e ngritjes së kapaciteteve profesionale të stafit dhe nivelit të efektshmërisë, do të bëhet rekrutimi i stafit të rinj, trajnimi profesional i tyre dhe funksionalizimi i plotë i mbikëqyrjes metrologjike me qëllim të përmirësimit të kualitetit të ofrimit të shërbimeve në laboratorët ekzistues. Laboratorët e krijuar në Prishtinë dhe Prizren duhet të jenë funksional dhe në përputhje me standardet e nevojshme cilësore.

Mbikëqyrja e Tregut

Ka vazhduar zhvillimi i infrastrukturës ligjore me qëllim të përafrimit me acquis të BE-së. Në funksion të kësaj janë amandamentuar Ligji për Inspektoratin e Tregut si dhe Ligji mbi Sigurinë e Përgjithshme të Produkteve.

Në funksion të mbrojtjes së të drejtave të pronësisë intelektuale dhe luftimit të piraterisë, janë realizuar marrëveshjet e bashkëpunimit me njësitë doganore për verifikimin e produkteve jo-ushqimore industriale, si dhe me Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

Mbikëqyrja e Tregut në vete ngërthen një spektër mjaft të gjerë të tregut, e cila ende sfidohet me ngecje mbi kapacitetet administrative, profesionale dhe ekspertiza mbi përmirësimin e zbatimit të legjislacionit në fuqi mbi sigurinë e produkteve.

Me qëllim të adresimit të sfidave në këtë fushë, Inspektorati Kosovar i Mbikëqyrjes së Tregut do të zhvillojë trajnime profesionale për inspektorët e tregut lidhur me zbatimin e direktivave dhe rregulloreve teknike të produkteve industriale jo ushqimore, si dhe rekrutimin e inspektorëve të rinj. Ndërsa lidhur me aspektin administrativ, është duke u krijuar databaza për shkëmbim të informacioneve, konform RAPEX-it.

Mbrojtja e Konsumatorit

Në këtë sektor janë bërë hapa të rëndësishëm pozitiv si në aspektin e legjislacionit, ashtu edhe në aspekt të kapaciteteve institucionale dhe të implementimit të politikave. Është aprovuar Ligji për Mbrojtjen e Konsumatorit. Ligji në fjalë, i rregullon dhe mbron të drejtat themelore të konsumatorit gjatë blerjes së mallrave, shërbimeve dhe formave tjera në tregun e lirë si dhe detyrimet e shitësit, prodhuesit dhe furnizuesit.

Gjithashtu, në funksion të implementimit të legjislacionit është aprovuar Plani i Zbatimit të Programit për Mbrojtjen e Konsumatorit për periudhën 2014-2016. Krahas kapaciteteve institucionale, me strukturimin e brendshëm të MTI-së është themeluar Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorit i cili përveç tjerash propozon, harton dhe siguron zbatimin e dokumenteve strategjike dhe legjislacionin përkatës. Me vendim të qeverisë së Republikës së Kosovës është themeluar Këshilli për Mbrojtjen e Konsumatorit, i cili përbehet nga shtatë anëtar duke përfshirë Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë, përfaqësuesit e biznesit, shoqërinë civile dhe një ekspert të pavarur. Për organizimin e punës dhe fushëveprimin të Këshillit, së fundmi është nxjerr Rregullorja për Punën e Këshillit për Mbrojtjen e Konsumatorit.

Përkundër përparimit të dukshëm në këtë sektor, mbeten ende një numër sfidash për tu adresuar. Përkushtim të plotë kërkon kompletimi i akteve dytësore, që do të plotësonin kornizën ligjore. Si rrjedhojë, sfiduese mbete edhe monitorimi i zbatimit të Programit për Mbrojtjen e Konsumatorit. Edhe me tutje nevojitet ngritja e kapaciteteve të stafit, si dhe ngritja e vetëdijes së konsumatorëve për të drejtat e tyre. Njëkohësisht, monitorimi dhe shqyrtimi i ankesave të konsumatorëve drejtuar Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorit kërkon korrektësi dhe angazhim të vazhdueshëm.

Me qëllim të adresimit të sfidave në këtë sektor, Plani i veprimit parasheh një numër masash që duhet ndërmarr. Në kuadër të kompletimit të kornizës ligjore, parashihet nxjerrja e UA-së për Shitje me Aksion dhe Mallra me Defekt, si dhe hartimi dhe aprovimi i Rregullores 2006/2004 për bashkëpunim në mes të autoriteteve përgjegjëse për zbatimin e legjislacionit të konsumatorit. Më tutje, zbatimi i Programit për Mbrojtje të Konsumatorit do të monitorohet përmes raporteve periodike dhe takimeve të Këshillit për Mbrojtjen e Konsumatorit. Me që rast, do të ilustrohen arritjet dhe ngeçjet në zbatim të programit në fjalë. Si tërësi, ndërmarrja e hapave të sipërm do të ishte vështirë e realizueshme, po qe se nuk merret parasysh kapaciteti administrativ dhe profesional i stafit kompetent. Si rrjedhojë, Plani i veprimit parasheh trajnime për ngritje profesionale të stafit në fushën e mbrojtjes së konsumatorit. Përveç tjerash do të organizohen edhe aktivitete me qëllim të ngritjes së vetëdijes së konsumatorëve në përgjithësi për të drejtat e tyre dhe veprimtarinë e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorit. Paralelisht, monitorimi dhe shqyrtimi i ankesave të konsumatorëve parashihet të bëhet përmes numrit total të ankesave të pranuar duke analizuar numrin e ankesave të zgjidhura dhe atyre që mbeten në shqyrtim e sipër. Sa i përket kësaj fushe, Ministria dhe agjencitë e tjera kompetente, duhet të kenë një koordinim më të mirë mes tyre, dhe

gjithashtu të përmirësojnë kapacitetet administrative dhe profesionale të cilat sigurojnë zbatim më të mirë të legjislacionit.

4.1.2. Lëvizja e lire e punëtoreve, shërbimeve dhe e drejta e themelimit

E drejta e themelimit

Korniza ligjore është plotësuar me miratimin e Ligjit për Tregti të Jashtme si dhe Ligjit për Masat Mbrojtëse në Importe. Progres është bërë edhe sa i përket lehtësirave në kuadër të reformës së të bërit biznes, përfshirë thjeshtësimet sa i përket regjistrimit të biznesit. Është larguar dispozita që kërkon depozitim fillestar të kapitalit minimal për kompanitë me përgjegjësi të kufizuar; kapitali fillestar për kompanitë aksionare është ulur në 10,000 €; është hequr po ashtu tarifa për regjistrimin e biznesit. Janë hapur 28 qendra që ofrojnë shërbime të ndryshme për bizneset.

Megjithatë, e drejta e themelimit është ende në një fazë të hershme të zhvillimit. Përafrimi i legjislacionit vendor me standardet evropiane mbi tregtinë e shërbimeve dhe të drejtën e kompanive dhe nevoja për ngritjen e kapaciteteve administrative mbeten pjesë sfiduese për institucionet e Kosovës.

Andaj, në funksion të plotësimit të kornizës ligjore si dhe përafrimit të mëtejshëm të legjislacionit vendor me acquis të BE-së, institucionet përgjegjëse të Republikës së Kosovës planifikojnë ndryshim-plotësimin e Ligjit për Shoqëritë Tregtare, si dhe plotësimin e legjislacionit parësor përmes miratimit të Udhëzimeve Administrative përkatëse në këtë fushë.

Tregtia e shërbimeve

Infrastruktura ligjore mbi shërbimet është plotësuar tutje me miratimin e Ligjit mbi Tregtinë e Jashtme (duke përfshirë tregtinë e shërbimeve), si dhe Ligjin mbi Mbrojtjen e Konsumatorit (që mbulon shitjen e produkteve dhe ofrimin e shërbimeve, si dhe shërbimeve financiare të konsumatorit).

Në funksion të avancimit të kapaciteteve institucionale në fushën e tregtisë së shërbimeve, MTI ka krijuar bazën e të dhënave të shërbimeve, e cila është në fazat fillestare dhe ka nevojë për të dhëna shtesë. Autoriteti i Kualifikimeve të Kosovës ka ndërtuar hapat e saj drejt zhvillimit me rastin e miratimit dhe regjistrimit të gjashtë kualifikimeve profesionale në sistemin e Kosovës, e cila është në përputhje me kornizën evropiane të kualifikimeve. I njëjti ka akredituar dymbëdhjetë ofrues të programeve të aftësimit profesional.

Edhe përkundër një progresi të lehtë në këtë drejtim, përafrimi i legjislacionit vendor me acquis të BE-së është në një fazë të hershme dhe ka disa kufizime për shtetasit e vendeve të treta në ofrimin e shërbimeve në Kosovë. Më në detale, institucionet përgjegjëse janë duke negociuar liberalizimin e tregtisë së shërbimeve përbrenda CEFTA-s. Pjesë tjetër sfiduese në këtë fushë mbetet përafrimi mbi njohjen reciproke të kualifikimeve profesionale dhe programeve të aftësimit profesional të cilat mbeten ende të kufizuara.

Me synim të lehtësimit të ofrimit të shërbimeve në treg, Plani planifikon të adresojë reduktimin e disa sfidave përmes një mori veprimesh. Kjo synohet të realizohet përmes përafrimit të mëtejshëm të legjislacionit vendor me atë të BE-së, më detalisht fillimin e procesit të transpozimit të Direktivës së Shërbimeve në legjislacionin vendor përmes inicimit të miratimit të një ligji përkatës vendor. Po ashtu, në këtë kontekst, do të bëhet një analizë mbi tregtinë e shërbimeve përmes së cilës do të bëhet identifikimi i mangësive dhe ngecjeve kyçe në këtë drejtim dhe efekti i tyre në tregtinë vendore.

Lëvizja e lirë e punëtorëve

Lëvizja e lirë e punëtorëve, veçanërisht pjesa në lidhje me ofrimin e mundësisë së punësimit të shtetasve të huaj në Kosovë është duke u ndërtuar dhe përafuar gradualisht me standardet e BE-së. Ligji për dhënien e lejeve për punë dhe punësimin e shtetasve të huaj në Republikën e Kosovës është abroguar dhe provizionet e tij që kanë të bëjnë me punësimin e të huajve janë bartur në Ligjin e ri për të huajt. Në bazë të procedurave të parapara me legjislacionin, edhe në vitin 2012 institucionet kanë përcaktuar numrin e lejeve të punës për të huajt. Ndërsa në fushën e sigurimeve sociale, janë përmbyllur me sukses marrëveshjet për njohjen bilaterale të së drejtës pensionale me Maqedoninë dhe me Malin e Zi.

Sidoqoftë, legjislacioni në këtë fushë është ende në fazën fillestare të zhvillimit. Sfidues mbeten kapacitetet e limituara në këtë fushë dhe përafrimi i mëtejshëm i legjislacionit me *acquis*.

Plani i Veprimit parasheh masa përmes të cilave institucionet do të zbatojnë legjislacionin ekzistues dhe zhvillojnë atë më tutje. Në vazhden e krijimi të platformës administrative për Koordinim të limituar të Sistemeve të Sigurimeve Sociale, do të përcaktohet numri i lejeve të punësimit për personat e huaj për vitin e ardhshëm, përcaktimi i statistikave për nevojat afatshkurtra dhe afatgjata të fuqisë punëtore të huaj në Kosovë, si dhe do të bëhet përcaktimi i numrit të nevojshëm të punonjësve për rekrutim të punëtorëve të vendeve të treta në tregun kosovar të punës. Qeveria e Kosovës edhe më tutje do të fokusohet në ngritjen e kapaciteteve institucionale për Koordinim të limituar të Sistemeve të Sigurimeve Sociale. Më saktësisht, do të funksionalizohet nga MPMS, Komisioni Koordinues për Marrëveshjet Bilaterale në fushën e Sigurimeve Sociale. Me qëllim të zgjerimit të tregut të punëtorëve, do të zhvillohen negociatat me shtetet partnere me qëllim të lidhjes së Marrëveshjeve Bilaterale në fushën e Sigurimeve Sociale.

4.1.3. Lëvizja e Lirë e Kapitalit

Sa i përket kornizës legjislative, ka pasur progres të konsiderueshëm në zhvillimin e legjislacionit primar dhe sekondar në harmoni me standardet ndërkombëtare për pagesat dhe lëvizjen e lirë të kapitalit. Është adoptuar Ligji për pagesat si dhe janë aprovuar një varg rregullash e rregulloresh për implementimin e legjislacionit të sistemit financiar, bankar dhe të sigurimeve. Po ashtu, Republikës së Kosovës i është caktuar një kod shtetëror nga SWIFT – i, i cili kod do të mundësojë kryerjen e rregullt të pagesave mes institucioneve financiare dhe bankare vendore dhe atyre të vendeve të huaja.

Mirëpo edhe pse janë bërë përpertime të mëdha në këtë sektor, sfida mbetet reforma e mëtutjeshme për avancimin e mbikëqyrjes financiare, më konkretisht kërkesave të Bazel II për mbikëqyrjen bankare dhe direktivat e BE-së dhe avancimi i kornizës ligjore në harmoni me standardet e BE-se. Institucionet duhet të përfundojnë rishikimin funksional të rregullativës në këtë fushë.

Plani parasheh një varg aktiviteteve me qëllim të avancimit të mbikëqyrjes financiare në pajtim me Standardet Basel II/III për Banka dhe Solvenca II për Sigurimet. Ligji i përgjithshëm mbi Sigurimet është në fazën finale të përgatitjes, gjithashtu do të bëhet rishikimi i manualeve ekzistuese mbikëqyrjes bankare dhe mbikëqyrjes së sigurimeve, për t'i përafuar me standardet dhe direktivat e BE-se, si dhe do të bëhet përafrimi i rregullativës së Mbikëqyrjes pensionale dhe manualeve të mbikëqyrjes së pensioneve në harmoni me EIOPA (European Insurance and Occupational Pensions Authority), direktivat e BE-se dhe IOPS (International Organization of Pension Supervisors), dhe do të hartohet rregullativa mbi mbikëqyrjen e tregut të letrave më vlerë.

4.1.4. Doganat dhe Tatimet

a. Doganat

Dogana e Kosovës karakterizohet me legjislacion të avancuar që është gjerësisht në përputhje me kodin doganor të BE-së. Për të implementuar këtë legjislacion në mënyrë efektive, është miratuar Plani Strategjik 2013-2015. Doganat kanë vazhduar implementimin e Kornizës së Strategjisë Operative 2012-2014 (KSO) si dokument trevjeçar që orienton njësitë operative të doganave në përmbushjen e objektivave.

Sa i përket kapaciteteve institucionale dhe bashkëpunimit ndër-institucional, është miratuar Procedura Standarde e Operimit (PSO) për analizën e rrezikut të përbashkët midis Doganës, Policisë dhe Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë, kjo u pasua me miratimin e PSO për operacionin e përbashkët të tri agjencive kufitare brenda Qendrës Koordinuese Kombëtare për kontrollin kufitar. Gjithashtu është miratuar Kodi i Etikës për zyrtarët kufitarë.

Janë ndërmarrë një varg aktiviteteve dhe një numër të operacioneve kundër kontrabandës dhe krimin të organizuar. Me qëllim që të rritë bashkëpunimin ndërkombëtar doganor Kosova ka nënshkruar tre marrëveshje dypalëshe. Sistemi elektronik i doganave ASYCUDA Eorl është plotësisht operacional. Njëkohësisht, shkëmbimi sistematik elektronik i të dhënave (SSED) është plotësisht operacional në mes të doganës të Kosovës dhe Doganave të Shqipërisë, Maqedonisë dhe Malit të Zi.

Objektet kufitare të Merdares dhe Vërmicë janë modernizuar dhe ndërtimi i garazhit për ekzaminim të hollësishëm në Vërmicë ka përfunduar. Përveç kësaj, gjashtë pikat kufitare me Serbinë janë bërë funksionale në përputhje me dispozitat të memorandum mirëkuptimi dhe protokollin teknik të dakorduar në negociatat mes dy vendeve.

Përkundër arritjeve të mëdha nga Dogana, ende mbesin disa sfida të tilla si lufta kundër aktiviteteve joformale, sidomos në vijën kufitare mes Kosovës dhe Serbisë. Sfidë për doganat gjithashtu është që të siguron grumbullimin e plotë të të hyrave të projektuara. Trajnimet e mëtejshme të stafit dhe rritja e kapaciteteve është e nevojshme për lehtësimin e tregtisë dhe bashkëpunimit doganor.

Që të adresohen sfidat e doganës të Kosovës një numër masash do të merren të përfshira edhe në planin e veprimin. Njësitë anti-kontrabandë të doganave do të intensifikojë angazhimin e tyre, në të njëjtën kohë dogana do të ngrit bashkëpunimin me agjencionet tjera të zbatimit të ligjit për të luftuar aktivitetet joformale, veçanërisht në vijën kufitare me Serbinë. Doganat e Kosovës do të siguron grumbullimin e plote të të hyrave të projektuara duke ndërmarrë masa dhe duke bërë raporte tremujore. Ndërsa për të ngritur kapacitetet administrative dogana do të mbaj trajnime brenda dhe jashtë vendit bazuar në bashkëpunim me Agjencitë tjera relevante për ngritjen e kapaciteteve dhe zhvillimit profesional të stafit.

b. Tatimet

Në kuadër të reformës fiskale, janë aprovuar ndryshim plotësimet e legjislacionit tatimor konkretisht *Ligji për Administratën Tatimore dhe Procedurat*, *Ligji për Tatimin në të Ardhurat Personale*, *Ligji për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave*, *Ligji për Tatimin Mbi Vlerën e Shtuar dhe Ligji për Lojërat e Fatit*.

Është miratuar rregullorja mbi pagesën e pagave dhe mëditjeve të kryesuesit dhe anëtarëve të Bordit të Pavarur Shqyrtues për ankesa, Komisioneve të Auditimit dhe Këshillit të Raportimit Financiar të Kosovës.

Sa i përket kapaciteteve institucionale, autoritetet tatimore kanë ndërmarrë një sërë aktiviteteve për të ngritur përmbushjen vullnetare dhe për të luftuar evazionin tatimor. Aplikacioni i ri për menaxhimin e rasteve të mbledhjes së detyrueshme (SMRM) është bërë plotësisht operacional. Gjithashtu, një ekip është krijuar që të merret kryesisht me zbatimin e procedurave për mbledhjen e borxheve të ndërmarrjeve në pronësi shoqërore. Numri i tatimpaguesve që kanë deklaruar tatimet e tyre përmes sistemit elektronik EDI është rritur ndjeshëm. Administrata tatimore dhe Agjencia e Regjistrimit të Biznesit kanë nënshkruar një memorandum mirëkuptimi për të lehtësuar regjistrimin e biznesit. Njëkohësisht, sistemi i ATK-së është ndërlidhur me sistemet e informimit të 8 institucioneve të tjera qeveritare.

Edhe përkundër arritjeve ende mbetin sfida që ndërlidhen me zhvillimin në fushën e tatimeve. Zbatimi i legjislacionit tatimor mbetet një sfidë për autoritetin tatimor. Njëkohësisht autoritetet tatimore duhet të jetë në gjendje për të përshtatur politikat dhe për të identifikuar mjete për të luftuar ekonominë joformale dhe evazionin tatimor. Me qëllim të rritjes së efikasitetit të teknologjisë informative, sistemi aktual (SIGTAS) duhet të zëvendësohet nga një infrastrukturë moderne si dhe struktura tatimore duhet të jetë më shumë në përputhje me atë të BE-së.

Sa i përket Bordit të Pavarur, përkundër progresit të evidentuar në zgjidhjen e ankesave teknikisht nuk mund të shqyrtohen të gjitha ankesat me këtë strukturë të Bordit deri në afatin e parapare me ligjin e mëparshëm (fund viti 2013). Prandaj është plotësua ndryshimi i ligjit me afat për zgjidhjen e ankesave deri në fund të vitit 2014.

Sfidat e Administratës Tatimore janë adresuar në Planin e Veprimit nëpërmjet një sërë masash dhe aktiviteteve. ATK do të plotësojë legjislacionin primar dhe sekondar në mënyrë që të zhvillojë më tutje legjislacionin tatimor. Për të luftuar evazionin tatimor do të organizohen fushata mediale për informimin e tatimpaguesve lidhur me obligimet tatimore, vizita dhe kontrole me qëllim parandalimin e dështimit të përmbushjes së obligimeve tatimore si dhe vizita vëzhguese të rastit. ATK gjithashtu ka nevojë për Asistencë teknike të donatorëve për të siguruar furnizimin me një sistem informativ bazë dhe asistencë teknike dhe financiare në ndërtimin/zhvillimin e mëtutjeshëm dhe integrimin me nën-sistemet ekzistuese informative në ATK.

Ndërsa, që të forcohet Bordi i Pavarur për Rishqyrtime dhe Ankesa do të kompletohet me anëtarë nga Kuvendi i Kosovës njëkohësisht duke iu ofruar përkrahje administrative për bordin edhe nga MF gjë që do të rezultojë në zvogëlimin e numrit të rasteve që presin zgjidhje.

4.1.5. Konkurrenca

Zhvillimet e fundit në këtë sektor kanë të bëjnë me zhvillimin e legjislacionit dytësor për implementimin e Ligjit për Ndihmë Shtetërore. Për këtë qëllim është aprovuar Rregullorja mbi Procedurat dhe Format e Njoftimit mbi Ndihmën Shtetërore. Rregullorja përcakton procedurat për njoftimin e ndihmës shtetërore, në rast të ndihmës së paligjshme, skemave ekzistuese si dhe procedurave raportuese dhe monitoruese. Autoriteti Kosovar i Konkurrencës duke u bazuar në Ligjin për Mbrojtje të Konkurrencës ka zhvilluar aktivitete të ndryshme duke përfshirë: vendime në lidhje me marrëveshjet e ndaluara, aktivitete monitoruese, rekomandime për institucionet relevante për raste abuzimi me pozitë dominuese si dhe ka dhënë opinione në lidhje me draft legjislacionin për institucionet e ndryshme të vendit. Sa i përket zhvillimeve institucionale, është themeluar komisioni për Ndihmë Shtetërore, si dhe janë emëruar anëtarët e saj.

Me gjithë progresin e shtuar, ky sektor vazhdon të ballafaqohet me sfida të mëdha të cilat janë kyçe për përmbushjen e obligimeve të Kosovës ndaj Komisionit Evropian. Sfiduese është vlerësuar kompletimi i kornizës ligjore për mbrojtje të konkurrencës. Përkundër faktit që Ligji për Ndhimë Shtetërore ka me pak se dy vite që ka hyrë në fuqi, është cilësuar që përmbajtja e tij duhet të plotësohet dhe ndryshohet krahas legjislacionit të BE-së. Në ndërkohë, sfidues mbetet monitorimi i vazhdueshëm i zbatimit të ligjit aktual për ndihme shtetërore. Autoriteti Kosovar i Konkurrencës ka nevojë të rris kapacitetin e tij, duke u fokusuar në ekspertizë dhe përvojë të stafit. Përveç kësaj, sfiduese vlerësohet edhe emërimi i katër anëtarëve të ri të Komisionit Kosovar të Konkurrencës, duke ditur që në mungesë të tyre, AKK do të jetë praktikisht jo funksionale. Për më tepër, rregullat e konkurrencës dhe mbrojtja e tyre duhet të promovohen më tepër me qëllim të ndërgjegjësimit të akterëve relevant.

Plani i veprimit parasheh adresimin e sfidave të lartcekura duke filluar nga aprovimi i Ligjit të plotësuar dhe ndryshuar për Mbrojtje të Konkurrencës pasuar me aprovimin e legjislacionit sekondar përkatës. Do të ndërmerren masa konkrete për ndryshimin dhe plotësimin e legjislacionit parësor dhe dytësor për Ndhimë Shtetëror. Njëkohësisht, ky plan parasheh monitorimin e zbatimit të ligjit në fjalë përmes disa aktiviteteve, përfshirë mbajtjen e një regjistri mbi zbatimin e ligjit, kontrollimin e mjeteve të ndara të ndihmës, marrjen e vendimit për kthimin e mjeteve dhe përgatitjen e raportit vlerësues për ndihma. Sa i përket ngritjes së kapaciteteve, ky plan parasheh emërimin e katër komisionarëve të Autoritet Kosovar të Konkurrencës nga Kuvendi i Kosovë si dhe rekrutimin e stafit për ndihme shtetërore, ku si rrjedhojë do të bëhet edhe funksionalizimi i zyrës për ndihmë shtetërore.

4.1.6. Prokurimi Publik

Legjislacioni për Prokurim Publik është pasuruar edhe më tutje me legjislacion dytësor, me që rast është nxjerr Udhëzime Administrativ (UA) mbi dorëzimin e planifikimeve për prokurim dhe informatave plotësuese si dhe UA për qartësimin e bazës ligjore për zbatimin e procedurave të prokurimit. Hapa zhvillimor janë ndërmarr nga Organi Shqyrtues i Prokurimit dhe Agjencia Qendrore e Prokurimit, ku si rrjedhojë dy institucionet kanë miratuar rregulloret e brendshme të punës.

Në kuadër të ngritjes së kapaciteteve, staf i ri profesional dhe administrativ është punësuar në Komisionin Rregullativ për Prokurim Publik (KRPP) dhe Organin Shqyrtues për Prokurim (OSHP). Me qëllim që të ketë trajtim korrekt dhe profesional ndaj ankesave të operatoreve ekonomik drejtuar OSHP-së, ky i fundit ka bërë rekrutimin e eksperteve të jashtëm, të cilët angazhohen në bazë të specifikave të ankesës. Përveç kësaj, stafi aktual është trajnuar mbi prokurim publik nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike, me që rast janë certifikuar 530 prej 600 zyrtarëve.

Përkundër arritjeve të deritanishme, ky sektor vazhdon të ballafaqohet me sfida të cilat kërkojnë vullnet dhe përkushtim të plotë të institucioneve kompetente. Korrupsioni në prokurim publik vlerësohet si shqetësues, dhe si i tillë po përkeqëson perceptimin publik mbi transparencën dhe drejtësinë e prokurimit publik në vend. Vëmendje të plotë kërkon edhe përgatitja e qartë e specifikave teknike në publikimin e tenderëve duke pasur parasysh që një numër i rasteve kthehen në rivlerësim dhe ri-tenderim. Gjithashtu, sfiduese konsiderohet forcimi i menaxhimit të kontratës dhe kapaciteti planifikues i saj.

Angazhim i mëtutjeshëm nevojitet për adresimin e sfidave në këtë fushe përfshirë edhe ngritjen e kapaciteteve humane dhe administrative në institucionet kyçe të prokurimit publik. Me theks të veçantë, sfiduese konsiderohet emërimi i bordit të OSHP-së, i cili nga Gushti 2013 është

jofunksional si rezultat i skadimit të mandatit të tre anëtareve të bordit drejtues. Krahas kësaj, vazhdon me qenë sfidë emërimi i Drejtorit të AQP-së. Ky i fundit edhe më tutje është duke ngecur në ushtrimin e plotë të mandatit të tij, si rezultat i mos aprovimit të listës së shërbimeve dhe furnizimeve të centralizuara nga ana e Qeverisë së Kosovës. Përveç tjerash, sfiduese mbetet ngritja e vetëdijes sa i përket procedurave të prokurimit publik dhe zbatimit të tyre.

Për adresimin e sfidave të lartcekura, plani i veprimit parasheh një numër masash që duhet ndërmarr, përfshirë raportimet që deklarohen shkeljet nga ana e autoriteteve kontraktuese, raportimet periodike të cilat tregojnë publikimin e shpalljes së tenderëve, monitorimet e planifikuara dhe ato të rastit si dhe raportimet e vendimeve që merren nga ana e OSHP-së. Përveç kësaj, planifikohet organizimi i një forumi publik, përfshirë shoqërinë civile dhe operatorët ekonomik i cili do synon të ofroj informata shtesë mbi procedurat e prokurimit publik.

Për adresimin e çështjes së specifikimeve teknike të tenderëve, do të shqyrtohen ankesat relevante, gjobat e shqiptuara për Autoritetet Kontraktuese(AK) si dhe rastet e kthyerat për rivlerësim dhe ritenderim. Plan i veprimit parasheh ngritjen e kapaciteteve, duke punësuar staf të ri, dhe duke organizuar trajnime për shërbyesit civil që merren me procedurat e prokurimit publik. Parashihet edhe emërimi i tre anëtarëve të bordit të OSHP-së, si dhe emërimi i drejtorit të AQP-së. Më tutje, Qeveria e Kosovës do të bëjë miratimin e listës së shërbimeve dhe furnizimeve të centralizuara, gjë do të fuqizoj AQP-në në zbatimin e përgjegjësive të saj. Gjithashtu, menaxhimi i kontratës publike do të realizohet përmes monitorimeve që do të bëhen autoriteteve kontraktuese dhe gjetjeve nga këto raporte monitoruese.

4.1.7. Ligji i Pronësisë Intelektuale

Në këtë sektor, progres i dukshëm është shënuar në kompletimin e bazës ligjore, përfshirë miratimin e Ligjit mbi Treguesit Gjeografik dhe Emërtimet e Origjinës. Për implementimin e legjislacionit, është nxjerr Udhëzimi Administrativ mbi Përfaqësuesit e Autorizuar në fushën e pronësisë industriale. Dispozita për shkeljen e Ligjit për të Drejtat e Autorit dhe shmangja e masave teknologjike janë futur në Kodin Penal të Republikës së Kosovës.

Strategjia Nationale kundër Piraterisë dhe Falsifikimit 2012-2016 është miratuar. Me qëllim të zbatimit të strategjisë, është themeluar Task Forca kundër Piraterisë dhe Falsifikimit. Kjo e fundit në muajin Gusht të këtij viti ndërmori hapin e parë duke konfiskuar 10000 CD që përmbajnë muzikë, filma, video lojëra dhe programe kompjuterike, pastaj janë sekuestruar edhe afro 150 libra të ndryshëm. Vlen të ceket që Inspektorati i Tregut ka ndërmarrë procedurat ligjore të procedimit të rasteve në gjykatat kompetente. Njëkohësisht, është hartuar, dhe ka filluar implementimi i Rregullores për Ndërmjetësim në të Drejtën e Autorit, dhe është bërë trajnimi i ndërmjetësve për çështjet nga e drejta e autorit.

Në kuadër të kapaciteteve institucionale, baza e automatizuar e të dhënave për regjistrimin e objekteve të pronësisë industriale është e krijuar dhe plotësisht funksionale. Gjatë vitit që po e lëmë pas një numër memorandumesh të mirëkuptimit janë nënshkruar ndërmjet institucioneve kyçe të IPR-it, përfshirë Inspektoratin e Tregut, Dogana dhe policinë e Kosovës. Në saj të mekanizmave të krijuara, hynë edhe Komisioni për shqyrtimin e ankesave drejtuar kundër vendimit të Agjencisë për Pronësi Industriale dhe Komisioni Shtetëror për Pronësi Intelektuale. Sa i përket ngritjes së kapaciteteve, Agjencia për Pronësi Industriale ka bërë rekrutimin e dy zyrtareve të rinj.

Me gjithë progresin e arritur, sektori i IPR-it vazhdon të ballafaqohet me një numër sfidash të cilat kërkojnë përkushtim të madh nga institucionet kompetente. Edhe pse gjatë vitit që lamë pas,

korniza ligjore dukshëm është përparuar, megjithatë përveç përafritit të mëtutjeshëm sfiduese mbetet edhe zbatimi i legjislacionit në fuqi. Angazhim të mëtutjeshëm nevojitet edhe në adresimin e lëndëve të pranuar në Agjencinë për Pronësi Industriale. Krahas tjerash kjo e fundit reflekton edhe mungesën e resurseve humane në këtë Agjenci. Përveç tjerash, ngritja e kapaciteteve konsiderohet sfiduese duke u fokusuar në aspektin e avancimit profesional të stafit të institucioneve të IPR-it si dhe vetëdijesimin e popullatës së gjerë mbi të drejtat e pronësisë intelektuale. Angazhim profesional vazhdon të kërkohet krahas luftimit të mallrave të falsifikuara, të cilat e dëmtojnë dukshëm tregun e Kosovës.

Me qëllim të adresimit të sfidave në këtë sektor, Plani i veprimit parasheh një varg masash, duke filluar nga nxjerrja e akteve nënligjore të cilat do të plotësojnë Ligjin për Treguesit Gjeografik dhe Emërtimet e Originës. Gjithashtu, do të rregullohen procedurat e kundërshtimit për marka tregtare me që rast do të vihen afate për Agjencinë për Pronësi Industriale. Sa i përket zyrës për të Drejtat e Autorit, parashihet vazhdimi i zbatimit të Rregullores për Ndërmjetësim në të Drejtën e Autorit. Gjithashtu, planifikohet rregullimi i skemave private të autorit, respektivisht kompensimeve të veçanta. Vlerësimi i adresimit të ankesave drejtuar API-së do të bëhet përmes identifikimit të numrit të lëndëve të shqyrtuara dhe rasteve të zgjidhura. Në kontekst të ngritjes së kapaciteteve, ky plan parasheh rekrutim të ri të stafit dhe organizimin e trajnimeve të cilat do të ndihmojnë ngritjen profesionale të stafit të IPR-it. Me qëllim të parandalimit dhe luftimit të rasteve që dëmtojnë pronësinë intelektuale, ky plan parasheh identifikimi dhe specializimin e së paku dy hetuesve policorë për fushën e IPR-it. Këshilli Shtetëror për Pronësi Intelektuale parashihet të takohet rregullisht dhe të jetë në ushtrim të funksionit të tij. Njëkohësisht, do të ndërmerren aktivitete për vetëdijesimin e qytetarëve mbi të Drejtën e Pronësisë Intelektuale. Më tutje, për luftimin e mallrave të falsifikuara, plani i veprimit parasheh identifikimin e numrit të ngarkesave komerciale me qëllim të identifikimit të mallrave të falsifikuara. Krahas kësaj, do të krijohen profile të riskut për mallra të falsifikuara, dhe me përpikëri do të raportohet rritja e numrit të rasteve ex officio.

4.1.8. Politikat e Punësimit dhe ato Sociale, Politikat e Shëndetit Publik

Në sektorin e politikave të punësimit me qëllim të implementimit sa më të mirë të kornizës ligjore si dhe përafritit të legjislacionit me BE-në, në gjysmën e dytë të vitit 2012 Kuvendi i Kosovës ka miratuar Ligjin për Grevat si dhe ka miratuar Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Skemën e Ndhmës Sociale në Kosovë. Për zbatimin e ligjit në fjalë është miratuar Udhëzimi Administrativ për llogaritjen e shumëve mujore të asistencës sociale. Gjithashtu gjatë kësaj periudhe është aprovuar Udhëzimi Administrativ për kompensimin e normës së lëndimit dhe sëmundjeve profesionale të shkaktuara në punë, për të ndihmuar në zbatimin sa më të mirë të Ligjit të Punës. Në mënyrë që të rregullohet bashkëpunimi në mes të Qendrës për Punë Sociale dhe Zyrave Komunale të Punësimit, në prill 2013 u miratua Udhëzimi Administrativ për Procedurat e Regjistrimit, Certifikimit dhe Kërkimit të Punësimit për të Papunësuarit që Aplikojnë në Skemën e Ndhmës Sociale.

Në maj të këtij viti, Kuvendi i Kosovës ka miratuar Ligjin për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, ndërsa Ligji për lëshimin e lejeve të punës dhe punësimin e shtetasve të huaj është anuluar por disa prej dispozitave të këtij ligji janë inkorporuar në Ligjin e ri për të Huajt të miratuar në korrik.

Në funksion të implementimit të legjislacionit në këtë fushë, është miratuar Strategjia për Decentralizimin e Shërbimeve Sociale 2013-2017 e cila parasheh zbatimin e formulës për decentralizimin e buxhetit në komuna. Zbatimi i programeve dhe projekteve aktive në tregun e punës kanë vazhduar nga ana e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) në bashkëpunim me donatorët e huaj. Në kuadër të këtyre projekteve janë angazhuar në trajnime në

punë dhe praktikë në punë grupe të ndryshme punëkërkuesish. Poashtu, bazuar në ligjin për Shëndetin në Punë, janë organizuar edhe trajnime për inspektorët shëndetësorë dhe ata të sigurisë.

Sidoqoftë, në kuadër të politikave sociale mbeten një varg sfidash për t'u plotësuar duke përfshirë këtu edhe amandamentimin e ligjit të punës dhe mbështetjen e tij nga burime të mjaftueshme financiare. Numri i inspektorëve të punës të cilët janë bartës kryesorë të zbatimit të ligjeve mbetet ende shumë i vogël për t'i mundësuar këtij Inspektorati ushtrimin e plotë të kompetencave. Ofrimi i shërbimeve arsimore si dhe të punësimit duhet të bëhet në mënyrë të barabarte duke përfshirë këtu grupet e marginalizuara. Decentralizimi i shërbimeve sociale ka hasur në ngecje për shkak të problemeve të lidhura me formulën e buxhetit për decentralizim të zhvilluar në vitin 2012 e cila ende nuk është funksionale.

Për t'i adresuar këto sfida, Qeveria e Kosovës e ka miratuar Planin e Veprimit. Ky Plan i Veprimit ndër të tjera parashih ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit të Punës. Përmes një draft ligji për Agjencionin e Punësimit i cili është aktualisht në Kuvend, do të themelohet Agjensioni i Kosovës për Punësim, si organ vartës i MPMS-se, për zbatimin e politikave të punësimit dhe aftësimin profesional.

Ky plan gjithashtu parashih vazhdimin e decentralizimit të shërbimeve sociale sipas Strategjisë për Decentralizimin e Shërbimeve Sociale. Gjithashtu parashihet edhe rritja e numrit të inspektorëve të punës për t'ia mundësuar këtij Inspektorati funksionimin sa më të mirë si dhe përmbushjen e kompetencave të veta.

Në fushën e **Shëndetit Publik** janë shënuar një varg të arriturash, ku si e arritur kryesore është miratimi i Ligjit për Shëndetësi. Implementimi i ligjit në fjalë ka për qëllim rregullimin e sistemit shëndetësor në të gjitha nivelet. Po ashtu është miratuar edhe Ligji për Kontrollin e Duhanit, i cili parashih ndalimin e pirjes së duhanit në vendet publike që kontribuon në ruajtjen dhe përmirësimin e shëndetit të popullatës..

Shërbimet shëndetësore vazhdojnë të ju ofrohen komunitetit Roma, Ashkali dhe Egjiptian si dhe komuniteteve tjera në vendbanime ku shtrihen këto komunitete me theks të veçantë mbikëqyrjen dhe trajtimin e rasteve me nivel të lartë të plumbit në gjak si dhe në rritjen e nivelit të vaksinimit. Në kuadër të ngritjes së kapaciteteve institucionale në fushën e shërbimeve shëndetësore, është miratuar nga qeveria Statuti i Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës, janë themeluar Odat e profesionistëve shëndetësorë dhe është zgjedhur kryetari i saj, janë nënshkruar kontratat e para me QKUK dhe Spitalet Rajonale për shërbimet shëndetësore. Gjithashtu do të vazhdohet me pagesat për performancë me institucionet shëndetësore. Rregullorja e brendshme për strukturën e Ministrisë së Shëndetësisë është miratuar në qeveri.

Me gjithë progresin e arritur, në sektorin e shëndetësisë mbeten një varg sfidash që duhen adresuar në të ardhmen. Ndër më kryesoret është financimi i qëndrueshëm në sektorin e shëndetësisë për arsye të aplikimit sa më të mirë të reformës shëndetësore që është duke u bërë, që përfshin edhe riorganizimin e sistemit shëndetësor, dhe decentralizimin e menaxhimit profesional të burimeve njerëzore në shëndetësi.

Gjithashtu nevojitet funksionalizimi i Sistemit Informativ Shëndetësor (SISH), me qëllim të ofrimit të dhënave shëndetësore. Në këtë drejtim, nevojitet zgjerimi i rrjetit nëpër të gjitha institucionet shëndetësore si dhe integrimi i sektorit privat në kuadër të Sistemit të Informimit Shëndetësor unik.

Me qëllim të adresimit të sfidave në këtë sektor, Plani i Veprimit për negocimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit parasheh një mori masash që duhet ndërmarrë. Parashihet plotësimi dhe miratimi i kornizës ligjore duke përfshirë Projektligjin për Sigurime Shëndetësore, Projektligjin për Transplantimin e Indeve dhe Qelizave i cili aktualisht ka kaluar leximin e parë në Kuvend, Projektligjin për Produkte Medicinale dhe Pajisje, Projektligjin për Shëndetin Mendor, Projektligjin për Emergjenca, Projektligjin për Shëndet Publik, Projektligjin për të Ushqyerit me Qumësht Gjiri, Projektligjin për Inspektoratin Shëndetësor, dhe Projektligjin për Transfuzionin e Gjakut. Me qëllim të zbatimit të legjislacionit në fuqi nevojitet monitorimi dhe inspektimi dënimeve vazhdueshëm. Zhvillimi i Politikave në fushën e shërbimeve shëndetësore është njëri ndër synimet kryesore të Ministrisë së Shëndetësisë ku parashihet të miratohet Strategjia Shëndetësore 2014-2020, përfshirë udhërrëfyesit, protokollet klinike, planin zhvillimor institucional dhe planin e integritetit institucional. Në të njëjtën kohë, parashihen fushata për vetëdijësimin mbi rreziqet shëndetësore të kontaminimit me plumb si dhe vaksinimit të komunitetit rom ashkali, dhe egjiptas në pjesën Veriore të Mitrovicës. Me qëllim të adresimit sa më të drejtë të stigmës, për risocializimin dhe ri-integrimin e personave parashihen aktivitete ndër-institucionale.

Ngritja e kapaciteteve institucionale në fushën e shërbimeve shëndetësore synohet të bëhet përmes krijimit të Agjencionit për Financim Shëndetësor që do të jetë parardhës i Fondit të sigurimeve shëndetësore. Gjithashtu parashihen trajnime për stafin shëndetësorë për SISH-,si dhe aktivitete promovuese dhe trajnime në fushën e shëndetit të nënës dhe fëmijës.

4.1.9. Arsimi dhe Hulumtimi

Në sektorin e arsimit, në kuadër të zhvillimit të kornizës legjislative dhe përafrimit të saj me atë të BE-së, në dhjetor 2012 Kuvendi i Kosovës miratoi një ligj për arsimin e të rriturve dhe në shkurt 2013 e rishikoi ligjin për arsimin dhe formimin profesional. Në periudhën nga shtatori 2012 deri në prill 2013, janë miratuar 31 Udhëzime Administrative për zhvillimin e sistemit të arsimit për mësimdhënësit, financimin e këtij sektori, dhe kompetencat e mësimdhënësve në sistemin e menaxhimit të arsimit. Një grup prej njëmbëdhjetë Udhëzimeve Administrative e kanë plotësuar Ligjin për arsimin e lartë. Ndërsa Udhëzimi Administrativ Nr. 16/2013 për Zhvillimin Profesional të Arsimtarëve dhe Udhëzimi Administrativ Nr. 14/2013 për Vlerësimin e Performancës së Mësimdhënësve janë miratuar për të plotësuar legjislacionin e nevojshëm dytësor për zhvillimin profesional të mësimdhënësve. Në kuadër të hulumtimit dhe inovacionit, në mars u rishikua dhe u miratua ligji për veprimtari kërkimore-shkencore.

Në tremujorin e fundit të vitit 2012 u themelua Bordi për Mbikëqyrjen e Planit Strategjik të Arsimit në Kosovë (PSAK) 2011-2016 si dhe filloi zbatimi i programit për trajnimin dhe licensimin e mësimdhënësve të arsimit parauniversitar. Ky program ka për synim sigurimin e cilësisë në këtë sektor. Në fund të vitit 2012, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë finalizoi Kurrikulumin themelor të Kosovës. Në dhjetor të vitit 2012 MASHT miratoi udhëzuesin për normat dhe standardet e ndërtesave shkollore. Në arsimin e lartë u miratua një vendim ministror mbi reformën e cilësisë së programeve të trajnimit të mësimdhënësve të Universitetit të Prishtinës. Në Prizeren, Pejë, Mitrovicë dhe Gjilan u hapën Universite të reja publike.

Në shkurt, në kuadër të shqyrtimit të dytë vjetor të përbashkët për arsim, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë përpiloi një raport progresi sektorial dhe një *aide memoire* që i përcakton prioritetet e politikave për periudhën 2013-2014.

Gjatë vitit 2013, Ministria e Arsimit ka organizuar trajnime të ndryshme për mësimdhënësit në përpjekje për zhvillimin e mëturjes së profesional të tyre. Në mbështetje të zhvillimit të kapaciteteve kërkimore, Ministria ka financuar kandidatë për PhD në studimet e tyre jashtë vendit. Gjithashtu është organizuar edhe një trajnim lidhur me projektet kërkimore ndërkombëtare për komunitetin shkencor. Deri në tre mujin e parë të vitit 2013, Agjencia e Akreditimit e Kosovës (AAK) ka akredituar 12 programe të studimeve të doktoratës në Universitetin e Prishtinës.

Sidoqoftë, sektori i Arsimit përballlet me sfida të shumta. Mungesa e hapësirës ndikon që gjysma e shkollave të punojnë me dy ndërrime por edhe një numër i tyre (rreth 2% e institucioneve) detyrohen të punojnë në tri ndërrime. Në shkolla mungojnë laboratorët shkencorë dhe objektet sportive, si dhe nuk ka mirëmbajtje të përshtatshme për ndërtesat. Normat e ulëta të regjistrimit në shkolla të fëmijëve nga komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian, normat e larta të braktisjes së shkollës dhe performanca akademike e dobët e nxënësve nga ky komunitet janë shqetësuese. Edhe fëmijët me aftësi të kufizuara përballen me të njëjtat probleme. Në anën tjetër, burimet financiare, kapaciteti administrativ dhe angazhimi janë të pamjaftueshme për të arritur nivelin e hulumtimit dhe inovacionit të shënuar brenda BE-së.

Për adresimin e këtyre sfidave, Plani i Veprimit parasheh përmirësimin e infrastrukturës shkollare si dhe reduktimin e ndërrimeve në shkolla. Parashihet të përmirësohet edhe raporti nxënës-kompjuter në shkolla, për të arritur kështu që secila shkollë të ketë një kompjuter për 20 nxënës. Në përpjekje të rritjes së numrit të nxënësve nga rradhët e komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë parasheh sigurimin e teksteve shkollare në gjuhën romë. Përkrahja e 6 Qendrave mësimore për komunitetin rom, ashkali dhe egjiptian në 5 komuna të ndryshme si dhe krijimi i skemës së granteve dhe bursave për këtë komunitet parashihet të ndikojnë në rritjen e numrit të nxënësve nga këto rradhë. Ndërsa në përkrahje të hulumtimit dhe inovacionit në vend, parashihet që fondi shtetëror për hulumtime shkencore dhe inovacion të rritet pas vitit 2015. Gjithashtu parashihet të përkrahen së paku 40 kandidatë të studimeve të doktoratës dhe post-doktoratës në studimet e tyre.

4.1.10. Çështjet e Organizatës Botërore të Tregtisë (OBT)

Institucionet e Republikës së Kosovës do të fillojnë procesin e përgatitjeve për fillim e negocimit të anëtarësimit në Organizatën Botërore të Tregtisë (OBT). Pjesë e përgatitjeve do të jetë hartimi i një plani për anëtarësim në OBT, emërimi i stafit përgjegjës, si dhe inicimi i kontesteve ekzistuese me të cilat ballafaqohet tregu kosovar. Përgatitja e pozicioneve mbi procesin e negocimit do të jetë pjesë përmbytëse për fillimin e negocimit të procesit. Do të bëhet përgatitja profesionale e ekipit përgjegjës të cilët do të udhëheqin procesin e negocimit.

4.2. Politikat Sektoriale

4.2.1. Industria dhe NVM-të

Institucionet kosovare kanë vazhuar me intenzitet të shpejtuar në thjeshtësimin e legjislacionit vendor në fushën e politikës industriale dhe të Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (NVM). Është miratuar Ligji mbi Zonat Ekonomike, i cili përcakton qartë rolin e qeverisë dhe të komunave në krijimin e zonave të lira ekonomike (zonave të lira, parqeve industriale, parqeve teknologjike dhe inkubatorëve të biznesit).

Sa i përket politikave, ka vazhduar me implementimi i reformës së Të Bërit Biznes me qëllim të krijimit të një ambienti më të mirë për bizneset. Si rezultat i kësaj reforme, Kosova ka bërë përparim në rangimin e "Të Bërit Biznes" të Bankës Botërore. Në mars 2013, Qeveria e Kosovës ka miratuar Strategjinë për Zhvillimin e Sektorit Privat 2013-2017 me qëllim të zhvillimit të sektorit privat

konkurrues. Kjo strategji identifikon sektorët strategjikë industrial të cilët duhet t'i kenë në konsideratë institucionet gjegjëse kosovare, si dhe prioritetet në aspektin ligjor të përafrimit të legjislacionit vendor me acquis të BE-së, e në veçanti në fushën e lëvizjes së lire të mallrave dhe të tregtisë.

Përkundër arritjeve të lartpërmendura, mbeten një mori sfidash në të cilat institucionet kosovare duhet të adresojnë mekanizmat efikas për eliminimin e tyre. Më në detale, nevojitet përgatitja e vlerësimit të ndikimit të rregullatorit, sigurimi i zbatueshmërisë së kontratave, reduktimin edhe më tej të rregullave të panevojshme të biznesit dhe krijimin e një mjedisi që lehtëson qasjen në financa për akterët e biznesit. Gjithashtu, zhvillimi i kornizës institucionale mbetet pjesë e përgatitjes së autoriteteve vendore për zbatimin e politikave të NVM-ve, me theks të veçantë zbatimi i strategjisë për zhvillimin e sektorit privat, si dhe planit të veprimit i cili duhet të monitorohet në mënyrë më efikase.

Në funksion të adresimit të sfidave evidente të lartpërmendura, MTI do të bëjë zhvillimin e një sistemi të kategorizimit të ndërmarrjeve. Kjo do të arrihet përmes përmirësimit të dhënave ekzistuese mbi NVM-të, si dhe klasifikimi i tyre duke i kategorizuar në baza sektoriale.

Lidhur me përmirësimi e mëtejme të ambientit të të bërit biznes, MTI së bashku me Komunat do të vazhdojnë me zvogëlimin e mëtejme të barrierave në të bërit biznes, me fokus në barrierat të cilat janë në kompetencë të komunave. Mundësimi i regjistrimit të bizneseve online po ashtu do të jetë një indikator stimulues për ndërmarrësit e rinje për lehtësimin e procedurave. Në kuadër të avancimeve administrative në këtë drejtim, do të bëhet unifikimi i numrit të bizneseve të cilat do të shërbejnë si statistika të sakta për zhvillimin e planifikimeve tjera në vijim.

Me synim të përmirësimit të qasjes në financa për ndërmarrjet dhe sektorin privat në tërësi, MTI do të realizojë aplikimin për anëtarësim në institucionet zhvillimore të BE-së (CIP, EU SME Eëek, COSME) dhe donatorëve tjerë, me qëllim të krijimit të instrumentëve financiarë për lehtësimin e qasjes së NVM-ve në financa. Njëherit do të punohet në rritjen e fondeve të dedikuara për skemën e garantimit të kredive, si dhe shtimi i fondeve për subvencionimin e NVM-ve.

Ngritja e bashkëpunimit në mes të institucioneve arsimore dhe NVM-ve do të bëhet përmes realizimit të ciklit të programit "Internship Biznesi" për 600 studentë, i zbatuar në bashkëpunim në mes të MTI, MASHT, dhe MKRS. Poashtu, synohet që lënda për ndërmarrësi do të përfshihet në kurrikulën e Arsimit të Ulët (MASHT).

Së fundmi, Strategjia për Zhvillimin e Sektorit Privat 2013-2017 është planifikuar të monitorohet në baza të rregullta, me qëllim të identifikimit të ngecjeve dhe mundësisë së shtimit të indikatorëve shtesë që do të ngrisin efektshmërinë në zhvillimin e sektorit privat.

4.2.2. Bujqësia

Në procesin e krijimit të kornizës ligjore fusha e bujqësisë dhe zhvillimit rural, karakterizohet me legjislacion të avancuar, sepse janë miratuar një numër i konsiderueshëm ligjesh të cilat kanë krijuar kushte të favorshme për zhvillimin e sektorit në përgjithësi. Gjithashtu është miratuar edhe legjislacioni sekondarë sidomos në fushën e inspektimit dhe mbikëqyrjes së pyjeve, si dhe janë krijuar mekanizma të nevojshëm për inspektim duke shtuar kontrollet dhe inicim të procedurave penale dhe kundërvajtje për prerësit ilegal të pyjeve.

Me qëllim të zbatimit të kornizës legislative, MBPZHR ka plotësuar më tutje kornizën strategjike duke miratuar kështu edhe Strategjinë për Shërbimet Këshillimore 2013-2020.

Sa i përket kornizës institucionale, me qëllim të zbatimit me efikasitet të politikave bujqësore dhe të zhvillimit rural, janë themeluar edhe strukturat kompetente administrative (Autoritetin Menaxhues, Komitetin Monitorues, Agjencinë e Zhvillimit të Bujqësisë etj) të cilat korrespondojnë me Politikën e Përbashkëta Bujqësore (PPB) dhe programin e IPARD-it. Në kuadër të Programit Nacional për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2007- 2013, MBPZHR ka zgjeruar ndërmarrjen e masave edhe në sektor të ri duke përfshirë sektorët e produkteve të qumështit, frutave dhe verës, si dhe janë lansuar projekte specifike të zhvillimit rural për të ndihmuar ristrukturimin e sektorit në përgjithësi.

Edhe për kundër progresit të arritur, sektori i bujqësisë ballafaqohet me disa sfida si harmonizimi i mëtutjeshëm i ligjeve me acqui-në dhe implementimi i ligjeve ekzistuese. Duke pasur parasysh volumin e madh të punës në implementimin e skemës së subvencioneve dhe grandeve, Agjencia e Zhvillimit të Bujqësisë ballafaqohet me sfida të cilat janë regjistrat e vjetër kadastral dhe të pronës si dhe prirjet për mashtrim nga ana e parashtruesve të kërkesave. Sfidë e vazhdueshme mbetet çështja e shërbimeve këshillimore, ndonëse është bërë një punë e madhe, ato akoma nuk janë efikase dhe në nivel të kënaqshëm, e kjo për shkak të mungesës së mjeteve buxhetore që reflekton në konsolidimin e departamentit si dhe numrit të kufizuar të këshilltareve. Për më tepër, toka bujqësore po vazhdon të shkatërrohet nga veprimtaritë e pakontrolluara duke ndërruar destinimin e sajë pa kriter. Në të njëjtën kohë duhet të bëhet më shumë në përafrimin e të dhënave statistikore (import-eksport) me të dhënat e BE-së ku bashkëpunimi ndër-institucional dhe ngritja e kapaciteteve në këtë aspekt është crucial. Gjithashtu, sektori i pylltarisë ballafaqohet me sfida të mëdha për shkak të prerjeve ilegale dhe zjarreve të pyjeve të cilat po shkaktohen nga koordinimi jo i pamjaftueshëm i institucioneve relevante (APK, Komunitat, Policia dhe Gjykatat).

Me qëllim të harmonizimit të politikave bujqësore me Politikën e Përbashkëta Bujqësore të BE, nga Janari 2014 do të fillojë të implementohet Strategjia për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2014-2020, me të cilën synohet rritja e prodhimit, përmirësimi i konkurrencës, krijimi i të ardhurave nga fermat, qëndrueshmëria e tyre, gjenerimi i vendeve të reja të punës dhe përmirësimi i infrastrukturës rurale.

Plani i veprimit parasheh një mori masash për përmirësimin e kornizës ligjore siç janë ligjet bazike dhe aktet nënligjore. Parashihet që edhe më tutje të vazhdohet përkrahja e fermave bujqësore dhe modernizimi i tyre përmes skemës së subvencioneve dhe grandeve investuese për sektorët të cilët janë strategjik dhe konkurrues në treg. Në lidhje me implementimin më të lehtë të skemës së projekteve për subvencione dhe grandeve investuese nga Agjencioni i Zhvillimit Rural, synohet që të krijohet sistemi i menaxhimit të informacionit për administrimin dhe kontrollin e pagesave direkte dhe për programin e zhvillimit rural, i cili është në përputhje me nevojat specifike të Kosovës.

Sa i përket efikasitetit më të madh të shërbimeve këshillimore bujqësore, parashihet funksionalizimi i Departamentit të Shërbimeve Këshillimore dhe themelimi i qendrave për këshillime bujqësore në të gjitha komunitet me qëllim të ofrimit të shërbimeve këshilluese teknik për fermerë.

Për mbrojtjen e tokave bujqësore nga ndërtimet e ndryshme do të ndërmerren masa për mbrojtjen e saj, bazuar në Ligjin për Toka bujqësore si dhe do të implementohet Strategjia për Konsolidimin e tokave e cila parasheh Rregullimin e pa Përfunduar të Tokave (RrPT) dhe Rregullimin Vullnetar i Tokave (RrVT) në disa zona kadastrale të Kosovës.

Përafrimi i të dhënave statistikore me të dhënat e BE-s, do të bëhet me një koordinim më të mirë me gjithë arteret të cilët janë të përfshirë në grumbullim, përpunim dhe publikim e të dhënave.

Sa i përket sektorit të pylltarisë, përkatësisht mbrojtjes së pyjeve nga prerjet ilegale, me planin e veprimit parashihet miratimi i Ligjit të ri për Pyjet në të cilin parashihen masat ndëshkuese për prerjet ilegale. Gjithashtu parashihet pyllëzimi i sipërfaqeve të reja dhe hartimi i planeve menagjuese për pyje etj. Me qëllim të përmirësimit të infrastrukturës rurale sidomos në zonat rurale, MBPZHR do ti mbështesë projektet e hartuara nga Grupet Lokale të Veprimit.

Në fushën e *sigurisë së ushqimit*, kontrolleve veterinarë dhe fitosanitare, është shënuar progres në përmirësimin e kornizës ligjore, respektivisht me plotësim-ndryshimin e një sërë ligjesh, si Ligji për Ushqim, Ligji për Veterinari, , Ligji për Bagëtinë dhe Ligji për Mbrojtjen e Bimëve, të cilat janë shoqëruar me një numër të konsiderueshëm të procedurave standarde të operimit dhe udhëzuesve për inspektorë.

Në drejtim të zhvillimit të politikave dhe planeve në këtë sektor, është adoptuar dhe ka filluar zbatimin Plani Zyrtar për Kontroll dhe Mostrim të Ushqimit dhe Shëndetit të Kafshëve dhe Bimëve. Gjithashtu, është finalizuar kategorizimi i Pikave të Kontrollit Kufitar dhe janë miratuar Procedurat Standarde të Operimit për mostrimin e mishit dhe produkteve të tij.

Në vazhden e përmirësimit të kornizës institucionale dhe profesionale, AUV ka punësuar numër të konsiderueshëm të inspektorëve veterinarë, sanitarë, fitosanitarë dhe atyre ligjorë. Sa i përket identifikimit, regjistrimit dhe lëvizjes së kafshëve, janë marrë disa hapa në drejtim të vendosjes së një sistemi elektronik të të dhënave, si dhe të gjitha palët e përfshira në këtë dikaster, si veterinarët e terrenit, inspektorët dhe pronarët e thertoreve, janë trajnuar në futjen e të dhënave në këtë sistem. Për më tepër, një numër i konsiderueshëm i inspektorëve të AUV-së janë trajnuar për kryerjen e kontrolleve zyrtare, përderisa stafi i Laboratorit të Ushqimit dhe të Veterinarisë (LUV) është trajnuar për kryerjen e analizave përkatëse laboratorike. Po ashtu, është treguar përkushtim në përmirësimin e punës së LUV me blerjen e pajisjeve të reja dhe moderne.

Sidoqoftë, përkundër kornizës së kënaqshme ligjore në fushën e sigurisë së ushqimit dhe kontrolleve veterinarë, autoritetet e Kosovës duhet të përqendrohen më tepër në plotësimin dhe zbatimin më efikas të legjislationit përkatës. Kësisoj, me masat e parapara në Plan të Veprimit, pritet të miratohen një mori ligjesh, rregulloresh, strategjish e planesh të veprimit. Sistemi i sigurisë së ushqimit në Kosovë duhet të organizohet më mirë brenda institucioneve përgjegjëse, përmes koordinimit më të mirë në mes të institucioneve në të gjitha nivelet. Gjithashtu, duhet të konsolidohen më tej kontrollet fitosanitare dhe të sigurisë ushqimore, si në kufij ashtu edhe brenda vendit.

Në drejtim të ngritjes së kapaciteteve institucionale dhe profesionale, parashihet themelimi i disa zyrave rajonale si dhe investime të konsiderueshme në resurset njerëzore dhe ato infrastrukturore, për të ndërlidhur të gjitha elementet në zinxhirin ushqimor. Plani i Veprimit parashih akreditimin e Laboratorit të Ushqimit dhe Veterinarisë, si dhe funksionalizimin e plotë të tij, me qëllim të ofrimit të një game më të gjerë të shërbimeve testuese. Për më tepër, ky plan adreson edhe çështjen e përmirësimit sistematik të databazës sa i përket regjistrimit të kafshëve (lindjet, regjistrimi, lëvizja dhe therjet e tyre).

Gjithashtu, duhet të përfundojë ndërtimi i fabrikës së përpunimit të nënprodukteve me origjinë shtazore dhe të përmirësohen kapacitetet për transferimin e mostrave. Me kontrollin e prodhimeve me origjinë bimore dhe shtazore merren edhe institucionet komunale përmes inspektorëve

komunalë për veterinarin, sanitarin dhe bujqësinë, mirëpo roli dhe përgjegjësitë e tyre nuk janë të përkufizuara tërësisht, prandaj sipas Planit të Veprimit parashihet edhe transferimi i inspektorëve komunalë në kuadër të AUV-së.

4.2.3. Mjedisi

Në funksion të mbrojtës dhe përmirësimit të gjendjes së mjedisit, institucionet e Kosovës kanë vazhduar të avancojnë edhe më tutje në plotësimin e kornizës ligjore kryesisht në fushën e menaxhimit të mbeturinave, ujërave, mbrojtës së natyrës, planifikimit urban dhe në sektorë të ndërtimit. Po ashtu është shënuar progres në fushën e politikave mjedisore duke miratuar nga ana e Qeverisë Strategjinë për Mbrojtje të Mjedisit, Strategjinë për Mbeturina, Strategjinë për Cilësi të Ajrit së bashku me Planet e Veprimit. Këto strategji janë me shumë rëndësi për sektorin e mjedisit me të cilat synohet përmirësimi i gjendjes së mjedisit duke ndjekur parimin e zhvillimit të qëndrueshëm, dhe ngritjes së mirëqenies së popullatës.

Krahas progresit të shënuar në legjislacionin, MMPH vazhduar punën në procesin e implementimit të legjislacionit dhe politikave mjedisore duke hartuar dhe miratuar Planet Zhvillimore Komunale (PZHK) dhe Planet Zhvillimore Urbanistike (PZHU) në shumicën e komunave të Kosovës. Në anën tjetër, inspektorati mjedisor ka arritur të ndaloj operimin e gurëthyesve ilegal dhe ndalimin e eksploatimit të materialeve inerte nga shtretërit e lumenjve dhe duke rehabilituar dhe përmirësuar gjendjen e tyre. Krahas kësaj, janë shpallur edhe 16 zona të mbrojtura për burimet e ujit të pijshëm. Ndërsa, rrjeti i monitorimit të cilësisë së ajrit tani më është i kompletuar dhe funksional duke mbuluar tërë territorin e Kosovës. Për më tepër, AMMK tanimë ka krijuar një konsistencë në raportet vjetore të përgatitura për Gjendjen e Ajrit, për Hotspotet Mjedisore dhe Raporti për Zonat e Mbrojtura të cilat dërgohen në Agjencinë Evropiane të Mjedisit-EEA/EIONET.

Në kuadër të ngritjes së kapaciteteve njerëzore dhe institucionale janë mbajtur vazhdimisht trajnime të ndryshme në fushën VNM dhe VSM, krimeve mjedisore, trajtimin e ujërave të zeza, menaxhimin e mbeturinave, dhe adaptimit ndaj ndryshimeve klimatike.

Megjithatë edhe përkundër arritjeve në sektorin e mjedisit mbetet një numër i sfidave të cilat duhet të adresohen, e posaçërisht në zbatimin dhe fuqizimin e legjislacionit si në nivelin qendror po ashtu dhe lokal. Sfidë mbetet akoma konsolidimi i kornizës strategjike për sektorin e mjedisit në përgjithësi. Për më tepër politikat mjedisore dhe ato të ndryshimeve klimatike nuk janë të kanalizuar në politikat e tjera e veçanërisht në sektorin e energjisë, transportit, pylltarisë, bujqësisë dhe industrisë. Zbatimi i standardeve evropiane për menaxhimin e mbeturinave është në një fazë të hershme, dhe përpjekje substanciale janë të nevojshme për të zbatuar standardet e BE-së në këtë fushë.

Në këtë kontekst, institucionet e Kosovës duhet që të avancojnë përafrimin e legjislacionit mjedisorë me atë të BE-së, si dhe në ngritjen e kapaciteteve për implementim e politikave si në nivel qendror dhe në atë lokal. Gjithashtu, duhet të rritet angazhimi për përmirësimin e kapaciteteve njerëzore/institucionale sa i përket monitorimit, raportimit dhe planifikimit strategjik. Krahas kësaj, burimet financiare/ rritja e investimeve kapitale në këtë sektor është e pamjaftueshme për të adresuar problemet mjedisore.

Megjithatë, me qëllim të adresimit të sfidave në këtë sektor, plani i veprimit parasheh një numër masash, duke filluar nga miratimi i Strategjisë për Mbrojtje të Mjedisit, Cilësisë së Ajrit, Ujërave, Menaxhimit të Mbeturinave, dhe të përafrimit të legjislacionit mjedisor me atë të BE-së. Po ashtu parashihet miratimi i Strategjisë për Ndryshime Klimatike, fushë kjo e cila nuk ka pasur progres dhe zhvillime të mjaftueshme deri më tani.

Në anën tjetër, planifikohen investime kapitale në përmirësimin e infrastrukturës komunale me projekte konkrete duke zgjeruar dhe avancuar rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimit. Kapacitetet administrative brenda sektorit të mjedisit dhe ndryshimeve klimatike do të fuqizohen e posaçërisht në fushën e inspektimit, monitorimit dhe të raportimit. Përfundimisht, plani parasheh një numër të aktiviteteve kryesisht lidhur me inventarizimin, raportimin dhe monitorimi e Gazrave Serrë, monitorimin e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, masave për zonat e mbrojtura të natyrës, e shumë aktivitete tjera të cilat në përgjithësi do të ndikojnë në implementimin e politikave mjedisore me qëllim të përmirësimit të gjendjes së mjedisit.

4.2.4. Politikat e Transportit

Në sektorin e transportit është shënuar progres sa i përket kompletimit dhe përafrimit të kornizës legislative primare dhe sekondare me *acquis communautaire*. Më tej, me qëllim të zbatimit të kornizës legislative, janë miratuar një numër i konsiderueshëm aktesh nënligjore duke përfshirë transportin rrugor, hekurudhat si dhe aviacionin civil. Ndërkaq, në funksion të hartimit të politikave efektive është shkrire Strategjia e Transportit Multimodal me Strategjinë Sektoriale në një dokument të vetëm strategjik, përkatësisht në Strategjinë Sektoriale dhe Multimodale që pritet të miratohet në nja afat sa me të shpejt kohor. Për më tepër, me këtë strategji synohet të krijohet një ambient i përshtatshëm për zhvillim të sigurt, kualitativ dhe funksional të sistemeve të transportit dhe kapaciteteve njerëzore.

Po ashtu, në ndjekje të modeleve evropiane të zhvillimit të hekurudhave, janë shënuar zhvillime pozitive me ndarjen e Hekurudhave të Kosovës në dy kompani publike, përkatësisht ARH në bashkëpunim me MI janë duke zbatuar kornizën ligjore për hapjen graduale të tregut të transportit hekurudhorë.

Në fushën e aviacionit civil, është përmbyllur marrëveshja për zbatim në mes të Qeverisë së Hungarisë dhe Forcës Ndërkombëtare të Sigurisë së Kosovës (KFOR) për ofrimin e shërbimit të navigimit ajror dhe aktiviteteve të tjera përkatëse në hapësirën ajrore të Kosovës. Si rezultat i kësaj, periudha e synuar për ri-hapjen e hapësirës ajrore të Kosovës është gjysma e parë e vitit 2014. Për më tepër, si rezultat i angazhimeve konsistente në Marrëveshjen për Hapësirën e Përbashkët Evropiane të Aviacionit (HPEA), Kosova ka bërë hapa progresiv në miratimin e rregulloreve ekonomike dhe atyre të sigurisë, si kërkesa të drejtpërdrejta nga faza e parë e marrëveshjes së HPEA-së dhe është e gatshme për kalim në fazën e dytë të kësaj marrëveshje.

Gjithashtu, në pajtueshmëri me kornizën institucionale, MPB ka amandamentuar programet kombetare për sigurim të aviacionit civil. Sa i përket aktiviteteve operacionale, në fushën e sigurimit të aviacionit civil, janë kryer inspektime të vazhdueshme në ANP "Adem Jashari" si dhe inspektimet në "Catering Prishtina" që është përgjegjës për furnizimin e aeroplanët me ushqim dhe pije. Në anën tjetër, numri i udhëtarëve në ANP-në "Adem Jashari" deri në qershor 2013 ka pasur ngritje për 15 % në krahasim me periudhën e njëjtë gjatë vitit 2012.

Në fushën e infrastrukturës rrugore, zbatimi i projektit R7 është në zbatim e sipër, përkatësisht, pas përfundimit të segmentit (Morinë-Gjurgjicë), puna është duke vazhduar me të njëjtën dinamikë në segmentet 7-8-9 Prishtina Jugore-Besi (20km). Në ndërkohë, pas përfundimit të procedurave tenderuese, kompania fituese për ndërtimin e R6 është shpallur Bechtel-Enka, dhe pritet që gjatë ditëve në vijim të nënshkruhet kontrata dhe të fillon zbatimi i projektit të R6. Për më tepër, në kuadër Qeveria e Kosovës synon përmirësimin e gjithëmbarshtëm në rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës rrugore. duke përfshirë autostradën R7.

Sa i përket sinjalizimit horizontal dhe vertikal të rrugëve, projekti është kryer 100%. Ndërkohë, ka vazhduar procesi i dhënies së licencave për transportimin e mallrave, për transportimin e mallrave të rrezikshme licenca për transportimin e udhëtarëve. Në kontekstin e aktiviteteve të inspektimit janë ndërmarrë masat konkrete ndaj operatoreve që nuk kanë respektuar ligjet në fuqi. Në fushën e ngritjes së kapaciteteve njerëzore dhe profesionale, kanë vazhduar trajnime në të gjitha fushat e transportit me ç'rast zyrtaret e fushave të ndryshme janë pajisur me diploma dhe certifikua si nga institucionet vendore ashtu edhe nga ato ndërkombëtare.

Megjithatë, edhe përkundër arritjeve substanciale, sektori i transportit ende vazhdon të ballafaqohet me sfida shumëdimensionale në procesin e integritimit evropian. Në këtë kontekst, sfida vazhdon të mbetet harmonizimi i mëtejme i legjislacionit primar dhe sekondar me *acquis communautaire*. Po ashtu, siguria në komunikacionin rrugor, përkatësisht shkalla e lartë e aksidenteve rrugore vazhdon të sfidojë MI dhe institucionet tjera përgjegjëse sektoriale. Për më tepër, kapacitetet e kufizuara të inspektimit, automjetet e vjetra si dhe cilësia e ulët e infrastrukturës rrugore janë disa prej sfidave të cilat janë duke pamundësuar zbatimin e plotë të legjislacionit nga MI.

Në sektorin e hekurudhave, sfida kryesore janë mungesa e investimeve në infrastrukturën hekurudhore dhe trajnimi i stafit ARH-s. Përkundër një varg të arriturash në sektorin e aviacionit, kapacitetet për sigurimin e aviacionit civil që menaxhohet nga MPB duhet të përmirësohen edhe më tej. Ndërkaq, pengesat politike për pjesëmarrjen dhe përfaqësimin e Kosovës në institucione të ndryshme ndërkombëtare janë sfidat kryesore sa i përket avancimit të bashkëpunimit ndërkombëtar në sektorin e transportit që njëkohësisht po ndikojnë negativisht edhe në zbatimin e legjislacionit dhe përmbushjen e standardeve të BE.

Megjithatë, në funksion të përmirësimit të gjendjes së përgjithshme të sektorit të transportit, institucionet përkatëse do të marrin masa konkrete në drejtim të miratimit dhe zbatimit të plotë të legjislacionit. Në kontekst të avancimit dhe përafrimit të kornizës legislative, Kosova do të miratojë Ligjin mbi Sigurinë në Komunikacionin dhe Ligjin për Agjencinë e Shërbimeve të Navigacionit Ajror Krahas zhvillimeve legislative, në rrafshin operacional Qeveria do të miratojë strategjinë për siguri në komunikacionin rrugor me qëllim të zvogëlimit të numrit të aksidenteve dhe përmirësimit të sigurisë në komunikacionin rrugor. Ndërkaq, sa i përket orientimit të politikave strategjike, përmes realizimit të projektit të R7 si dhe fillimit të zbatimit të projektit të R6, Qeveria do të vazhdojë të përmirësojë infrastrukturën rrugore si faktor përcaktues i nxitjes së mëtejme të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik.

Në anën tjetër, me qëllim të balancimit të investimeve në sektorin e transportit, Qeveria do të intensifikojë përpjekjet që strategjinë aktuale të investimeve në ndërtimin e rrugëve të reja ta plotësojë me investime adekuate edhe në sektorët tjerë, veçanërisht përfshirje më të lartë do të këtë sektori i hekurudhave. Rrjedhimisht, rëndësi e veçantë do t'i kushtohet prioritetëve afatgjatë nga fusha e transportit siç janë ristrukturimi dhe modernizimi i sistemeve të transportit si dhe integrimi i plotë i Kosovës në rrjetin rajonal dhe evropian të transportit rrugor, hekurudhor dhe ajror. Sa i përket zhvillimeve institucionale në sektorin e transportit, përkatësisht në fushën e aviacionit civil, pritet që brenda një afati sa më të shkurt kohor AAC të çertifikojë Ofruesin e Shërbimeve të Navigacionit Ajror (OShNA). Për më tepër, Qeveria në vijimësi do t'i forcojë dhe zhvillojë kapacitetet administrative dhe profesionale përmes thëllimit të reformave institucionale duke bërë që institucionet përgjegjëse të jenë të përgatitura për të menaxhuar dhe koordinuar në mënyrë sa më të suksesshme sfidat e procesin të integritimit në BE.

4.2.5. Energjia

Kosova ka shënuar progres në krijimin e kornizës legislative të energjisë në përputhje me pakon e dytë të ligjeve të BE-së dhe në plotësimin e obligimeve ndaj Komunitetit të Energjisë (KE). Kjo kornizë përmban gjashtë ligje kyçe, siç janë: Ligji për Energjinë, Ligji për Energjinë Elektrike, Ligji për Rregullatorin e Energjisë, Ligji për Eficiencën e Energjisë, Ligji për Gazin Natyror dhe Ligji për Ngrohjen Qendrore. Për më tepër, institucionet e Kosovës kanë miratuar Udhëzime Administrative për caqet e Burimeve të Ripërtërishme të Energjisë si dhe për të promovuar eficiencën e energjisë.

Sa i përket kornizës institucionale tanimë është funksionalizuar Agjencia e Kosovës për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguria Bërthamore (AKMRrSB) e cila operon si agjenci e pavarur që i përgjigjet Zyrës së Kryeministrit. Ndërkaq, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MTI) ka themeluar dhe funksionalizuar njësinë për rezerva të detyrueshme të naftës.

Nga aspekti politik është e rëndësishme të theksohet se Qeveria e Republikës së Kosovës ka arritur marrëveshje me Qeverinë e Republikës së Serbisë për sektorin e energjisë. Kjo marrëveshje, ndër të tjera pritet t'i zgjidhë problemet ekzistuese ndërmjet KOSTT-it dhe kompanisë homologe nga Serbia. Sa i përket zbatimit të kornizës ligjore dhe politikave të këtij sektori, Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) ka bërë investime në filtrat elektrikë për të ulur nivelin e hedhjes së grimcave të ngurta nga TC Kosova A. Gjithashtu, janë bërë investime edhe në procesin e palosjes së hirit nga termocentralet në miniera, duke eliminuar kështu tërësisht ndotjen në mjedis, si dhe është bërë eliminimi i materieve të rrezikshme nga impianti i Gazifikimit. Ndërkaq, investimet e realizuara në rrjet kanë ndikuar që të rritet siguria e furnizimit me energji elektrike si dhe të zvogëlohen humbjet teknike. KOSTT, përveç investimeve në shumë projekte tjera, ka filluar me realizimin e procesit të rëndësishëm të realizimit të linjës 400 kV që lidhë Kosovën me Shqipërinë. Në kuadër të krijimit të kornizës rregullative për hapjen e Tregut të Energjisë Elektrike është krijuar dhe aprovuar Dizajni i Tregut në bazë të së cilit janë draftuar edhe Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike.

Megjithatë, karshi progresit të arritur në këtë sektor mbeten një numër sfidash të cilat institucionet kosovare duhet të adresojnë. Në radhë të parë harmonizimin e mëtutjeshëm të kornizës ligjore me *acquis communautaire*, ku bënë pjesë hartimi i ligjeve të reja apo ndryshimi dhe plotësimi i legjislacionit ekzistues primar apo sekondar në sektor. Sfidë tjetër e rëndësishme e Kosovës është edhe zhvillimi i politikave strategjike në përputhje me obligimet e Traktatit të Komunitetit të Energjisë, siç është vazhdimi me zhvillimin dhe ristrukturimin e sektorit, përkatësisht zhvillimi i kapaciteteve të reja gjeneruese të cilat edhe mundësojnë mbylljen e termocentralit Kosova A.

Sfidë për institucionet kosovare mbetet edhe ruajtja e pavarësisë profesionale dhe financiare të rregullatorit të energjisë dhe institucioneve tjera të pavarura. Nga ana tjetër, Kosova përveç që duhet të rrisë sigurinë e furnizimit me energji elektrike, duhet që të investojë edhe në rritjen e eficiencës së energjisë si dhe në përqindjen e pjesëmarrjes së përgjithshme të burimeve të ripërtërishme të energjisë në prodhim. Krijimi i një fondi për eficiencë të energjisë si dhe lehtësimi i procedurave administrative dhe financiare për licencim në këtë sektor mbetet sfidë në vete.

Me qëllim të tejkalimit të suksesshëm të këtyre sfidave, institucionet e Kosovës do të hartojnë dhe miratojnë ligjin e ri për tregti me naftë dhe produkte të naftës si dhe atë për energji termike. Në të njëjtën kohë, do të miratohen edhe amendamentet e ligjeve ekzistuese në sektorin e energjisë elektrike, energjisë termike, të naftës, gazit natyror, por edhe të ligjit për mbrojtje nga rrezatimi dhe siguria bërthamore. Ndërkaq, strategjia për energji dhe ajo për rezerva të naftës do të rishikohen ashtu që të bëhet e mundur implementimi i rregullave të BE-së.

AKMRrSB dhe ZRrE do të shtojnë numrin e stafit të punësuar si dhe të rrisin kapacitetet e tyre profesionale duke investuar në trajnimin e tyre. Njëkohësisht do të rritet edhe vet buxheti i tyre, ashtu që të rritet pavarësia e këtyre institucioneve të pavarura. Procesi për ngritjen e kapaciteteve të reja gjeneruese, në veçanti të termocentralit Kosova e Re duhet të përshpejtohet, e që njëkohësisht ndikon edhe në përshpejtimin e hapave për dekomisionimin e termocentralit Kosova A. Në këtë aspekt, është planifikuar që gjatë vitit 2014 të bëhet miratimi i transaksionit për projektin Kosova e Re si dhe të bëhet shpallja e fituesit të ofertës për TC Kosova e Re. Sa i përket procesit të dekomisionimit të TC Kosova A, fillimisht do të nisë procesi i dekomisionimit dhe çmontimit të azotikut, gazifikimit, ngrohtores dhe objekteve tjera përcjellëse të cilat nuk e pengojnë operimin normal të njësive aktive. Në kuadër të rritjes së efikasitetit të energjisë, projekti i kogjenerimit të energjisë termike për qytetin e Prishtinës nga termocentrali Kosova B pritet të përfundojë në vijim gjatë vitit 2014. Nga ana tjetër, Agjencia e Statistikave të Kosovës do të mbledhë dhe krijojë të dhëna statistikore lidhur me efikasitetin dhe kursimin e energjisë elektrike. Planifikimi i investimeve të ardhshme në Rrjetin e Transmisionit konsiston në rritjen e sigurisë së furnizimit dhe në zvogëlimin e humbjeve teknike në rrjet.

4.2.6. Shoqëria Informativë

Spektori i komunikimeve elektronike dhe politikave audiovizuale ka shënuar progres substancial me miratimin e një numri të konsiderueshëm të legjislacionit primar dhe sekondar. Në funksion të krijimit dhe implementimit të politikave të përshtatshme për zhvillimin e shoqërisë informative është miratuar nga Qeveria e Kosovës dokumenti strategjik "Politikat e Sektorit të Komunikimeve Elektronike - Agjenda Digjitale për Kosovë 2013-2020". Përveç kësaj, Qeveria e Kosovës ka miratuar vendimin për liberalizimin e mëtejshëm të shërbimeve të telefonisë mobile, si dhe vendimin për aprovimin e shenjës Z6 si shenjë e thirrjes për shërbime Radio Amatore në tërë hapësirën gjeografike të Republikës së Kosovës. Sa i përket zhvillimeve në fushën e radio frekuencave, plani i përdorimit të radio frekuencave është miratuar nga Bordi i ARKEP-it si dhe njëkohësisht është hartuar plani për monitorimin e shfrytëzimit të radio frekuencave. Ndërkaq, në fushën e interoperabilitetit për ndërveprueshmërinë e sistemit të TIK, Qeveria e Kosovës ka aprovuar Korniza e Interoperabilitetit.

Sa i përket zhvillimeve institucionale në fushën e medieve, në kuadër të procesit të kompletimit të emërimit të anëtarëve të Komisionit të Pavarur për Media (KPM), Kuvendi i Kosovës ka emëruar edhe një anëtarë të KPM nga radhët e komunitetit serb duke emëruar 6 nga 7 anëtarët që duhet të ketë KPM. Më tej, Kuvendi i Kosovës zgjodhi 3 anëtarë të Bordit për Ankesa të KPM. Për më tepër, KPM ka marrë 33 vendime ndaj subjekteve transmetuese. Gjithashtu KPM ka marrë vendim të publikojë listën me frekuenca të lira për radio dhe TV lokale. Me qëllim të ngritjes së kapaciteteve profesionale në fushën e TIK-ut dhe politikave audiovizuale, janë mbajtur një varg trajnimesh dhe vizita të ndryshme në institucionet ndërkombëtare.

Megjithatë, përkundër progresit substancial në sektorin e komunikimeve elektronike, shoqërisë së informacionit dhe politikave audiovizuale, një varg sfidash komplekse me të cilat ballafaqohen institucionet përgjegjëse e vështirësojnë implementimin efektiv të standardeve të BE-së, përfshirë kompletimin dhe përafrimin e kornizës legjislative me *acquis communautaire* si dhe ngritjen e kapaciteteve profesionale për monitorim dhe implementim të reformave. Ndërkaq, në aspektin operacional të politikave audiovizuale, sfidë mbetet miratimi i strategjisë për kalim nga sistemi analog në sistemin digjital të transmetimit.

Po ashtu, pavarësisht miratimit të Ligjit për RTK, sfidë esenciale mbetet qëndrueshmëria afatgjate financiare e RTK-së. Për më tepër, sa i përket sfidave që ndërlidhen me zhvillimet institucionale sektoriale janë ruajtja e pavarësisë financiare si dhe ngritja e kapaciteteve profesionale në ARKEP

dhe KPM. Në anën tjetër, pamundësia e anëtarësimit të institucioneve të Kosovës në organizma ndërkombëtare për shkaqe politike vazhdon ta sfidojë sektorin e komunikimeve elektronike dhe politikave audiovizuale duke shkaktuar probleme në çështjet si marrja e kodit shtetëror për telefon, për internet si dhe shpërndarje të pamjaftueshme të spektrit frekuencor, përfshirë edhe transmetimet digjitale.

Me qëllim të përmbushjes së sfidave të lartpërmendura, Kosova do të intensifikoj përpjekjet në agjendën e përafrimit të legjislacionit, implementimit efektiv të politikave dhe thellimit të reformave institucionale. Në kontekst të avancimit dhe përafrimit të kornizës legjislative, Kosova do të miratoj Ligjin për Digjitalizim të Transmetimeve Radiodifuzive Tokësore. Ndërkaq, me qëllim të implementimi të politikave në mënyre efektive, Qeveria do të zhvilloj dhe miratoj strategji sektoriale siç është ajo për E-qeverisje dhe planin e veprimit si dhe Strategjinë për Teknologji Informative me qëllim të përcaktimit të prioritetëve, objektivave dhe detyrave të zhvillimit të TIK-ut. Gjithashtu, Qeveria do të miratoj edhe Strategjinë për Digjitalizim si dokument themelor për kalimin nga sistemi analog në sistemin digjital të transmetimit.

Megjithatë, përveç miratimit të legjislacionit dhe strategjive sektoriale, Qeveria do të angazhohet në ruajtjen e pavarësisë financiare, forcimin e kapaciteteve institucionale dhe profesionale të rregullatorëve si ARKEP dhe KPM. Për më tepër, në këtë vijimësi angazhimesh, MZHE do të forcojë kapacitetet profesionale sa i përket koordinimit të politikave për TIK-un dhe çështjet që rrjedhin nga Agjenda Digjitale e Evropës. Rrjedhimisht, përmes reformave institucionale, forcimit të kapaciteteve profesionale, dhe intensifikimit të bashkëpunimit ndërkombëtar për të siguruar kodin shtetëror për telefon, domenin shtetëror për internet, dhe anëtarësimin në Unionin Ndërkombëtar të Telekomunikacionit (ITU), Kosova synon modernizimin e rrjetit të telekomunikacionit, integrimin në rrjetet Evropiane dhe pjesëmarrje aktive në programet e BE-së për sektorët përkatës.

4.2.7. Kontrolli Financiar

Sa i përket kapaciteteve implementuese të auditimit të brendshëm dhe kontrollit financiar, është zhvilluar edhe më tej korniza institucionale për menaxhimin financiar dhe kontrollin. Është rritur numri i njësive të auditimit në gjithsej 65, janë krijuar edhe 6 komitete të auditimit si dhe është rritur numri i auditorëve të brendshëm. Nga njësia e auditimit të brendshëm janë pranuar 54 raporte të auditimit nga organizatat buxhetore. Ka vazhduar certifikimi i auditorëve për module të ndryshme të menaxhimit financiar dhe kontrollit si dhe janë mbajtur disa trajnime për komitetet dhe njësitë e auditimit.

Pavarësisht shume zhvillimeve pozitive në fushën e kontrollit financiar, ende ekzistojnë sfida në këtë sektor përfshirë nevojën për rritjen e efikasitetit të Njësive të Auditimit të Brendshëm dhe plotësimin e stafit sipas standardeve ndërkombëtare. Gjithashtu për të zbatuar legjislacionin për certifikimin e auditorëve të brendshëm duhet të bëhet rishikimi i kurrikulës për trajnime specifike dhe rregullave të certifikimit. Sfidë tjetër tejet me rëndësi është që institucionet duhet t'i kushtojnë rëndësi të veçantë ngritjes së llogaridhënies menaxheriale në fushën e kontrollit financiar për një mirëkuptim më të madh dhe marrje e përgjegjësisë brenda organizatave buxhetore për të krijuar një kulturë të delegimit të përgjegjësisë dhe autoriteteve. Njësia Qendrore Harmonizuese për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin ka nevojë për ngritje të kapaciteteve.

Me qëllim të adresimit të disa nga këto sfida, Plani i Veprimit parasheh një varg masash për ngritjen e efikasitetit të Njësive të Auditimit të Brendshëm. Do të bëhet rishikimi i kurrikulave specifike dhe rregullave të certifikimit dhe kompletimi i njësive të auditimit më auditor të brendshëm.

Ndërsa për rritje të efikasitetit dhe funksionimit më të mirë institucional, do të ridizajnohet statusi funksional i Njesisë Qendrore Harmonizuese për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Po ashtu Plani parasheh një varg masash për ngritjen e kapaciteteve dhe llogaridhënies menaxheriale në fushën e auditimit dhe kontrollit financiar.

Sa i përket auditimit të jashtëm, ka filluar implementimi i strategjisë së re zhvillimore bashkë me planin implementues një vjeçar. Zyra e Auditorit Gjeneral ka publikuar gjithsej 115 raporte të auditimit, përfshirë këtu raportet vjetore të rregullsisë për pasqyrat financiare të organizatave buxhetore, auditimet menaxheriale dhe të performancës, dhe auditive tjera të organizatave jo-qeveritare.

Për të kontribuar në qëndrueshmërinë e ZAP-it marrëveshja për zbatimin e Skemës së Certifikimit të ri u nënshkrua me Shoqatën e Kontabilistëve dhe Auditorëve të Kosovës. Kjo skemë është projektuar për auditorët e sektorit publik dhe është e bazuar në Standardet Ndërkombëtare të Institutit Suprem të Auditimit (ISSAI). Kanë vazhduar aktivitetet për ngritjen e kapaciteteve edhe në auditimin e jashtëm. Është rritur numri i auditorëve të licencuar dhe kontabilistëve të certifikuar dhe janë mbajtur një varg trajnimesh të stafit të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm.

Sidoqoftë, ekziston nevoja të sigurohet qëndrueshmëria institucionale e Zyrës së Auditorit Gjeneral (ZAP) si dhe të kontribuohet edhe më tutje në forcimin e qeverisjes së mirë së ZAP-it.

Me qëllim të sigurohet qëndrueshmëria institucionale e ZAP do të miratohet një ligj i ri për në pajtim me standardet e auditimit të njohura ndërkombëtarisht për sektorin publik dhe që siguron pavarësinë organizative, funksionale dhe financiare. Po ashtu Plani parasheh zhvillimin e legjislacionit të nevojshëm sekondar.

Gjithashtu parashihet aprovimi i Strategjisë së Zhvillimit të Përbashkët për periudhën 2014 - 2020, rritje e kapaciteteve administrative dhe certifikimit të auditorëve. Në Plan parashihen hapa konkret në kontribuimin për forcimin e qeverisjes së mirë siç janë auditimet e obligueshme të Rregullsisë për të gjithë shpenzuesit buxhetor, auditimet e performancës dhe menaxhimit. Do të vazhdojë auditimi i fondeve të donatorëve dhe projekteve si pjesë e integruar e portfolios së veprimtarisë së ZAP. Njëkohësisht do të zhvillohet edhe më tej Raporti Vjetor i Auditimit dhe do të rritet komunikimi dhe bashkëpunimi me palët e interesit.

4.2.8. Statistikat

Ka pasur një progres sa i përket legjislacionit mbi statistikën përfshirë legjislacionin sekondar të nevojshëm për implementimin e ligjeve. Janë miratuar Udhëzimi Administrativ (UA) për ruajtjen dhe shfrytëzimin e materialit statistikor dhe UA për kushtet dhe mënyrën e ofrimit të të dhënave statistikore të fituara me përpunime të veçanta të statistikave zyrtare. Njëkohësisht, disa rregullore janë miratuar në lidhje me riorganizimin e brendshëm, zbatimin e NACE dhe funksionimin e Këshillit Statistikor.

Përveç kësaj, për zbatimin e politikave zhvillimore në fushën e statistikave, janë përgatitur Plani Vjetor i Statistikave 2013 dhe Planin Strategjik 2013-2017 për statistika zyrtare. Këto dokumente synojnë zhvillimin dhe përmirësimin e kualitetit të të dhënave statistikore në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Sa i përket zhvillimit të statistikave të biznesit, Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka përfunduar mbledhjen e të dhënave për projektin e transferimit të klasifikimit të aktivitetit

ekonomik nga NACE Rev.1 NACE Rev 2. Ndërsa, lidhur me përgatitjet për regjistrimin e bujqësisë, janë harmonizuar me metodologjinë e Eurostat dhe me nevojat e vendit pyetësori, udhëzimet dhe metodologjia e regjistrimit të bujqësisë.

Sa i përket ngritjes së kapacitetit ASK ka rekrutuar nëntë punëtorë: dy në fushën e TI, gjashtë në fushën e prodhimit të statistikave dhe një në administratë.

Sidoqoftë, kjo fushë ende ballafaqohet me shumë sfida. Një prej sfidave është edhe përmirësimi i cilësisë së statistikave në të gjitha fushat statistikore, por sidomos në fushën e biznesit dhe llogarive kombëtare. Në këtë kontekst, Kosova duhet të prodhojnë statistikën afatshkurtra në baza tremujore (indikatori afatshkurtër). Ndër të tjera, është i nevojshëm forcimi i menaxhimit të agjencisë që do të çojë në zhvillimin e institucionit dhe sistemit statistikor të Kosovës, është gjithashtu e nevojshme e kapaciteteve në fushën e statistikave prodhuese dhe administrative. Sfide tjetër e ASK është që duhet të bëjë përgatitjet për regjistrimin e bujqësisë. Gjithashtu vazhdimi i ndërtimit të kapaciteteve të ASK-së është i nevojshëm për të lehtësuar prodhimin e statistikave më cilësore.

Me qëllim të adresimit të këtyre sfidave janë parashikuar një numër i aktiviteteve në Planin e Veprimit. Në aspektin e zhvillimit institucional, do të bëhen ndryshime në ligjin për statistikën zyrtare të pasuara me harmonizimin e legjislacionit sekondar dhe me rekomandimet e Eurostat-it që në të njëjtën kohë do të përforcojnë menaxhmentin e ASK-së. Për të përmirësuar statistikën të bizneseve dhe llogarit kombëtare do të zbatohen rekomandimet e Eurostat-it, të tilla si kalimi nga platforma NACE Rev.1 në NACE Rev.2, do të bëhet përfshirja e njësive lokale në Regjistrin Statistikor të Bizneseve si dhe do të themelohet regjistri për grupet e ndërmarrjeve dhe bizneseve. Më pas, do të fillojë transferimi i të dhënave nga ESA 95 dhe SNA 93 në ESA 2010. Përveç kësaj, do të fillojnë të publikohen statistikën tremujore sektoriale dhe të llogarive kombëtare. Ndërsa për të adresuar regjistrimin e bujqësisë do të ndryshohet ligji për regjistrimin e bujqësisë dhe si rrjedhojë do të finalizohet kalendari i buxhetit dhe aktiviteteve. Kapaciteti administrativ do të forcohet nëpërmjet pjesëmarrjes aktive në seminare, vizita studimore, punëtori të cilat synojnë trajnimin profesional të personelit të ASK-së.

4.3. Drejtësia, Liria dhe Siguria

4.3.1. Vizat, kufijtë, azili dhe migrimi

Me miratimin e ligjeve kyçe në fushën e kufirit, azilit dhe migrimit, konsiderohet se legjislacioni bazë në këto fusha është pothuajse i kompletuar. Për më tepër, regjimi i vizave ndaj shtetasve të huaj që kanë nevojë të pajisen me viza për të hyrë në Kosovë, ka nis të zbatohet nga 1 korriku 2013.

Kjo fushë, megjithatë karakterizohet me një sërë sfidash. Në fushën e azilit dhe migrimit mungon legjislacioni sekondar apo ekziston nevoja që ai të rishikohet në pajtim me ndryshimet legjislative që kanë ndodhur gjatë këtij viti. Fusha e menaxhimit të kufirit kërkon hartimin e legjislacionit sekondar. Sa i përket riatdhesimit, është e domosdoshme të nënshkruhen marrëveshje të riatdhesimit jo vetëm me shtetet e BE-së, por posaçërisht me shtetet e origjinës dhe ato transit.

Me qëllim të adresimit të sfidave në këtë fushë, plani i veprimit parasheh finalizimin dhe aprovimin e legjislacionit sekondar në fushën e vizave, menaxhimit të kufirit, azilit dhe migrimit. Përveç kësaj, ky plan parasheh adresimin e sfidave të përmendura në fushën e azilit dhe migrimit përmes masave për ngritjen e kapaciteteve në departamentin e ri-integrimit në Ministrinë e Punëve të Brendshme.

4.3.2. Shpëlarja e parave

Sa i përket parandalimit dhe luftimit të shpëlarjes së parave, Kosova ka vazhduar me përmirësimin dhe plotësimin e kornizës ligjore ekzistuese. Plotësim-ndryshimi i ligjit kundër shpëlarjes së parave zgjeron dhe forcon mandatin e Njësitit të Inteligjencës Financiare (NJIF) në luftimin dhe parandalimin e shpëlarjes së parasë. Për më tepër, memorandumet e bashkëpunimit të nënshkruara nga NJIF me a) Policinë e Kosovës, b) Departamentin e Regjistrimit të OJQ-ve përbrenda Ministrisë së Administratës Publike dhe c) Bankën Qendrore, mundësojnë një bazë të mirëfilltë për realizimin e bashkëpunimit më këto institucione.

Me gjithë të arriturat dhe angazhimin e institucioneve, sfidë në këtë fushë mbetet mungesa e një plani të veprimit për strategjinë kundër shpëlarjes së parasë, dhe mos emërimi i autoritetit/koordinatorit që do të mbikëqyrte dhe koordinonte zbatimin e strategjisë kundër shpëlarjes së parasë dhe financimit të terrorizmit. Duke marrë parasysh natyrën komplekse të krimeve financiare dhe aktiviteteve kundër shpëlarjes së parasë, sfidë tjetër në këtë fushë është mungesa e ekspertizës së gjyqtarëve, prokurorëve dhe stafit mbështetës që punojnë në këto çështje. Me qëllim të adresimit të kesaj çështje, IGJK parasheh organizimin e trajnimeve për ngritjen e shkathtësive të gjyqtarëve e prokurorëve në zbatim të ligjit kundër shpëlarjes së parave.

Me qëllim të adresimit të sfidave të cekura në raportin e progresit, parashihet rishikimi i strategjisë kundër shpëlarjes së parasë dhe financimit të terrorizmit, hartimi i planit të veprimit për këtë strategji dhe emërimi i autoritetit/koordinatori nacional për zbatimin e saj. Ky plan, po ashtu do të parasheh masat e nevojshme për tu ndërmarrë me qëllim të përmirësimit të ekspertizës së gjyqtarëve dhe prokurorëve që merren me krime financiare.

4.3.3. Drogat

Lufta kundër narkotikëve vazhdon të mbetet ndër prioritet kryesore të Policisë së Kosovës dhe autoriteteve tjera relevante. Në këtë drejtim, Kosova ka miratuar strategjinë dhe planin e veprimit kundër trafikimit të narkotikëve si dhe ka shënuar rritje të sasisë së narkotikëve të konfiskuara. Për më tepër, Kosova është në proces të themelimit të Observatorit të drogave, trup ky i cili do të ofrojë një pasqyrë të qartë mbi drogat në Kosovë, përfshirë këtu aspektin e parandalimit, luftimit dhe zvogëlimit të dëmit.

Me gjithë të arriturat në këtë fushë, një sërë sfidash mbeten për t'u tejkaluar. Kosova vazhdon të jetë vend transit për transportimin dhe deponimin e narkotikëve, sidomos heroinës. Në anën tjetër, mungojnë analistë dhe hetues financiar të cilët do të mund të shqyrtonin dhe hetonin aspektet financiare të ndërlidhura me trafikimin e narkotikëve.

Me qëllim të adresimit të sfidave të lartpërmendura në këtë fushë, ky plan i veprimit, parasheh zhvillimin e mëtejshëm të kapaciteteve (ndër të tjera) doganore përmes trajnimeve të cilat ndihmojnë zbulimin dhe konfiskimin e narkotikëve në pikat kufitare, si dhe rekrutimin e analistëve dhe hetuesve financiarë me qëllim të ndërlidhjes së hetimeve kundër trafikimit të drogave me ato financiare.

4.3.4. Policia

Angazhimi dhe përkushtimi i Policisë së Kosovës ka bërë që ky institucion të perceptohet si një nga institucionet më të besueshme në fushën e sundimit të ligjit. Avancimi i kornizës ligjore përmes miratimit të ligjeve dhe një numri të udhëzimeve administrative, nënshkrimi i memorandumit të mirëkuptimit në mes të Policisë dhe Njësisë së Inteligjencës Financiare me anë të të cilit mundësohet

shkëmbimi i informatave elektronike në mënyre të shpejtë dhe të sigurt, si dhe përmirësimi i strukturës së brendshme të Policisë së Kosovës janë vetëm disa nga të arriturat e Policisë së Kosovës. Me gjithë progresin, një numër sfidash mbeten për t'u adresuar. Ato prekin kryesisht fushën e mbrojtjes së dëshmitarëve, si finalizimi dhe aprovimi i legjislacioni sekondar në këtë fushë dhe hartimi i programeve të veçanta për mbrojtjen e dëshmitarëve. Për më tepër vërehet mungesë e ekspertizës adekuate për trajtimin e të miturve si të dyshuar, viktimë apo dëshmitarë të krimit si dhe mungesë e rezultateve nga zbatimi i strategjisë së policimit në komunitet.

Me qëllim të adresimit të sfidave të lartë përmendura, plani i veprimit parasheh hartimin e legjislacionit sekondar dhe programeve përkatëse në fushën e mbrojtjes së dëshmitarëve, si dhe hartimin e një udhëzimi administrativ për trajtimin e të miturve që janë të dyshuar për kryerje të veprave penale, viktimë apo dëshmitarë të veprave penale që do të përcillet me trajnimet e nevojshme për stafin e policisë që do të zbatojnë këtë udhëzim. Masa adekuate janë paraparë në mënyrë që strategjia për policimin në komunitet të prodhojë rezultatet e pritura, duke përfshirë informata inteligjente për sektorët e tjerë të policisë.

4.3.5. Luftimi i krimit të organizuar

Zhvillimi i mëtejshëm i kornizës ligjore në luftën kundër krimit të organizuar, miratimi i katër strategjive dhe planeve të veprimit, nënshkrimi i marrëveshjeve për bashkëpunim ndërkombëtarë dhe ngritja e kapaciteteve njerëzore të institucioneve të zbatimit të ligjit dhe atyre gjyqësore, janë identifikuar si disa nga të arriturat kryesore në luftimin e krimit të organizuar.

Me qëllim të përmirësimit të saktësisë dhe të harmonizimit të statistikave për rastet e krimit të organizuar, baza e përbashkët e të dhënave në mes të institucioneve të zbatimit të ligjit është në proces të funksionalizimit. Kjo bazë e të dhënave do të ofrojë informata lidhur me hetimet, ndjekjet penale, dhe vendimet përfundimtare të gjykatës për rastet që lidhen me veprat penale të krimit të organizuar dhe korrupsionit. Për më tepër, kjo bazë e të dhënash do të ofrojë statistika edhe mbi konfiskimin e pasurisë së fituar me vepër penale. Kur është fjala tek konfiskimi i pasurisë, vlen të theksohet se është shënuar një rritje e ndjeshme në numrin dhe sasinë e pasurisë së konfiskuar, përderisa Kosova është anëtarësuar në CARIN (Camden Asset Recovery Inter-Agency Network).

Me gjithë të arriturat, sfidat nuk mungojnë sa i përket luftimit të krimit të organizuar, e ndër më të dukshmet janë ngecjet në zbatimin e legjislacionit në fuqi. Për më tepër, Kosovës i mungon korniza rregullative dhe infrastrukurore që do të siguronte mbrojtjen e dëshmitarëve, si dhe kornizë e mirëfilltë që do të rregullonte fushën e përgjimit të telekomunikacionit. Mungesa e një qasje më proaktive ndaj konfiskimit të pasurisë së fituar me vepër penale dhe e ekspertizës për hetim të krimit të organizuar, konsiderohen si çështje që duhen adresuar. Gjithashtu, nevojitet një sensibilizim më i madhë i institucioneve për zbatimin e ligjit lidhur me rolin dhe përgjegjësitë e Agjencisë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose Konfiskuar. Gjithashtu, nevojitet një rritje e vetëdijësimit të institucioneve për zbatimin e ligjit lidhur me rolin dhe përgjegjësitë e Agjencisë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose Konfiskuar.

Plani i veprimit, ka paraparë kompletimin e kornizës ligjore në fushën e mbrojtjes së dëshmitarëve, përgjimit të telekomunikacionit, si dhe intensifikimin e shfrytëzimit të dispozitave për konfiskimin e pasurisë së fituar me vepër penale. Ky plan gjithashtu parasheh masa për ngritjen e nivelit të ekspertizës të zyrtarëve që hetojnë rastet e krimit të organizuar.

4.3.6. Mbrojtja e të dhënave personale

Progresi në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale është karakterizuar me miratimin e një numri të udhëzimeve administrative që burojnë nga Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Megjithatë, sfidat janë të dukshme sa i përket mbrojtjes së të dhënave personale. Mbrojtja e të dhënave personale në Kosovë konsiderohet të jetë në fazë fillestare. Ekziston një nivel i ulët i ndërgjegjësimit të sektorit publik dhe privat në këtë fushë, ndërsa në anën tjetër mungon ekspertiza e nevojshme për të adresuar në mënyrë të duhur vështirësitë. Sektori i policisë, mbetet si më i ndjeshmi sa i përket mbrojtjes adekuate të të dhënave personale.

Me qëllim të adresimit të sfidave të cilat paraqiten në këtë fushë, ky plan i veprimit parasheh ngritjen e kapaciteteve të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale përmes rekrutimit të zyrtarëve shtesë (sidomos prej komunitetit pakicë) dhe trajnimeve të specializuara për zyrtarët e agjencisë. Për më tepër, janë paraparë masa në lidhje me ndërgjegjësimin e sektorit publik dhe privat për mbrojtjen e të dhënave personale dhe ofrimin të mbështetjes për këta sektorë që të zbatojnë plotësisht kornizën ligjore relevante.

| No | Veprim | Indikatoret | Afati perfun. | Inst pergj | Inst Ndhmës | Ref_Doc | Kosto | BKK | Donatorët | Gaps |
|----|--|---|------------------------|------------|-------------|---------|-------|-----|-----------|------|
| | 2. KRITERET POLITIKE | | | | | | | | | |
| | 2.1. Demokracia dhe Sundimi i Ligjit | | | | | | | | | |
| | 2.1.1. Kuvendi | | | | | | | | | |
| 1 | Te perfundohet reforma zgjedhore duke marre parasysh rekomandimet e Komisionit Evropian si dhe praktikat me te mira nga BE | 2. Plotesim-ndryshimi i Ligjit per Zgjedhjet ne pajtim me rekomandimet e KE-se, i miratuar | K1-2014 | Kuvendi | / | / | / | / | / | / |
| 2 | Te perforcohet kapaciteti administrativ dhe legjislativ i Kuvendit si dhe te permiresohet procedura legjislative per te siguruar ekspertize legjislative dhe perputhshmeri me Acquis | 1. Projektligji për Kuvendin, të miratohet; 2. Plani strategjik per trajnimin e burimeve njerezore, i miratuar 3. Rregullorja e re e Kuvendit, e miratuar 4. Numri i stafit te rekrutuar ne pajtim me Rregulloren per Pergjegjesite dhe Organizimin e Administrates se Kuvendit ne Departamentin Ligjor dhe per Ceshtje Procedurale 5. Numri i trajnimeve | 1.K2-2014 3.K3-2014 | Kuvendi | / | / | / | / | / | / |

| | | | | | | | | | | |
|----|--|---|---------|---------|---|---|---|---|---|---|
| 3. | Të sigurohet pavarësia buxhetore e Kuvendit të Kosovës | 1. Buxheti i Kuvendit, si edhe propozimet mbi ndryshimet në administrimin e tij, duhet të miratohen nga Qeveria dhe të kenë prioritet nevoja e Kuvendit | K4-2014 | Kuvendi | | | | | | |
| 3 | Te permiresohet koordinimi dhe planifikimi i perbashket mes Kuvendit dhe Qeverise | 1. Koordinatorët për harmonizimin e agjendes legjislative nga Kuvendi dhe Qeveria, të emëruar 2. Plani legjislativ Kuvend - Qeveri, i harmonizuar | K1-2014 | Kuvendi | / | / | / | / | / | / |
| 4. | Të fuqizohet roli mbikqyrës i Komisionit për Integritet Evropian në procesin e Integritet Evropian | 1. Bashkëpunimi dhe bashkërendimi i aktiviteteve të ministrive të linjës me Komisionin për Integritet Evropian në procesin e Integritet Evropian dhe procesin e liberalizimit të vizave; 2. Konsultimi dhe bashkërendimi me Komisionin Evropian për Integritet Evropian rreth çështjeve që negocohen me Bashkimin Evropian | K4-2014 | Kuvendi | | | | | | |

| | | | | | | | | | | |
|---|--|---|---------|---------|---|---|---|---|---|---|
| 4 | Kuvendi te perforcoje funksionet mbikeqyrese ndaj ekzekutivit dhe organizatave buxhetore | 1. Numri i raportimeve me shkrim nga Ekzekutivi / organizatat buxhetore 2. Numri i interpelancave 3. Numri i raporteve te Kuvendit mbi vleresimin e implementimit te legjislacionit 4. Numri i raporteve te institucioneve te pavaruara, të shqyrtuara | K4-2014 | Kuvendi | / | / | / | / | / | / |
| 5 | Te sigurohet llogaridhenja dhe shqyrtimi I shpenzimeve te buxhetit te Kuvendit pergjate vitit fiskal | 1. Numri i Raporteve per shpenzim të buxhetit të Kuvendit, te shqyrtuara në Komisionin Parlamentar per Buxhet dhe Financa dhe Komisioni per Mbikqyrjen e Financave Publike | K4-2014 | Kuvendi | / | / | / | / | / | / |

| | | | | | | | | | | |
|----------------|---|---|---------|---------|---|---|---|---|---|---|
| 6 | Te konsultohet Kuvendi gjate procesit te modifikimit te draft buxhetit te tij, para se te dergohet per miratim ne Kuvend si dhe te sigurohet kontrolli I buxhetit nga Kuvendi | 1. Propozim buxheti per 2013-2014 ne harmoni me ligjin per menaxhimin e financave publike 2. Numri i raportimeve mbi buxhetin me theks të veçantë në fushën e shëndetësisë, bujqësisë, asistencës sociale, kulturës dhe arsimit. 3. Mekanizmi mbi mbikëqyrjen dhe përcjelljen e rekomandimeve që u jepen organizatave buxhetore dhe Ekzekutivit, i vendosur | K4-2014 | Kuvendi | / | / | / | / | / | / |
| 7 | Te ngritet mbikeqyrja e sektorit te sigurise nga ana e komisioneve parlamentare | 1, Numri i raportimeve me shkrim 2. Numri i interpelancave 3. Numri i raporteve te Kuvendit mbi vleresimin e implementimit te legjislacionit | K4-2014 | Kuvendi | / | / | / | / | / | / |
| 2.1.2. Qeveria | | | | | | | | | | |
| 1 | Të përmirësohet koordinimi dhe planifikimi i përbashkët ndërmjet Kuvendit dhe Qeverisë | Shih veprimin 3 tek 2.1.1 Kuvendi | K1-2013 | ZKM | / | / | / | / | / | / |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|--|---------|-----|---|---|---|---|---|---|
| 2 | Të ngriten kapacitetet për zhvillimin dhe koordinimin e politikave dhe planifikimit strategjik, si dhe të sigurohet që agjenda legjislative korrespondon me kapacitetet individuale të ministrive dhe buxhetin aktual | <p>1. Strategjia legjislative, plani vjetor i punës dhe buxheti, të harmonizuara</p> <p>2. KASH-i dhe buxheti vjetor i harmonizuar me deklaratën e prioriteteve të Qeverisë</p> <p>3. Plan i vjetor i punës i hartuar në bazë të deklaratës së prioriteteve të qeverisë dhe prioriteteve të ministrive</p> <p>4. Vlerësimi i pajtueshmërisë me udhëzimin administrativ 02/2012 për secilin dokument strategjik, i hartuar</p> <p>5. Dokumentet strategjike, të miratuara</p> <p>6. Numri i stafit të rekrutuar në Zyren për Planifikim Strategjik</p> <p>7. Numri i trajnimeve për ZPS</p> | K4-2014 | ZKM | / | / | / | / | / | / |
|---|---|--|---------|-----|---|---|---|---|---|---|

| | | | | | | | | | | |
|---|---|--|---------|------|---|---|----------------|----------------|---|---|
| 3 | Të ngriten strukturat per koordinimin e procesit te Stabilizim Asociimit, si dhe te ngriten kapacitetet e Qeverise me qellim permiresimin e harmonizimit te legjislacionit vendor me Acquis, koordinimin e politikave dhe absorbimin e asistences | 1. Vlerësimi i kapaciteteve të Qeverisë për harmonizimin e legjislacionit vendor me acquis, koordinim të politikave, i përfunduar 2. Planet e ngritjes së kapaciteteve dhe rekrutimit, të hartuara 4. Numri i zyrtarëve të rekrutuar dhe trajnuar në fushën e acquis, asistencës dhe koordinim të politikave | K4-2014 | MIE | / | / | / | / | / | / |
| 4 | Të forcohen kapacitetet e administratës në nivelin lokal, përfshirë komunat e sapo formuara, duke ofruar udhëzime nga niveli qëndror tek ai lokal | 1. Ligji për Emrat, Numrat dhe Kufinj të Administrativ të Komunave, i miratuar 2. Aktet ligjore nga fusha e vetëqeverisjes lokale qe duhet te harmonizohen me Acquis, te identifikuara 3. Strategjia për Vetëqeverisjen Lokale 2014-2023, e miratuar 4. Programi për ngritjen e kapaciteteve të zyrtarëve të nivelit lokal për komunat e krijuara në procesin e decentralizimit, i hartuar 5. Programi për investime publike për | K4-2014 | MAPL | / | / | € 2,390,590.00 | € 2,390,590.00 | / | / |

komunat e formuara në procesin e decentralizimit, i hartuar
 6. Programi për ngritjen e kapaciteteve të zyrtarëve të nivelit lokal sa i përket menaxhimit të tokës, i hartuar.
 7. Doracaku për inaugurimin e organeve të Komunës, i hartuar.
 8. Doracaku për funksionalizimin e organeve lokale pas zgjedhjeve lokale 2013, i hartuar

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---------|---------|--|---|-------------|-------------|---|---|
| 5 | Të forcohen kapacitetet e administratës në nivelin lokal, përfshire komunat e sapo formuara, duke ofruar udhëzime nga niveli qendror tek ai lokal | 1. Ligji për Emrat, Numrat dhe Kufijtë Administrativ të Komunave, i miratuar | K3-2014 | Kuvendi | | / | / | / | / | / |
| 6 | Të vazhdohet procesi i decentralizimit për komunën e veriut të Kosovës | 1. Komuna e Mitrovicës Veriore, e funksionalizuar 2. Plani i Veprimit për Funksionalizim të katër komunave, i miratuar. 3. Buxheti i Komunave, i alokuar) | K4-2013 | MAPL | | / | € 13,322.57 | € 13,322.57 | / | / |

| | | | | | | | | | | |
|---|--|--|----------|------|---|---|--------------|--------------|---|---|
| 7 | Të ngritet transparenca e punës dhe vendimmarrjes të nivelit lokal | 1. Aktet normative dhe vendimet e komunave, të publikuara 2. Mbledhjet e Kuvendeve të komunave, të hapura për publikun, 3. Qasja e qytetarëve në punën e Kuvendeve të Komunave përmes teleprezencës, e funksionalizuar 4. Fushata vetëdijësuese për qytetarët për teleprezencën, e organizuar 5. Fushata për qasjen në dokumentat publike, e organizuar 6. Trajnimet për qasjen në dokumentat publike për zyrtarët lokal, OJQ-të dhe Mediat, e organizuar | K4- 2014 | MAPL | / | / | € 326,188.07 | € 326,188.07 | / | / |
|---|--|--|----------|------|---|---|--------------|--------------|---|---|

| | | | | | | | | | | |
|-----------------------------|---|--|-----------|------|---|---|--------------|--------------|---|---|
| 8 | Monitorimi i zbatimit të ligjshmërisë në Komuna | 1. Plani vjetor i monitorimit, i publikuar 2. Raportet tremujore të Komunave, të hartuara 3. Numri i vlerësimeve ligjore të vendimeve të komunave nga organet mbikqyrëse 4. Mbledhjet e Kuvendeve të Komunave, të monitoruara | K4 - 2014 | MAPL | / | / | € 75,384.60 | € 75,384.60 | / | / |
| 9 | Përmirësimi i veprimtarisë së organeve lokale për përmbushjen e mandatit të tyre ligjor | 1. Databaza për menaxhimin e tokës komunale, e funksionalizuar 2. Raporte të auditorit të përgjithshëm mbi vlerësimin e kualitetit të menaxhimit financiar, të publikuara 3. Raport vjetor mbi zbatimin e projekteve kapitale të Kuvendeve të Komunave, i hartuar. 4. Raport mbi plane të integruara komunale për zhvillimin e Komunës, i hartuar | K4-2014 | MAPL | / | / | € 210,500.00 | € 210,500.00 | / | / |
| 2.1.3. Administrata Publike | | | | | | | | | | |

| | | | | | | | | | | |
|---|--|--|---------|---------|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Te kompletohet korniza ligjore per Reformë të Administratës Publike | 1. Ligji për Shërbim Civil, i plotësuar-ndryshuar 2. Projektligji për Inspektim Administrativ, I miratuar 3. Projektligji për Pagat e Nepunësve Publik që nuk janë pjesë e Sherbimit Civil, i miratuar | K1-2014 | MAP | / | / | / | / | / | / |
| 2 | Te kompletohet korniza ligjore per Reformë të Administratës Publike | 1. Projektligji mbi Qeverine, i miratuar 2. Projektligji mbi Procedurat Administrative, i miratuar 3. Projektligji per Pagat e Zytarëve te Larte Publik, i miratuar 4. Projektligji për Inspektim Administrativ, I miratuar 5. Projektligji për Pagat e Nepunësve Publik që nuk janë pjesë e Sherbimit Civil, i miratuar | K2-2014 | Kuvendi | / | / | / | / | / | / |
| 3 | Të përmirësohen kushtet për funksionin e Institucionit të Avokatit të Popullit | 1. Plotesim-ndryshimi i Ligjit per Avokatin e Popullit duke marre parasysh rekomandimin e Komisionit te Venedikut | K1-2014 | MD | / | / | / | / | / | / |

| | | | | | | | | | | |
|---|--|--|---------|---------|---|---|---|---|---|---|
| 4 | Të përmirësohen kushtet për funksionin e Institucionit të Avokatit të Popullit | <p>1. Plotesim-ndryshimi i Ligjit per Avokatin e Popullit duke marre parasysh rekomandimin e Komisionit te Venedikut</p> <p>2. Propozim buxheti per 2013 per Ombudspersonin ne perputhje me Ligjin per Avokatin e Popullit dhe Ligjin per Menaxhimin e Financave Publike</p> <p>3. Propozim buxheti per 2013 per Ombudspersonin ne perputhje me ligjin per Avokatin e Popullit dhe ligjin per menaxhimin e financave publike</p> | K2-2014 | Kuvendi | / | / | / | / | / | / |
|---|--|--|---------|---------|---|---|---|---|---|---|

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---------|---------|---|---|---|---|---|---|
| 5 | Te implementohen politikat per reformen e administrates publike duke siguruar buxhet si dhe kapacitete te mjaftueshme | <ol style="list-style-type: none"> 1. Udhërrëfyeti për implementimin e SRAP-it, i hartuar 2. Burimet financiare për zbatimin e Udhërrëfyetit, të siguruara 3. Rregulloret për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të të gjitha institucioneve të Qeverise, të miratuara 4. Kodi i ri i mirësjelljes në Shërbimin Civil të Kosovës, i miratuar 5. Sistemi i ri i pagave ne pajtim me Rregulloren për Klasifikimin e Vendeve te Punës, i vendosur 6. Katalogu për vendet e punës, i përfunduar 7. Vlerësimet e rezultateve në punë të nëpunësve civilë sipas sistemit të ri, të realizuara 8. Numri i stafit te rekrutuar ne DMRAP dhe DIEKP 9. Numri i trajnimeve | K4-2014 | MAP | / | / | / | / | / | / |
| 6 | Te sigurohet pajtueshmeri me vendimet e Bordit te Pavarur Mbiqeqyres I Shërbimit Civil të Kosovës | <ol style="list-style-type: none"> 1. Numri i vendimeve dhe rekomandimeve te leshuara 2. Numri i raportimeve rreth implementimit të vendimeve të lëshuara nga KPMSHCK | K4-2014 | KPMSHCK | / | / | / | / | / | / |

| | | | | | | | | | | |
|------------------------|---|---|---------|---------|---|---|---|---|---|---|
| 7 | Te sigurohet pajtueshmeri me vendimet e Bordit te Pavarur Mbikeqyres I Shërbimit Civil të Kosovës | 1.Numri i vendimeve dhe rekomandimeve te leshuara 2. Numri i raportimeve rreth implementimit të vendimeve të lëshuara nga KPMSHCK | K4-2014 | MAP | / | / | / | / | / | / |
| 8 | Te sigurohet pajtueshmeri me vendimet e Bordit te Pavarur Mbikeqyres I Shërbimit Civil të Kosovës | 1.Numri i vendimeve dhe rekomandimeve te leshuara 2. Numri i raportimeve rreth implementimit të rekomandimeve të lëshuara nga KPMSHCK | K4-2014 | ZKM | / | / | / | / | / | / |
| 9 | Te sigurohet pajtueshmeri me vendimet e Bordit te Pavarur Mbikeqyres | 1.Numri i raporteve te shqyrtuara nga Kuvendi | K4-2014 | Kuvendi | / | / | / | / | / | / |
